

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 2066 Rep.  
Nr. 979 Kol. 19

MARREVESHJE SIGURUESE  
MBI KUOTAT E PJESEMARRJES NE SHOQERI



Ne Tirane, sot me date 25/07/2017 (dymije e shtatembdhjete), para meje Noteres Alket Hamcka anetar Dhomes se Noterise Tirane me zyre ne Rr "Asim Ferri", u paraqiten personalisht palet:

**BARREMARRES / KREDIDHENES:**

Raiffeisen Bank Sh.A., një bankë e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në Rruga e Kavajës, Tiranë, Shqipëri, dhe regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr.17426, datë 10.07.1997, me NUIS nr.J61911005B, e përfaqësuar nga përfaqësuesit e saj ligjor Z. Erion BALLI dhe Znj. Rudina HORJETI, (ketu e me poshte do te quhet Banka ose Barremarresi),

Dhe

**BARREDHENES / DOREZANES:**

Hazbi Parllaku i biri i Selimit, dtl.12.06.1955, lindur ne Kukes dhe banues ne adresen Rr "Mihal Grameno", nr. 212, Tirane, identifikuar me leternjoftim nr. 031584869.

**Dhenese e pelqimit;**

Liljana Parllaku e bija e Osmanit, dtl 07.06.1967, lindur ne Tirane dhe banuese ne adresen Rr "Mihal Grameno", nr. 212, Tirane, identifikuar me leternjoftim nr. 027269074

**BARREDHENES / BASHKEKREDIMARRRES:**

Shoqeria "PARLLAKU" shpk, e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 4104, datë 03.05.1993, NUIS J61826145P, date 03/05/1993 me seli ne adresen Petrele Mullet Objekt per ndertim, Godine nje kateshe, 10 km, ne rrugen Tirane - Elbasan, prane Lumit Erzen", Tirane, e përfaqësuar nga ortaku i vctem dhe administratori i shoqerise Z.Hazbi Parllaku (ketu e tutje Kredimarrresi)

dhe

**KREDIMARRRES:**

Shoqeria "TIRANA - URBAN - TRANS" sh.a, e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tirane, me vendimin nr. 26697, datë 10.11.2001, NUIS K21407001A, date regjistrimi 07/02/2002 me seli ne Tirane, Rr. "Abdi Toptani" nr.5, e përfaqësuar ne baze te Vendimit te Keshillit te Mbikeqyrjes se Shoqerise nr.3257 rep, date 08.06.2017 nga administratori i shoqerise Z.Hazbi Parllaku (ketu e tutje kredimarrres);

Baza Ligjore

Kjo kontrate bartobet bazuar ne nenet 6, 24, 31, 420, 605. e ne vazhdim te Kodit Civil.

- Ligjit nr.7829, dt.01.06.1994 "Per Noterine"

- Ligjit nr.8537, date 18.10.1999 "Per barret siguruese" (i ndryshuar).

Neni 1

**INTERPRETIMI**

**1.1 PERKUFIZIME**

Ne kete Marreveshje, termat dhe shprehjet qe vijojne do te kene kuptimet e meposhtune:

(a) "Kolateral" ka kuptimin qe i eshte dhene ketij termi ne Nenin 2.1 te kesaj marreveshjeje.

(c) "Detyrime" do te thote te gjitha detyrimet, pergjegjesite dhe borxhet e cfaredo natyre apo lloji te Barredhenesit ndaj Barremarresit (duke perfshire ketu interesin, tarifat ligjore dhe shpenzimet) qe ai i detyrohet kohe pas kohe, te tashme apo te ardhme, te sigurta apo te mundshme, te maturuara apo jo, te zgjeruara apo te rinovuara qofshin, te marra persiper ne cdo kohe dhe nga kushdo, dhe cdo balance perfundintare te paguar deri tani.

(d) "Borxhe te tjera" do te thote libra, dokumente,shkresa,letra,shenime dhe te dhena elektronike, si dhe te gjitha llogarite e tashme dhe te ardhme, borxhet, pretendimet, detyrimet ne para dhe kerkesat e cdo natyre dhe lloji pavaresisht nese jane te evidentuara nga instrumentet, te cilat jane kerkuar ose do te kerkojen, do te paguhen, detyrime keto te Barredhenesit dhe te gjitha te ardhurat prej tyre.

(e) "Kuota" ka kuptimin e kuotave te pjesemarrjes ne shoqeri dhe te drejtat e lidhura me to sipas legjislacionit ne fuqi

(f) "Detyrime te siguruar" ka kuptimin qe i eshte dhene ketij termi ne Nenin 3.1 si vijon

(g) Te Drejtat e Lidhura "do te thote:

- (i) cdo dividend ose interes i paguar ose i pagueshem ne lidhje me Kuotat;
- (ii) cdo kuote, letra me vlere, te drejta, te holla ose pasuri te lindura ose te ofruara ne cdo kohe (nese me me te kthimit, bonus, preferimit, te drejtave me kusht, zevendesimin, kembimin ose ndryshe) ne lidhje me ose mbi cilendo nga Kuotat;
- (iii) te gjithë dividende, interesat ose te ardhura te tjera ne lidhje me cdo aset te pemendur ne paragrafin (ii) me lart; dhe
- (iv) te gjithë te drejtat e votes ne lidhje me Kuotat, te cilat mund te ushtohen si ne asamblene e zakonshme, ashtu edhe ne asamblene e jashtezakonshme te Shoqerise.

Neni 2

## BARRA SIGURUESE

### 2.1 KRIJIMI I BARRES SIGURUESE

Barredhensit keru Z. Hazbi Parllaku eshte ortak i vetem i shoqerise Shoqeria "PARLLAKU" shpk e organizuar sipas ligjeve te Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tirane, me vendimin nr. 4104, datë 03.05.1993, NUIS J61826145P, date 03/05/1993 me seli ne adresen Petrele Muller Objekt per ndertim, Godinë nje kateshe, 10 km, ne rrugen Tirane - Elbasan, prane Lumit Erzen", Tirane. Sipas Ekstraktit te Regjistrimit Tregtar per te dhenat e Subjektit Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar struktura e ortakeve te kesaj shoqerice paraqet si ortak te saj barredhensin si me poshte vijon:

- Hazbi Parllaku - 100% te kuotave

Barredhensit keru Shoqeria "PARLLAKU" shpk eshte ortak i cili zoteron 50% te kuotave te Shoqerise "TIRANA - URBAN - TRANS", sh.a e organizuar sipas ligjeve te Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tirane, me vendimin nr. 26697, datë 10.11.2001, NUIS K21407001A, date regjistrimi 07/02/2002 me seli ne Tirane, Rr. "Abdi Toptani" nr.5. Sipas Ekstraktit te Regjistrimit Tregtar per te dhenat e Subjektit Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar struktura e ortakeve te kesaj shoqerice paraqet si ortak te saj barredhensin si me poshte vijon:

- Shoqeria "PARLLAKU" shpk- 50% te kuotave

Me ane te kesaj marreveshje siguruase Barredhensit keru i japin Barremarresit nje Barre Siguruase mbi kuotat ne total 100% te kuotave qe Z. Hazbi Parllaku zoteron tek shoqeria "PARLLAKU" shpk me te cilat sigurojne pagesen, permbushjen dhe shlyerjen e te gjitha detyrimeve te siguruar te Shoqerise "TIRANA - URBAN - TRANS" sh.a, ndaj Barremarresit.

Gjithashtu Me ane te kesaj marreveshje siguruase Barredhensit keru i japin Barremarresit nje Barre Siguruase mbi kuotat ne total 50% te kuotave qe Shoqeria "PARLLAKU" shpk zoteron tek shoqeria "TIRANA - URBAN - TRANS" sh.a, me te cilat sigurojne pagesen, permbushjen dhe shlyerjen e te gjitha detyrimeve te siguruar te Shoqerise "TIRANA - URBAN - TRANS" sh.a, ndaj Barremarresit.

Neni 3

## DETYRIMET E SIGURUARA

### 3.1 DETYRIMET E SIGURUARA

Barra Siguruase qe jepet siguron pagimin dhe permbushjen e te gjithë detyrimet monetare (dhe detyrimet te cilat mund te vlersohen ne te holla) dhe detyrimet e Kredimarsit kundrejt Kredidhensit sve sipas Kontratave te Kredise me poshte, duke perfshire, por pa rene ne kundershtrim me parashikimet e pergjithshme parardhese, permbushjen e duhur te te gjithë detyrimeve per pagesat ne lidhje me kryegjene, interesat, kamat-vonesat, tarifat, kostot dhe shpenzimet, demet, taksa dhe taksat e pulles te pagueshme, cdo shume per sherbime ndemjetesimi qe do te paguhen pas parapagimit ose ripagimit te te gjithë apo nje pjese te Kredise ne nje date tjeter nga data e caktuar per pagesen, dhe te gjitha e çdonjera prej kostove, shpenzimeve, takse pulle, taksat apo tarifat e pagueshme ne lidhje me mbrojtjen, ruajtjen apo ekzekutimin e detyrueshem te te drejtave te Kredidheneve sipas Kontrate Kredie Bankare nr. 962 rep, nr. 975 kol date 25 / 07 / 2017, Kontrate Kredie me Kufi nr. 266 rep, nr. 974 kol date 25 / 07 / 2017 dhe Kontrate Kredie Bankare nr. 263 rep, nr. 976 kol date 25 / 07 / 2017 dhe te gjithë detyrimet e Shoqerise dhe te Barredhensit sipas kesaj Marreveshjeje te lidhur ndemjet Kredidhensit dhe Kredimarsit.

### 3.2 INTERESI I VAZHDUESHEM

Kjo Kontrate do te jetë gjithashtu e detyrueshme për barredhensit edhe pas ndonjë ndryshimi, transferimi ose rinovimi të Kontratës së Kredisë ose të kësaj Kontrate. Barredhensit në mënyrë të shprehur bie dakort për vazhdimësinë e kësaj Kontrate në rast të rinovimit të të gjithë ose të një pjese të Detyrimeve të Siguruara (duke përfshirë një rinovim të Kontratës së Kredisë)

### 3.3 APLIKIMI I PAGESAVE

Te gjitha parate e mbledhura apo te marra nga Barremarresit prej Barredhensit do te shkojne per llogari te permbushjes se Detyrimeve ne menyren qe vete Barremarresit ka vendosur.

Neni 4

## MARREVESHJET E BARREDHENSIT

#### 4.1 MARREVESHJE TE PERGJITHSHME

Barredhësi bie dakord që:

(a) do të njoftojë Barremarresin menjëherë për:

- çdo ndryshim të emrit të Barredhësit;

- çdo ndryshim të vendit ku Barredhësi zhvillon aktivitetin e tij tregtar ose, nëse Barredhësi ka me shumë se një vend të tillë, të selisë kryesore të Barredhësit;

- çdo rast mospermbushjeje (sic është perkufizuar me poshtë në nenin 6);

(b) do të autorizojë barremarresin të bëjë, ekzekutojë, njohtë dhe shpërndajë formularet e njoftimit të regjistrimit dhe kalime të metejshme të të dhe transfertave, dokumenteve, akteve, ceshëve dhe gjerave, duke përfshirë shtojcat e metejshme të kësaj Marreveshjeje në mënyrë që kjo Marreveshjeje të ketë efekt.

(c) Barredhësi bie dakord dhe pranon që në rast mospermbushjeje barremarresi ka të drejtë të kryerje ekzekutive detyrueshem të barreve sigurore në përputhje me Ligjin "Për barret sigurore" dhe Barredhësi nuk do të kërkojë procedure të ndryshme ekzekutive nga ajo e parashikuar në ligj duke hequr dorë nga e drejta për ushtrim të Nenit 32 të këtij ligji.

#### 4.2 SHPENZIMET

Barredhësi duhet t'i paguajë Barremarresit, sipas kërkesës së gjitha kostot e arsyeshme të Barremarresit, taksat dhe shpenzimet duke përfshirë, pa përjashtim, pagesat ligjore në lidhje me përgatitjen, regjistrimin ose ndryshimin e kësaj Marreveshjeje, kompletimin apo ruajtjen e Barres Sigurore, zbatimin në çdo formë të dispozitave ose ushtrimit të drejtave, fuqive dhe mjeteve ligjore sipas Marreveshjeje apo sipas Ligjit "Për barret sigurore".

#### Neni 5

#### ARKETIMI I BORXHEVE

Perpara ose pas Mospermbushjes, Barremarresi mund t'i japë njoftim mbi Barren Sigurore çdo personi që është i detyruar të paguajë një borxh apo detyrim që perben Kolateral dhe mundet gjithashtu t'i drejtohet çdo personi për të bërë të gjitha pagesat për llogari të një borxhi të tillë ndaj Barremarresit. Barredhësi pranon që çdo pagesë e marrë prej tij nga persona të tilla në rast Mospermbushjeje, që është në vazhdim, përpara apo pas njoftimit të këtij personi mbi Barren Sigurore, do të merret dhe mbahet nga ai për Barremarresin dhe do t'i jepet Barremarresit sipas kërkesës së tij. Në rast Mospermbushjeje, Barredhësi bie dakord të deponojë të gjitha të ardhurat që rezultojnë në llogarinë e tij në favor të Barremarresit në bankën e aprovuar nga Barremarresi.

#### Neni 6

#### RASTET E MOSPERMBUSHJES

Rastet kur njëra nga ngjarjet e mëposhtme ndodh apo kushtet që vijojnë përbejnë mospermbushje, që këtej e tutje do t'u referohemi si "Rast i Mospermbushjes":

(a) dështimi për të përmbushur çdo lloj detyrimi, duke përfshirë pa asnjë kufizim mospagimin e principalit, interesave apo shuma të tjera që përbejnë pjesë të Detyrimit të papaguar në kohën e duhur sipas parashikimeve të Detyrimeve të Siguruara;

(b) keqinterpretimi thelbësor nga ana e Barredhësit në çdo marreveshje ose transakcion ndërmjet Barredhësit dhe Barremarresit;

(c) falimentimi ose mungesa e afësisë paguese të Barredhësit, njoftimi kundër Barredhësit i procedurave të falimentimit;

(d) çdo proces gjyqësor që behet i ekzekutueshem kundër Barredhësit apo Kolateralit;

(e) nëse një palë tjetër që ka pretendim mbi barren sigurore kundër pasurisë së Barredhësit ben hapa për të ekzekutuar barre sigurore të saj;

(f) nëse Barredhësi pushon apo paralajmëron se do të pushojë veprimtarinë e vet tregtare, shtet ose bie dakord të shesë një pjesë të konsiderueshme të aseteve të veta pa zbatuar ligjin perkates ose pa e njoftuar Barremarresin;

(g) nëse, sipas Barremarresit, në kushte të arsyeshme tregtare, Barra Sigurore ose Kolaterali vihet në rrezik.

#### 6.2 PERSHPEJTIMI

Në rast Mospermbushjeje dhe në çdo kohë me pas, Barremarresi nga ana e tij mund të deklarojë një pjesë ose të gjitha Detyrimet që nuk konsiderohen të pagueshme me anë të kërkesës, të bëhen menjëherë të tilla pa bërë ndonjë kërkesë apo njoftim.

#### 6.3 MJETET LIGJORE NE RAST MOSPERMBUSHJEJE

Në rast Mospermbushjeje, plus të drejtave dhe mjeteve ligjore të tjera që mund të ketë sipas ligjit, Barremarresi mund:

a) Të zgjedhë të mbajë të gjithë apo një pjesë të kolateralit në përmbushje të detyrimeve të Barredhësit sipas kësaj marreveshjeje në mënyrë e parashikuar në ligjin "Për Barret sigurore"

b) Të marrë, të arketojë, të shesë, të japë me qira, të marrë para hua për të siguruar dorezimin e kolateralit tek palët e treta ose të veprime me kolateralin apo një pjesë të tij në mënyrë të tillë, sipas kushteve dhe termave të tilla, dhe në kohën që lejohet nga ligji "Për barret sigurore"; si dhe mund të kërkojë në emër të tij dhe t'u paguajë të tjerëve shuma të arsyeshme për shpenzimet e marra persiper dhe për shërbimet e kryera në lidhje me marrjen, arketimin, kryerjen, marrjen e huasë për sigurimin, shitjen e kolateralit ose fitimin e pagesave nga ai dhe mund t'ia shtojë sasinë e këtyre shumave borxhit që Barredhësi ka ndaj Barremarresit.

c) Të vazhdojë të ekzekutojë pagesat dhe të ushtrojë të drejtat dhe mjetet ligjore të Barremarresit për të cilat parashikohet në ligjin "Për barret sigurore" si dhe të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore në dispozicion të barremarresit të cilat nuk bien në kundërshtim me legjislacionin shqiptar

#### 6.4 MJETET LIGJORE JO-PERJASHTUESE

Te gjitha te drejtat, fuqite dhe mjetet ligjore te Barremarresit sipas kesaj marreveshjeje mund te ushtrohen ne vecanti ose te kombinuara dhe nuk zevendesojne, por jane shtese e cdo forme sigurimi ne vazhdim nga Barremarresi dhe te gjitha te drejtat e tjera, fuqite apo mjetet ligjore te Barremarresit, pavaresisht nga forma se si kane lindur apo jane krijuar.

## 6.5 PERGJEGJESIA PER MUNGESAT

Per sa kohe eshte ne perputhje me ligjin e zbatueshem, Barredhenesi mbetet pergjegjes per permushjen e cdo Detyrimi qe nuk eshte permushur plotesisht ose shlyer nga dhenia e te ardhurave qe linden nga zbatimimi i Barres Siguruese kundrejt Detyrimeve te Siguruara.

### Neni 7

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### 7.1 VAZHDIMESIA E SIGURISE

Kjo Marreveshje dhe Barra Siguruese e krijuar sipas saj nuk zevendesojne por konsiderohen si shtese e barreve te tjera siguruese te mbajtura nga Barremarresi, dhe konsiderohet nje Marreveshje ne vazhdimesi dhe Barra Siguruese deri kur perfundon me shkrim dhe nenshkruhet nga palet.

### 7.2 KOMUNIKIMI

Kur edonjeres nga palet i kerkohet apo i jepet e drejta te njoftoje, te drejtoje ose t'i beje nje kerkese pales tjeter, ky njoftim, drejtim apo kerkese duhet te jete me shkrim dhe qubet i mjaftueshem kur dergohet me poste te thjeshte tek kjo pale, ne adresat e fundit te raportuara nga pala.

### 7.3 PASARDHESIT DHE CESIONARET

Kjo Marreveshje duhet te jete e detyrueshme per Barredhenesin dhe pasardhesit e tij ose saj dhe duhet te siguroje qe eshte ne favor Barremarresit, pasardhesve te tij dhe cesionareve. Kjo Marreveshje duhet te jete e cedueshme (transferueshme) nga Barremarresi qe eshte i lire nga pretendimet ndermjet Barredhenesit dhe Barremarresit, dhe Barredhenesi nuk ka te drejte t'i kundervihet cesionarit apo te ngreje ndaj tij pretendimet qe ai ka ndaj Barremarresit.

### 7.4 Pranimi i Shoqerise

Shoqeria pranon detyrimet e premtimet e Barredhenesit sipas kesaj Marreveshjeje dhe bie dakord te mos ndermarre asnje veprim qe mund te cetoje ose ndaloje zbatimin e tyre .

### Neni 8

## Verifikimi dhe raportimi i te dhenave

Palet ne kete kontrate bien dakord dhe deklarojne si me poshte :Duke kuptuar se, te dhënat tona demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë do të trajtohen ne perputhje me kuadrin ligjor dhe nenligjor ne fuqi per mbrojtjen e te dhenave personale, sekretin bankar si dhe sekretin profesional si dhe per faktin se Banka Raiffeisen dhe Regjistrin e Kredive të Bankes se Shqiperise kane marre te gjitha masat e nevojshem per te garantuar trajtimin e sigurt te te dhenave te mesiperme :

Autorizoj Raiffeisen Bank qe, per qellimet qe perfshijne:

1. vleresimin e aplikimit per te marrë kredi;
2. vleresimin e rrezikut të kredisë gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies time kontraktore të kredisë me bankën Raiffeisen dhe/ose
3. vleresimin e besueshmërisë time si person i lidhur me kredimarrësit,

te njihet me detyrimet e mia ndaj bankave/ degëve të bankave të huaja/ subjekteve kredidhënëse, nëpërmjet përdorimit të autorizuar të të dhënave/informacionit të Regjistrin të Kredive, në mënyrë që të vlerësojë sasinë e detyrimeve financiare, garancitë dhe besueshmërinë/afërsinë për të shlyer detyrimet financiare. Gjithashtu, jap pëlqimin tim që banka Raiffeisen, të përdorë emrin dhe të dhënat e mia identifikuese dhe financiare që mbahen në Regjistrin e Kredive, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë

Ky autorizim konsiderohet i dhene per te gjithë personat nenshkruer te kontrates , pra si per kredimarrësit dhe te dhenat e tyre, ashtu dhe per dorezanesit dhe apo hipotekuesit.

## 9. TE NDRYSHME

9.1 Kjo marreveshje do te zbarohet dhe do te interpretohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

9.2 Barredhenesi autorizon Barremarresin te rregjistroje formularet e njoftimit te rregjistrimit dhe dokumenta te tjere dhe te ndermarre te gjitha veprimet qe Barremarresi mund te mendoje se jane te nevojshme per te kompletuar dhe vazhduar kompletimin e Barres Siguruese, per te mbrojtur dhe ruajtur Kolateralin dhe per te ekzekutuar barren siguruese;

9.3 Kjo marreveshje eshte pjese e Kontrates se Huase ne Llogarine Rrjedhese dhe e detyrueshme si per palet nenshkruese, ashtu dhe per personat qe mund te zene vendin e tyre ose te cileve u jane transferuar te drejtat apo detyrimet.

9.4 Palet mund te ndryshojne vetem me shkrim elementet e kesaj marreveshjeje dhe t'i pasqyrojne ato ne Regjistrin e Barreve Siguruese.

- 9.5 Mosmarveshjet e paleve zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert kompetente do te jete Gjykata e Shkalles se Pare Tirane.
- 9.6 Marveshja nenshkrhet ne 7(shtate) kopje nga te cilat nje kopje per kredimarresin , nje kopje per bashkekredimarresi, nje per barredhensin, dy per kredithensin, nje per Qendren Kombetare te Biznesit dhe nje kopje depozitohet prane noterit.

**KREDIHENESI/BARREMARRES**

**BANKA RAIFFEISEN**

**PERFAQESUAR NGA:**

Erion BALLI

*Erion Balli*

Rudina HORJETI

*Rudina Horjeti*



**BARREDHENES**

Hazbi PARLLAKU

*Hazbi Parllaku*

Liljana PARLLAKU

*Liljana Parllaku*

**BARREDHENES/BASHKEKREDIMARRES**

Shoqeria "PARLLAKU" shpk

Perfaqesuar nga

Hazbi Parllaku

*Hazbi Parllaku*



**KREDIMARRES:**

Shoqeria "TIRANA - URBAN - TRANS" sh.a

Perfaqesuar nga

Hazbi PARLLAKU

*Hazbi Parllaku*



**NOTER**

*[Large handwritten signature]*



*[Handwritten mark]*



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
 DHOMA E NOTEREVE TIRANE  
 Nr. 2665 Rep.  
 Nr. 977 Kol. 13

MARREVESHJE SIGURUESE

Ne Tirane, sot me date 20 2017 (dy mijë e shtatëmbëdhjetë), para meje Noteres Alket Hamcka, anctar e Dhomes se Noterise Tirane me zyre ne Rr "Asim Zemele", u paraqiten personalisht palet:

BARREMARRES / KREDIDHENES:

Raiffeisen Bank Sh.A., një bankë e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në Rruga e Kavajës, Tiranë, Shqipëri, dhe regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr.17426, datë 10.07.1997, me NUIS nr.J61911005B, e përfaqësuar nga përfaqësuesit e saj ligjor Z. Erion BALLI dhe Znj. Rudina HORJETI, (ketu e me poshte do te quhet Banka ose Barremarresit),

Dhe

BARREDHENES / KREDIMARRES:

Shoqëria "TIRANA - URBAN - TRANS" sh.a, e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 26697, datë 10.11.2001, NUIS K21407001A, date regjistrimi 07/02/2002 me seli ne Tirane, Rr. "Abdi Toptani" nr.5, e perfaqesuar ne baze te Vendimit te Keshillit te Mbiqyqyrjes se Shoqerise nr.3257 rep, date 08.06.2017 nga administratori i shoqerise Z.Hazbi Parllaku (ketecj e tuje barredhenes/Kredimarres);

Baza Ligjore

Kjo kontrate bartohet bazuar ne nenet 6, 24, 31, 420, 605, e ne varshim te Kodit Civil.  
 - Ligji nr.7829, dt.01.06.1994 "Per Noterine"  
 - Ligji nr.8537, date 18.10.1999 "Per barret siguruese".

Neni 1

INTERPRETIMI  
 1.1 PERKUFIZIME

Ne kete Marreveshje, termat dhe shprehjet qe vijojne do te kene kuptimet e meposhtme:

- (a) "Kolateral" ka kuptimin qe i eshte dhene ketij termi ne Nenin 2.1 si vijon.
- (b) "Detyrime" do te thote te gjitha detyrimet, pergjegjesite dhe borxhet e cfaredo natyre apo lloji te Barredhenesit ndaj Barremarresit (duke perfshire ketu interesin, tarifat ligjore dhe shpenzimet) qe ai i detyrohet kohe pas kohe, te tashme apo te ardhme, te sigurta apo te mundshme, te maturuara apo jo, te zgjeruara apo te rinovuara qofshin, te marra persiper ne cdo kohe dhe nga kushdo, dhe cdo balance perfundimtare te papaguar deri tani qe rrjedhin nga Kontratat e Kredise Bankare e permendur ne pikën 2.2 të kësaj marrëveshje.
- (c) "Borxhe te tjera" do te thote libra, dokumente, shkresa, letra, shenime dhe te dhena elektronike, si dhe te gjitha llogarite e tashme dhe te ardhme, borxhet, pretendimet, detyrimet ne para dhe kerkesat e cdo natyre dhe lloji pavaresisht nese jane te evidentuara nga instrumentet, te cilat jane kerkuar ose do te kerkoehen, do te paguhen, detyrime keto te Barredhenesit dhe te gjitha te ardhurat prej tyre.
- (d) "Llogaritë Bankare dhe të Arkëtueshmet" nënkupton Llogaritë të tashme dhe të ardhshme të Barredhënësit dhe të gjithë të arkëtueshmet e tashme dhe të ardhshme të kryera nga te gjithë klientët, duke përfshirë por jo verëem, së bashku me të gjithë shumat kohë pas kohe që do të kreditohen në këto llogari si dhe interesi që do t'u kreditohet atyre (që më poshtë do i referohemi si "Kolateral").
- (e) "Rast Mospërbushje" nënkupton një nga Rastet e Mospërbushjes që përcaktohen ne kete marreveshje dhe ne Kontraten/at e Kredise.
- (f) "Ligji për Barret Siguruese" do të thotë ligji i Republikës së Shqipërisë nr. 8537, datë 18 Tetor 1999, se bashku me ndryshimet përkatëse dhe ndryshuar se fundmi sipas ligjit nr.101 date 20 Tetor 2016.
- (g) "Detyrime" do te kuptohen:
  - (i) te gjitha detyrimet monetare (dhe detyrimet qe mund te vlerësohen ne para) dhe pergjegjesite e Barredhënësit përkundrejt kredidhenesit sipas Kontrate; dhe
  - (ii) të gjitha detyrimet e Barredhënësit sipas Kontrates, dhe kësaj Marreveshje
- (h) "Regjistri i Barreve Siguruese" ka kuptimin që i jepet në Ligjin për Barret Siguruese.

(i) "Barre Siguruese" do të thotë barra siguruese e radhës së parë mbi Llogaritë Bankare dhe të Arkëtueshmet e krijuar në favor të Kredidhënësit në përputhje me Nenin 2 të kësaj Marrëveshje dhe sipas dispozitave të Kontrates

Neni 2

BARRA SIGURUESE  
 2.1 KRIJIMI I BARRES SIGURUESE

Barredhenesi ketu i jep Barremarresit nje Barre Siguruese ("Barre Siguruese") ne:

A-Llogarite rrjedhese, depozitat dhe garancite bankare te tashme dhe te ardhme qe Kredimarrësi/Barredhenesi Shoqëria "TIRANA - URBAN - TRANS" sh.a ka ose do te kete prane Kredidhenesit/barremarresit nen numrin e identifikimit personal si me poshte dhe ne cfaredo numri tjeter identifikimi te percaktuar nga Banka si dhe Llogarite rrjedhese, depozitar dhe garancite bankare te tashme dhe te ardhme qe Kredimarrësi/Barredhenesi Shoqëria "TIRANA - URBAN - TRANS" sh.a ka ose do te kete prane cdo banke te nivelit te dyte perfshire te gjitha interesat dhe te drejtat qe ai perfiton :

Shoqëria "TIRANA - URBAN - TRANS" sh.a NRP 805456

B. Të gjithë të arkëtueshmet te tashme dhe të ardhshme të kredituara ne llogarite qe kredimarresit/bashkekredimarresit ka prane kredidhenesit dhe prane Raiffeisen Bank sh.a dhe prane cdo banke tjeter te nivelit te dyte ne Republikën e Shqiperise perfshire te gjitha interesat dhe te drejtat qe ai perfiton , qe rrjedhin nga kontratat si vijon:

1. Kontrate sherbimi "Per transportin e udhetareve dhe stafit te TEG per linjen Stacionit te Trenit - Qender - TEG date 28.01.2017 te lidhur midis shoqerise Tirana East Gate dhe Barredhenesit Shoqëria "TIRANA - URBAN - TRANS" sh.a;

2.2 Barra Siguruese e dhënë në pikën "2.1", siguron pagimin, përmbushjen dhe shlyerjen e kredive dhënë nga Barrëmarrësi me anën e një Kontrate Kredie Bankare nr. 2062 rep, nr. 975 kol date 25/07/2017, Kontrate Kredie me Kufi nr. 2061 rep, nr. 974 kol date 25/07/2017 dhe Kontrate Kredie Bankare nr. 2063 rep, nr. 976 kol date 25/07/2017 si dhe siguron pagimin e çdo shume që Barrëdhënësi Shoqëria "TIRANA - URBAN - TRANS" sh.a i detyrohen Barrëmarrësit /Kredidhënësit në bazë të këtyre kontratave.

(Këtej e tutje pasurive të kategorive të mësipërme do t'u referohemi në mënyrë të përgjithshme si "Kolateral" dhe çdo reference për "Kolateralin" do të konsiderohet si reference për "Kolateralin ose çdo pjesë të tij").

### Neni 3 DETYRIMET E SIGURUARA

#### 3.1 DETYRIMET E SIGURUARA

Kjo marrëveshje siguruese, Barra Siguruese që jepet, siguron pagimin dhe përmbushjen e të gjitha Detyrimeve që rrjedhin nga Kontrate Kredie Bankare nr. 2062 rep, nr. 975 kol date 25/07/2017, Kontrate Kredie me Kufi nr. 2061 rep, nr. 974 kol date 25/07/2017 dhe Kontrate Kredie Bankare nr. 2063 rep, nr. 976 kol date 25/07/2017.

#### 3.2 INTERESI I VAZHDUESHEM

Barra Siguruese do të jetë barre e vazhdueshme pavaresisht nëse Detyrimet mund të mos jenë fikse dhe mund, që kohe pas kohe, të zvogelohen në bilanc zero dhe pavaresisht se kredia e dhënë mund të ripaguhet dhe është dhënë kredi tjetër për të cilën Barrëdhënësi është përgjegjës. Barrëmarrësi me kërkesë të Barrëdhënësit, mund të lirojë apo heq dorë nga Barra Siguruese mbi një pjesë të kolateralit në raport me detyrimet financiare të Kredimarrësit/Barrëdhënësit të parashikuara në Kontratën e Kredisë.

#### 3.3 APLIKIMI I PAGESAVE

Në rast vonese në përmbushje të detyrimeve, Barrëmarrësi me iniciativën e tij dhe pa qenë nevoja për njoftim apo miratim të mëtejshëm të barrëdhënësit, ka të drejtë që të preke/debitoje çdo shume të mbledhur në llogaritë/depozitat/garancite bankare, objekt i kësaj marrëveshjeje.

Të gjitha paratë e mbledhura apo të marra nga Barrëmarrësi prej Barrëdhënësit do të shkojnë për llogari të përmbushjes së Detyrimeve në mënyrë që vetë Barrëmarrësi ka vendosur.

### Neni 4 MARREVEESHJET E BARREDHENESIT

#### 4.1 MARREVEESHJE TE PERGJITHSHME

Barredhënësi bie dakord që:

- (a) do të njoftojë Barrëmarrësin menjëherë për:
  - (i) çdo ndryshim të emrit të Barredhënësit;
  - (ii) çdo ndryshim të vendit ku Barredhënësi zhvillon aktivitetin e tij tregtar ose, nëse Barredhënësi ka më shumë se një vend të tillë, të selisë kryesore të Barredhënësit;
  - (iii) çdo rast mospërmbushjeje (si është përkufizuar në Kontratën e Kredisë dhe në këtë Marrëveshjeje);
- (b) do të bëjë, ekzekutojë, njohtë dhe shpërndajë formularët e njoftimit të regjistrimit dhe kalime të mëtejshme të të dhe transfertave, dokumenteve, akteve, cështjeve dhe gjerave, duke përfshirë shtojcat e mëtejshme të kësaj Marrëveshjeje sic mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme nga Barrëmarrësi në mënyrë që kjo Marrëveshjeje të ketë efekt.

#### 4.2 SHPENZIMET

Barredhënësi duhet t'i paguajë Barrëmarrësit, sipas kërkesës së gjitha kostot e arsyeshme të Barrëmarrësit, taksat dhe shpenzimet duke përfshirë, pa përjashtim, pagesat ligjore në lidhje me përgatitjen, regjistrimin ose ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje, kompletimin apo ruajtjen e Barres Siguruese, zbatimin në çdo formë të dispozitave ose ushtrimit të të drejtave, fuqive dhe mjeteve ligjore sipas Marrëveshjes apo sipas Ligjit "Për barret siguruese".

### Neni 5 ARKETIMI I LLOGARIVE

Perpara ose pas Mospërmbushjes, Barrëmarrësi mund t'i japë njoftim mbi Barren Siguruese çdo personi që është i detyruar të paguajë një borxh apo detyrim që përben Kolateral dhe mundet gjithashtu t'i drejtohet çdo personi për të bërë të gjitha pagesat për llogari të një borxhi të tillë ndaj Barrëmarrësit. Barredhënësi pranon që çdo pagesë e marrë prej tij nga persona të tilla në rast Mospërmbushjeje, që është në vazhdim, perpara apo pas njoftimit të këtij personi mbi Barren Siguruese, do të merret dhe mbahet nga ai për Barrëmarrësin dhe do t'i jepet Barrëmarrësit sipas kërkesës së tij. Në rast Mospërmbushjeje, Barredhënësi bie dakord të depozitojë të gjitha të ardhurat që rezultojnë në llogarinë e tij në favor të Barrëmarrësit në bankën e aprovuar nga Barrëmarrësi.

### Neni 6 RASTET E MOSPERMBUSHJES

Përveç atyre rasteve të parashikuara në Kontratën e Kredisë rastet kur njëra nga ngjarjet e mëposhtme ndodh apo kushtet që vijojnë përbejnë mospërmbushjeje, që këtej e tutje do t'u referohemi si "Rast i Mospërmbushjes":

- (a) dëshimi për të përmbushur çdo lloj detyrimi, duke përfshirë pa asnjë kufizim mospagimin e principarit, interesave apo shumën e tjera që përbejnë pjesë të Detyrimit të papaguar në kohën e duhur;

(b) keqinterpretimi thelbesor nga ana e Barredhënesit e cdo marrëveshjeje ose transakcioni ndërmjet Barredhënesit dhe Barremarresit në lidhje me marrëdhënien e kreditimit sipas kontratës së kredisë siguruar me këtë marrëveshje siguroese;

(c) falimentimi ose mungesa e aftësisë paguese të Barredhënesit, njoftimi kundër Barredhënesit i procedurave të falimentimit;

(d) cdo vendim gjyqësor i formës së prërë i ekzekutueshem kundër Barredhënesit apo Kolateralit;

(e) nëse një palë tjetër që ka pretendim mbi barrën siguroese kundër pasurisë së Barredhënesit bën hapa për të ekzekutuar barrë siguroese të saj;

(f) nëse Barredhënesi pushon apo paralajmëron se do të pushojë veprimtarinë e vet tregtare, shet ose bie dakord të shesë një pjesë të konsiderueshme të aseteve të veta pa zbatuar ligjin përkatës ose pa e njoftuar Barremarresin;

## 6.2 PERSHPEJTIMI

Në rast Mospermbushjeje dhe në cdo kohë me pas, Barremarresi nga ana e tij mund të deklarojë një pjesë ose të gjitha Detyrimet që nuk konsiderohen të pagueshme me anë të kërkesës, të bëhen menjëherë të tilla pa bërë ndonjë kërkesë apo njoftim.

## 6.3 MJETET LIGJORE NE RAST MOSPERMBUSHJEJE

Në rast Mospermbushjeje, plus të drejtave dhe mjeteve ligjore të tjera që mund të ketë sipas ligjit, Barremarresi mund:

a) Të zgjedhë të mbajë të gjithë apo një pjesë të kolateralit në permbushje të detyrimeve të Barredhënesit sipas kësaj marrëveshjeje në mënyrën e parashikuar në ligjin "Për Barret siguroese"

b) Të marrë, të arketojë, të shesë, të japë me qira, të marrë para hua për të siguruar dorezimin e kolateralit tek palet e treta ose të veprojë me kolateralin apo një pjesë të tij në mënyrë të tillë, sipas kushteve dhe termave të tilla, dhe në kohën që lejohet nga ligji "Për barret siguroese"; si dhe mund të kërkojë në emër të tij dhe të paguajë të tjerëve shuma të arsyeshme për shpenzimet e marra për shërbimet e kryera në lidhje me marrjen, arketimin, kryerjen, marrjen e huasë për sigurimin, shitjen e kolateralit ose fitimin e pagesave nga ai dhe mund t'i shtojë sasinë e ketyre shumave borxhit që Barredhënesi ka ndaj Barremarresit.

c) Të vazhdojë të ekzekutojë pagesat dhe të ushtrojë të drejtat dhe mjetet ligjore të Barremarresit për të cilat parashikohet në ligjin "Për barret siguroese" si dhe të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore në dispozicion të barremarresit të cilat nuk bien në kundërshtim me legjislacionin shqiptar.

## 6.4 MJETET LIGJORE JO-PERJASHTUESE

Të gjitha të drejtat, fuqitë dhe mjetet ligjore të Barremarresit sipas kësaj marrëveshjeje mund të ushtrohen në veçanti ose të kombinuara dhe nuk zëvendësojnë, por janë shtesë e cdo forme sigurimi në vazhdim nga Barremarresi dhe të gjitha të drejtat e tjera, fuqitë apo mjetet ligjore të Barremarresit, pavarësisht nga forma se si kanë lindur apo janë krijuar.

## 6.5 PERGJEGJESIA PER MUNGESAT

Për sa kohë është në përputhje me ligjin e zbatueshem, Barredhënesi mbetet përgjegjës për permbushjen e cdo Detyrimi që nuk është permbushur plotësisht ose shlyer nga dhënia e të ardhurave që lindin nga zbatimi i Barrës Siguroese kundrejt Detyrimeve.

### Neni 7

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### 7.1 VAZHDIMESIA E SIGURISE

Kjo Marrëveshje dhe Barra Siguroese e krijuar sipas saj nuk zëvendësojnë por konsiderohen si shtesë e barreve të tjera siguroese të mbajtura nga Barremarresi, dhe konsiderohet një Marrëveshje në vazhdimësi dhe Barra Siguroese deri kur përfundon me shkrim dhe nënshkruhet nga palet.

### 7.2 KOMUNIKIMI

Kur çdonjëres nga palet i kërkohet apo i jepet e drejta të njoftojë, të drejtojë ose t'i bëjë një kërkesë palës tjetër, ky njoftim, drejtim apo kërkesë duhet të jetë me shkrim dhe qubet i mjaftueshem kur dërgohet me poste të thjeshtë tek kjo palë, në adresat e fundit të raportuara nga pala.

### 7.3 PASARDHESIT DHE CESIONARET

Kjo Marrëveshje duhet të jetë e detyrueshme për Barredhënesin dhe pasardhësit e tij ose saj dhe duhet të sigurojë që është në favor Barremarresit, pasardhësve të tij dhe cesionarëve. Kjo Marrëveshje duhet të jetë e cedueshme (transferueshme) nga Barremarresi që është i lirë nga pretendimet ndërmjet Barredhënesit dhe Barremarresit, dhe Barredhënesi nuk ka të drejtë t'i kundërvihet cesionarit apo të ngrejë ndaj tij pretendimet që ai ka ndaj Barremarresit.

### 7.4 VERIFIKIMI DHE RAPORTIMI I TE DHENAVE

Palet në këtë kontratë bien dakord dhe deklarojnë si më poshtë: Duke kuptuar se, të dhënat tona demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar si dhe sekretin profesional si dhe për faktin se Banka Raiffeisen dhe Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar trajtimin e sigurt të të dhënave të mesipërme:

Autorizoj Raiffeisen Bank që, për qëllimet që përfshijnë:

1. Vlerësimin e aplikimit për të marrë kredi;

2. vlerësimin e rrezikut të kredisë gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies time kontraktore të kredisë me bankën Raiffeisen dhe/ose
3. vlerësimin e besueshmërisë time si person i lidhur me kredimarrësit,

të njihet me detyrimet e mia ndaj bankave/ degëve të bankave të huaja/ subjekteve kredidhënëse, nëpërmjet përdorimit të autorizuar të të dhënave/informacionit të Regjistrimit të Kredive, në mënyrë që të vlerësojë sasinë e detyrimeve financiare, garancitë dhe besueshmërinë/afësinë për të shlyer detyrimet financiare. Gjithashtu, jap pëlqimin tim që banka Raiffeisen, të përdorë emrin dhe të dhënat e mia identifikuese dhe financiare që mbahen në Regjistrin e Kredive, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë

Ky autorizim konsiderohet i dhene per te gjithë personat nënshkruer te kontrates, pra si per kredimarrësit dhe te dhenat e tyre, ashtu dhe per dorezuesit dhe apo hipotekuesit.

## 8. TE NDRYSHME

- 8.1 Kjo marrëveshje do te zbatohet dhe do te interpretohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
- 8.2 Barredhenesi autorizon Barremarrësin te rregjistroje formularet e njoftimit te rregjistrimit dhe dokumenta te tjere dhe te ndermarre te gjitha veprimet qe Barremarrësi mund te mendoje se jane te nevojshme per te kompletuar dhe vazhduar kompletimin e Barres Siguruese, per te mbrojtur dhe ruajtur Kolateralin dhe per te ekzekutuar barren siguruese;
- 8.3 Kjo marrëveshje eshte pjese e Kontrates se Kredise me Kufi dhe/ose e kontrates se kredise dhe e detyrueshme si per palet nënshkruese, ashtu dhe per personat qe mund te zene vendin e tyre ose te cileve u jane transferuar te drejtat apo detyrimet.
- 8.4 Palet mund te ndryshojne vetem me shkrim elementet e kesaj marrëveshjeje dhe t'i pasqyrojne ato ne Regjistrin e Barreve Siguruese.
- 8.5 Mosmarrëveshjet e paleve zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 8.6 Marrëveshja nënshkruhet ne 4 ( kater ) kopje nje per kredimarrësin, dy per kredidhënësin dhe nje kopje depozitohet pranë noterit.

### KREDIDHENESI/BARREMARRES

#### BANKA RAIFFEISEN

Perfaqesuar nga:

Erion BALLI

*Erion Balli*

Rudina HORJETI

*Rudina Horjeti*



### KREDIMARRRES/BARREDHENES

#### Shoqeria "TIRANA - URBAN - TRANS" sh.a

Perfaqesuar nga:

Hazbi PARLLAKU

*Hazbi Parllaku*

*Hazbi Parllaku*



NOTER

*[Large handwritten signature]*



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 1005/2017 Rep.  
Nr. 98 Kol. 13

MARRËVESHJE SIGURUESE

(Kolateral specifike)

Sot me datë 25/07/2017 (dy mijë e shtatëmbëdhjetë) para meje Alket Hamçke, notere në Dhomen e Noterisë Tiranë, me adresë Pr. Asim Çemeli, u paraqitën personalisht për të redaktuar këtë kontratë palet:

**BARRËMARRESE / KREDIDHËNESE:**

Raiffeisen Bank Sh.A., një bankë e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në Rruga e Kavajës, Tiranë, Shqipëri, dhe regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr.17426, datë 10.07.1997, me NUIS nr.J61911005B, e përfaqësuar nga përfaqësuesit e saj ligjor Z. Erion BALLI dhe Znj. Rudina HORJETI, (ketu e me poshtë do të quhet Banka ose Barremarresi),

Dhe

**BARREDHENES / KREDIMARRRES:**

Shoqëria "TIRANA - URBAN - TRANS" sh.a, e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 26697, datë 10.11.2001, NUIS K21407001A, date regjistrimi 07/02/2002 me seli në Tiranë, Rr. "Abdi Toptani" nr.5, e përfaqësuar në baze të Vendimit të Keshillit të Mbrojtjes së Shoqërisë nr.3257 rep, date 08.06.2017 nga administratori i shoqërisë Z.Hazbi Parlaku (këtëj e tutje kredimarrës);

**Baza Ligjore**

Kjo kontratë bartet bazuar në nenet 6, 24, 31, 420, 605, e në varësim të Kodit Civil,

- Ligjit nr.7829, dt.01.06.1994 "Për Noterinë"

- Ligjit nr.8537, datë 18.10.1999 "Për barrët siguruese".

të cilët kanë rënë paraprakisht dakort që të lidhin këtë Marrëveshje Siguruese me kushtet e mëposhtme.

**Neni 1**

**INTERPRETIMI**

**1.1 PERKUFIZIME**

Në këtë Marrëveshje, termit dhe shprehjet që vijojnë do të kenë kuptimet e mëposhtme:

(a) "Kolateral" ka kuptimin që i është dhënë këtij termi në Nenin 2.1 si vijon.

(b) "Detyrime" do të thotë të gjitha detyrimet, përgjegjësitë dhe borxhet e çfarëdo natyre apo lloji të Barredhënesit ndaj Barremarresit (duke përfshirë këtu interesin, tarifën ligjore dhe shpenzimet) që ai i detyrohet kohë pas kohe, të tashme apo të ardhme, të sigurta apo të mundshme, të maturuara apo jo, të zgjeruara apo të rinovuara qofshin, të marra persiper në çdo kohë dhe nga kushdo, dhe çdo balance përfundimtare të papaguar deri tani.

(c) "Borxhe të tjera" do të thotë libra, dokumente, shkresa, letra, shënime dhe të dhëna elektronike, si dhe të gjitha llogaritë e tashme dhe të ardhme, borxhet, pretendimet, detyrimet në para dhe kërkesat e çdo natyre dhe lloji pavaresisht nëse janë të evidentuara nga instrumentet, të cilat janë kërkuar ose do të kërkojnë, do të paguhet, detyrime këto të Barredhënesit dhe të gjitha të ardhurat prej tyre.

(d) "Inventar" do të thotë gjithë inventaret e Barredhënesit të furnizuara ose financuara nga Barremarresi, kudo që ato janë të vendosura, nëse janë në pronësi ose do të fitohen apo rifitohen me pas nga Barredhënesi duke përfshirë gjithë mallrat, lenden e pare, mallrat në proces, mallra të përfunduara dhe pasuri personale e prekshme e mbajtur për shitje, dhenie me qira, rishitje, për t'u furnizuar apo që do të furnizohet sipas kontratave për shërbime.

**2. KRIJIMI I BARRËS DHE DETYRIMIT TË SIGURUAR**

2.1 Barredhënesi me këtë marrëveshje vendos në favor të Bankës/Barremarresë një barrë siguruese (së cilës më poshtë i referohemi me emërtimin "Barrë Siguruese") në mallrat e shënuara më poshtë:

- AUTOBUS, marka Neoplan, targa AA 790 AI, Lcje Qarkullimi me datë leshimi 26.04.2011, me numer identifikimi WAG244166YPN31233, është në emër të Shoqërisë "TIRANA-URBAN -TRANS" sh.a, Tiranë;

- **AUTOBUS, marka Neoplan**, targa AA 784 AI, Leje Qarkullimi me date leshimi 25.04.2011, me numer identifikimi WAG244166YPN28294, eshte ne emer te Shoqerise "TIRANA-URBAN -TRANS" sh.a, Tirane.
- **AUTOBUS, marka Neoplan**, targa AA 783 AI, Leje Qarkullimi me date leshimi 25.04.2011, me numer identifikimi WAG244166YPN31210, eshte ne emer te Shoqerise "TIRANA-URBAN -TRANS" sh.a, Tirane;
- **AUTOBUS, marka Neoplan**, targa AA 780 AI, Leje Qarkullimi me date leshimi 25.04.2011, me numer identifikimi WAG244166YPN31207, eshte ne emer te Shoqerise "TIRANA-URBAN -TRANS" sh.a, Tirane;
- **AUTOBUS, marka Neoplan**, targa AA 786 AI, Leje Qarkullimi me date leshimi 25.04.2011, me numer identifikimi WAG244166YPN31208, eshte ne emer te Shoqerise "TIRANA-URBAN -TRANS" sh.a, Tirane;
- **AUTOBUS, marka Neoplan**, targa AA 781 AI, Leje Qarkullimi me date leshimi 25.04.2011, me numer identifikimi WAG244166YPN31212, eshte ne emer te Shoqerise "TIRANA-URBAN -TRANS" sh.a, Tirane;
- **AUTOBUS, marka Neoplan**, targa AA 791 AI, Leje Qarkullimi me date leshimi 25.04.2011, me numer identifikimi WAG244166YPN31231, eshte ne emer te Shoqerise "TIRANA-URBAN -TRANS" sh.a, Tirane;
- **AUTOBUS, marka Neoplan**, targa AA 789 AI, Leje Qarkullimi me date leshimi 26.04.2011, me numer identifikimi WAG244166YPN31232, eshte ne emer te Shoqerise "TIRANA-URBAN -TRANS" sh.a, Tirane;
- **AUTOBUS, marka Neoplan**, targa AA 785 AI, Leje Qarkullimi me date leshimi 25.04.2011, me numer identifikimi WAG244166YPN31209, eshte ne emer te Shoqerise "TIRANA-URBAN -TRANS" sh.a, Tirane;
- **AUTOBUS, marka Neoplan**, targa AA 792 AI, Leje Qarkullimi me date leshimi 26.04.2011, me numer identifikimi WAG244166YPN31234, eshte ne emer te Shoqerise "TIRANA-URBAN -TRANS" sh.a, Tirane;
- **AUTOBUS, marka Neoplan**, targa AA 782 AI, Leje Qarkullimi me date leshimi 26.04.2011, me numer identifikimi WAG244166YPN31235, eshte ne emer te Shoqerise "TIRANA-URBAN -TRANS" sh.a, Tirane.
- **AUTOBUS, marka Renault**, targa AA 684 NX, Leje Qarkullimi me date leshimi 03.05.2016, me numer identifikimi VF6PS09B400012376, eshte ne emer te Shoqerise "TIRANA-URBAN -TRANS" sh.a, Tirane.
- **AUTOBUS, marka Renault**, targa AA 685 NX, Leje Qarkullimi me date leshimi 03.05.2016, me numer identifikimi VF6PS09B400012375, eshte ne emer te Shoqerise "TIRANA-URBAN -TRANS" sh.a, Tirane.
- **AUTOBUS, marka Renault**, targa AA 686 NX, Leje Qarkullimi me date leshimi 03.05.2016, me numer identifikimi VF6PS09B400012415, eshte ne emer te Shoqerise "TIRANA-URBAN -TRANS" sh.a, Tirane.
- **AUTOBUS, marka Renault**, targa AA 687 NX, Leje Qarkullimi me date leshimi 03.05.2016, me numer identifikimi VF6PS09B400012374, eshte ne emer te Shoqerise "TIRANA-URBAN -TRANS" sh.a, Tirane.
- **AUTOBUS, marka Renault**, targa AA 688 NX, Leje Qarkullimi me date leshimi 03.05.2016, me numer identifikimi VF6PS09B400012437, eshte ne emer te Shoqerise "TIRANA-URBAN -TRANS" sh.a, Tirane.
- **AUTOBUS, marka Renault**, targa AA 689 NX, Leje Qarkullimi me date leshimi 03.05.2016, me numer identifikimi VF6PS09B400012435, eshte ne emer te Shoqerise "TIRANA-URBAN -TRANS" sh.a, Tirane.
- **AUTOBUS, marka Renault**, targa AA 792 NN, Leje Qarkullimi me date leshimi 25.02.2016, me numer identifikimi WAG244162XPN29827, eshte ne emer te Shoqerise "TIRANA-URBAN -TRANS" sh.a, Tirane

dhe së bashku me të gjitha pjesët, aksesoret, pajisjet, veglat e veçanta, rinovimet dhe pjesët e këmbimit në tërësi apo vec e vec, pavarësisht nëse janë në pronësi të Barrëdhënësit momentalisht apo nëse do të ftohën nga ai në të ardhmen (këtu e më poshtë referuar si "Kolateral Specifik").

1.2 Barra Siguruese e dhënë në pikën "1.1", siguron pagimin, përmbushjen dhe shlyerjen e kredise në shumën **46,000,000 ALL (dyzet e gjashte milion)** dhënë nga Barrëmarrësi me Kontrate Kredie Bankare nr. 2662 rep. nr. 945 kol date 25/07/2017, Kontrate Kredie me Kufi nr. 2661 rep. nr. 944 kol date 25/07/2017 dhe Kontrate Kredie Bankare nr. 2663 rep. nr. 946 kol date 25/07/2017, si dhe siguron pagimin e çdo shume që Barrëdhënësi i detyrohet Barrëmarrësit në bazë të këtij raporti kreditimi.

### 3.PREMTIMET E BARRËDHËNËSIT

Barrëdhënësi bie dakort dhe premtim se:

- 3.1 Do të mbajë kolateralin në gjendje të mirë dhe do të bëjë ato riparime që ruajnë vlerën e kolateralit, me përjashtim të amortizimit të zakonshëm;
- 3.2 Në qoftë se i bëhet kërkesë, të japë me shkrim çdo informacion në lidhje me Kolateralin Specifik dhe të lejojë Barrëmarrësin që herë pas here të kontrollojë këtë kolateral duke u lejuar të hyjë në territorin dhe mjediset e brendshme të Barrëdhënësit;
- 3.3 Në qoftë se i bëhet kërkesë, të ekzekutojë, njohë dhe japë detyra, transferata dhe dokumenta ashtu siç mund t'i kërkohej në mënyrë të arsyeshme nga Barrëmarrësi në mënyrë që t'i jepet efekt kësaj Marrëveshjeje si dhe të paguajë të gjitha kostot e kërkimit dhe regjistrimit në regjister;
- 3.4 T'i paguajë Barrëmarrësit shpenzimet apo kostot, duke përfshirë shpenzimet ligjore të bëra nga Barrëmarrësi për të vënë në ekzekutim këtë Marrëveshje ose për të ekzekutuar të drejtat e tij mbi Kolateralin Specifik, si dhe shpenzimet për regjistrimin e njoftimeve dhe kërkimin e informacionit në Regjister në lidhje me barrën siguruese të krijuar nga kjo marrëveshje;
- 3.5 Të njoftojë menjëherë Barrëmarrësin n.q.se Kolaterali Specifik dëmtohet, shkatërrohet, konfiskohet apo vidhet;
- 3.6 Të ndryshojë menjëherë Barrëmarrësin për ndryshim të emrit të Barrëdhënësit;
- 3.7 Të mos shesë, japë me qira apo të tjetërsojë Kolateralin Specifik ose çdo interes të lidhur me të pa miratimin me shkrim të Barrëmarrësit;
- 3.8 Të sigurojë Kolateralin Specifik kundrejt humbjeve ose dëmtimeve nga zjarri dhe rrezikët shtesë, në një shoqëri siguruese, sipas preferencës së Barrëmarrësit.

#### 4. DEKLARATAT DHE GARANCITË

Barredhësi deklaron dhe garanton Bankën si më poshtë vijon:

- Barredhësi është pronar i vetëm e legjitim i Pasurive dhe ka të drejta të plota dhe të ligjshme për të dhënë kolateralin;
- Kolateralin është i lirë nga çdo barrë.
- nuk ka kërkesë padi apo pretendime në proces të ngritur përpara ndonjë gjykate apo paneli arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë apo jashtë saj, lidhur me kolateralin;
- krijimi, dhënia dhe regjistrimi i kolateralit është në përputhje me objektin dhe qëllimin e aktivitetit të Barredhësit dhe se të gjitha autorizimet e nevojshme apo të këshillueshme lidhur me ofrimin, vendosjen dhe regjistrimin e Barrës Siguruese janë dhënë dhe janë të vlefshme;
- krijimi, dhënia dhe regjistrimi i Barrës Siguruese si dhe dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk shkelin asnjë marrëveshje apo deklaram tjetër për marrje përsipër detyrimi në të cilën Barredhësi është palë apo ndonjë parashikim ligjor, rregullorë, vendim apo urdhër tjetër të gjykatës apo të autoritetit publik apo të çdo dokumenti tjetër ligjor me fuqi detyruese për Shoqërinë dhe se të gjitha detyrimet e parashikuara nga kjo Marrëveshje përbëjnë detyrime të vlefshme dhe të detyrueshme për zbatim nga Barredhësi;

Të gjitha deklaratat dhe garancitë e Shoqërisë sipas kësaj dispozite zbatohen në mënyrë të përsëritshme nga Barredhësi çdo ditë deri në përfundim të kësaj Marrëveshjeje.

#### 5. MBARIMI I BARRËS SIGURUESE

5.1 Barra Siguruese do t'i lirohet Barredhësit vetëm pas pëmbushjes në mënyrë të plotë dhe të përvokueshme të të gjithave detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kredie Bankare nr. 2062 rep. nr. 975 kol date 25/07/2017, Kontrata Kredie me Kufi nr. 2061 rep. nr. 974 kol date 25/07/2017 dhe Kontrata Kredie Bankare nr. 2063 rep. nr. 976 kol date 25/07/2017, duke kryer njëkohësisht edhe c' regjistrimin nga Regjistri i Barrëve Siguruese.

#### 6. RASTI I MOSPËRMBUSHJES

- 6.1 Nëse rrethanat e përshkruara më poshtë do të vërtetohen, atëherë kjo do të konsiderohet mospërbushje (me poshtë referuar si "mospërbushje"):
- Nëse Barredhësi nuk do të paguajë Barrëmarrësin, kur pagimi bëhet i detyrueshëm, çdo shumë që i detyrohet Barrëmarrësit sipas kësaj marrëveshjeje apo ndonjë tjetër të lidhur me këtë, ose në qoftë se Barredhësi nuk do të përbushë ndonjë premtim ose kusht tjetër të kësaj marrëveshjeje apo ndonjë tjetër të lidhur me Barredhësin dhe Barrëmarrësit;
  - Nëse ndonjë deklaram bërë nga Barredhësi në lidhje me këtë marrëveshje merret vesh të jetë i pasakte;
  - Nëse do të duhet të ekzekutohet një vendim gjyqësor ndaj Barredhësit;
  - Nëse çdo palë tjetër që pretendon të ketë barrë siguruese mbi Kolateralin Specifik, ndërmerr hapa për të ekzekutuar barrën e vet siguruese;
  - Nëse sipas mendimit të Barrëmarrësit, dhe mbi baza tregtare të arsyeshme, Barra Siguruese ose Kolateralin Specifik rrezikon ose mund të vihen në rrezik;
  - Nëse Barredhësi falimenton ose ndaj tij fillojnë procedura falimentimi vullnetare apo të detyruara.

#### 7. MJETET LIGJORE

7.1 Në rast mospërbushjeje, përveç të drejtave dhe mjeteve ligjore që parashikohen nga ligji, Barrëmarrësi mund:

- vetë ose përfaqësuesit e tij, por gjithmone me pëlqimin e Barredhësit, të hyjë në territorin e Barredhësit në të cilin ndodhet Kolateralin Specifik ose ndonjë pjesë e tij, me qëllim që të marrë në posedim këtë kolateral dhe ta zhvendosë atë nga ky territor;
- të deklarojë, kur e gjykon të nevojshme, menjëherë si të detyrueshme për Barredhësin që t'i paguajë të gjithë borxhin që i detyrohet, duke përfshirë borxhin e siguruar pa pasur nevojë për kërkesë ose njoftim të çdo lloji, dhe të arketojë të gjithë borxhin që i detyrohet me shpenzime të arsyeshme përfshirë kostot e gjykatës, pagimin e avokatëve dhe shpenzime të tjera ligjore;
- përveç të drejtave të parashikuara më sipër dhe atyre që garanton ligji, Barrëmarrësi ka, si para ashtu edhe pas mospërbushjes, të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore që i sigurohen nga Ligji "Për barrët siguruese", duke përfshirë të drejtën për të shitur kolateralin specifik dhe të drejtën për pagimin e çdo lloj mangësie që Barrëmarrësit mund t'i sigurohet me ligj.

#### 8. VERIFIKIMI DHE RAPORTIMI I TË DHENAVE

Palët në këtë kontratë bien dakord dhe deklarojnë si më poshtë: Duke kuptuar se, të dhënat tona demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë do të mbahen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe nuk do të transferohen në një shtet të tretë, si dhe për faktin se Banka Raiffeisen dhe Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar trajtimin e sigurt të të dhënave të mësipërme:

Autorizoj Raiffeisen Bank që, për qëllimet që përfshijnë:

- vlerësimin e aplikimit për të marrë kredi;
- vlerësimin e rrezikut të kredisë gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies time kontraktore të kredisë me bankën Raiffeisen dhe/ose
- vlerësimin e besueshmërisë time si person i lidhur me kredimarrësit.

të njihet me detyrimet e mia ndaj bankave/ degëve të bankave të huaja/ subjekteve kredihënëse, nëpërmjet përdorimit të autorizuar të të dhënave/informacionit të Regjistrat të Kredive, në mënyrë që të vlerësojë sasinë e detyrimeve financiare, garancitë dhe besueshmërinë/ aftësinë për të shlyer detyrimet financiare. Gjithashtu, jap pëlqimin tim që banka Raiffeisen, të përdorë emrin dhe të dhënat e mia identifikuese dhe financiare që mbahen në Regjistrin e Kredive, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë. Ky autorizim

konsiderohet i dhene per te gjithe personat nenshkruer te kontrates , pra si per kredimarrsesit dhe te dhenat e tyre, ashtu dhe per dorezanesit dhe apo hipotekuesit.

### 9. TE NDRYSHME

- 9.1 Kjo marreveshje do te zbatohet dhe do te interpretohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
- 9.2 Barredhenesi autorizon Barremarresin te rregjistroje formularet e njoftimit te rregjistrimit dhe dokumenta te tjere dhe te ndermarre te gjitha veprimet qe Barremarresi mund te mendoje se jane te nevojshme per te kompletuar dhe vazhduar kompletimin e Barres Siguruese, per te mbrojtur dhe ruajtur Kolateralin Specifik dhe per te ekzekutuar barren siguruese.
- 9.3 Kjo marreveshje eshte pjese e Kontrates se Kredise dhe e detyrueshme si per palet nenshkruese, ashtu dhe per personat qe mund te zene vendin e tyre ose te cileve u jane transferuar te drejtat apo detyrimet.
- 9.4 Palet mund te ndryshojne vetem me shkrim elementet e kesaj marreveshjeje dhe t'i pasqyrojne ato ne Regjistrin e Barreve Siguruese.
- 9.5 Mosmarreveshjet e paleve zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert kompetente do te jete Gjykata e Shkalles se Pare Tirane.
- 9.6 Marreveshja nenshkruhet ne ne 4 (kater) kopje origjinale ne prani te perkthyesit ne rast se eshte e nevojshme nje per barredhenesin, dy per barremarresin dhe nje kopje depozitohet prane noterit.

**KREDIDHENESI/BARREMARRES**  
**BANKA RAIFFEISEN**  
**PERFAQESUAR NGA:**

Erion BALLI



Rudina HORJETI



**BARREDHENES:**


Shoqeria "Tirana-Urban -Trans" sh.a

Perfaqesuar nga

Hazbi Parllaku



NOTERE



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
Dhoma e Noterise TIRANE  
Nr. 2061 Rep.  
Nr. 274 Kol. 13



### Kontrate Kredie me Kufi

Sot me date 25/07/2017, para meje Alket Memci Notere Publike ne Dhomen e Noterise Tirane me adrese ne Rrugen "Asim Zemele" u paraqiten personalisht palet:

#### KREDIDHENESI:

Raiffeisen Bank Sh.A., një bankë e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në Rruga e Kavajës, Tiranë, Shqipëri, dhe regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr.17426, datë 10.07.1997, me NIPT nr.J61911005B, e përfaqësuar nga përfaqësuesit e saj ligjor Z. Erion BALLI dhe Znj. Rudina HORJETI (këtë e tutje, "Banka" ose "Kredidhenesi"); dhe

#### KREDIMARRESI:

Shoqëria "TIRANA - URBAN - TRANS" sh.a, e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tirane, me vendimin nr. 26697, datë 10.11.2001, NUIS K21407001A, date regjistrimi 07/02/2002 me seli ne Tirane, Rr. "Abdi Toptani" nr.5, e perfaqesuar ne baze te Vendimit te Keshillit te Mbiqerqyrjes se Shoqerise nr.3257 rep, date 08.06.2017 nga administratori i shoqerise Z.Hazbi Parllaku (ketej e tutje kredimarresi);

#### BASHKEKREDIMARRES:

Shoqëria "PARLLAKU" shpk, e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tirane, me vendimin nr. 4104, datë 03.05.1993, NUIS J61826145P, date 03/05/1993 me seli ne adresen Petrele Mullet Objekt per ndertim, Godine nje kateshe, 10 km, ne rrugen Tirane - Elbasan, pranë Lumit Erzen", Tirane, e perfaqesuar nga ortaku i vetem dhe administrator i shoqerise Z.Hazbi Parllaku (ketej e tutje Kredimarresi)

#### DOREZANES:

Hazbi Parllaku i biri i Selimit, dtl.12.06.1955, lindur ne Kukes dhe banues ne adresen Rr "Mihal Grameno", nr. 212, Tirane, identifikuar me leternjofim nr. 031584869.

te cilet vendosin te lidhin kete kontrate me kushtet dhe termat e meposhtme, bazuar ne nenet 1031 e ne vijim, nenet, 560-584, 585-600 te K.Civil, Ligji per Barret Siguruese etj.

Financimi i dhënë Shoqëria "TIRANA - URBAN - TRANS" sh.a sipas kesaj kontrate kredie është mundësuar falë mbështetjes së Bashkimit Europian në kuadër të Programit për Zhvillim dhe Inovacion të Sipërmarrjeve të Ballkanit Perëndimor.

#### PËRKUFIZIMET

Nëse përmbajtja nuk e kërkon ndryshe, kudo që do të përdoren në këtë Kontratë, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

- "Ditë Pune" nënkupton, çdo ditë në të cilën bankat tregtare ne Shqiperi janë të hapura për veprime bankare të zakonshme.
- "Borxh" nënkupton, të gjitha detyrimet e Kredimarresit, si në formën e kryegjësë ose interesit (dhe/ose interesit për mospërmbushje), qofshin këta aktual, të ardhshëm ose të rasit, për pagimin ose ripagimin e parave Bankës sipas kushteve të kësaj Kontrate.
- "Afat i Kamatvonesës" nënkupton, në lidhje me çdo shumë të pa-paguar sipas kësaj Kontrate, një periudhë që fillon nga dita në të cilën kjo pagesë bëhet e kërkueshme dhe që mbaron në ditën e fundit të muajit që vijon pas datës në të cilën pagesa bëhet e kërkueshme.
- "Disbursim" nënkupton, disbursimin e një pjese të Kredise / Leshimin e Garancise Bankare ose pjese te saj nga banka per kredimarresin, në përputhje me Nenin 2 ose, siç mund t'a kërkojë përmbajtja, disbursimin e një pjese të shumës së kryegjësë të papaguar.
- "Rasti i Mospërmbushjes" nënkupton secilin prej rasteve ose ngjarjeve të parashikuara në Nenin 9.

"Data e Pagimit të Interesit"

nënkupton Ditën e Parë të Punës që vijon pas mbarimit të Periudhës së Interesit.

"Periudhë Interesi"

nënkupton, periudhën gjatë së cilës zbatohet interesi kontraktor, periudhë e cila fillon nga data e Disbursimit së Kredise dhe që mbaron pas 1 (një) muaji kalendarik.

"Kredia"

nënkupton shumën maksimale të kredise parashikuar në Nenin 2 ose, siç mund t'a kërkojë përmbajtja, shumën e kryegjësë së papaguar.

"Garanci"

nënkupton çdo hipotekë, peng, barrë siguroese, ose çdo mjet tjetër për sigurimin e detyrimit, të vendosur apo krijuar nga Kredimarrësi në favor të Bankës me qëllim garantimin e përmbushjes së detyrimeve të Kredimarrësit sipas kësaj Kontrate.

"Marreveshje siguroese"

nënkupton çdonjërin dhe të gjitha Kontratat ndërmjet Palëve të cilat vendosin apo krijojnë Garanci.

"Efekt material negativ"

nënkupton, në gjykimin e Kredithenesit, çdo efekt, ngjarje, ose ceshtje, e cila është materialisht kundër:

- (i) biznesit, aseteve, ose situates financiare të Kredimarrësit/Dorezanesit; ose
- (ii) aftësia e kredimarrësit/dorezanesit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kesaj kontrate.

"Garantor/Dorezanes"

nënkupton çdo person juridik apo fizik që ofron një garanci sipas parashikimeve të Nenin 585 e në vazhdim të Kodit Civil.

"Garancia"

Garancia e leshuar nga Fondi Europian i Investimeve në kuader të Programit për Zhvillimin dhe Inovacion të Sipërmarrjeve të Ballkanit Perëndimor

"Palet e Interesuara"

Fondi Europian i Investimit ("EIF"), agjentët e EIF, Zyra Europiane e Auditorëve ("ECA"), Komisioni dhe agjentët e Komisionit (duke përfshirë Zyrën Europiane Kundër Mashtrimit ("OLAF ") dhe çdo institucion tjetër i Bashkimit Europian ose pjesëtar i Bashkimit Europian i cili ka të drejtë të verifikojë përdorimin e garancisë në kuadër të Projektit për Zhvillim dhe Inovacion të Sipërmarrjeve të Ballkanit Perëndimor dhe çdo palë tjetër e autorizuar në bazë të ligjit në fuqi i cili ka të drejtë të auditojë ose monitorojë aktivitetet

Kriteret e Pranimit

Nënkupton kriteret e perputhshmërisë dhe pranueshmërisë të aplikuara nga Banka për pranuar financimin e Kredimarrësit në kuader të Programit për Zhvillim dhe Inovacion të Sipërmarrjeve të Ballkanit Perëndimor

## KUSHTET PARAPRAKE PËR DISBURSIMIN FILLESTAR DHE CDO DISBURSIM

Përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe me shkrim, detyrimi i Bankës për të bërë Disbursimin e parë të Kredise, sipas pëlqimit dhe diskrecionit të Bankës, i nënshtrohet përmbushjes paraprake të kushteve të mëposhtme:

- a. Banka merr prova që vërtetojnë se Marreveshjet Siguroese dhe Hipotekat janë plotësisht në fuqi dhe janë depozituar dhe regjistruar rregullisht; se Garancite është e vlefshme dhe efektive dhe se të drejtat e Bankës që rrjedhin nga Marreveshjet Siguroese dhe Hipotekat janë të ekzekutueshme;
- b. Kredimarrësi siguron çdo dokument tjetër të kërkuar nga Banka dhe plotëson të gjitha kushtet e detyrueshme përpara disbursimit
- c. Kredimarrësi paraqet prane bankes faturat e leshuara nga furnitoret sipas listes bashkangjitur në Aneksin 5 dhe transfertat bankare perkatese .

## NENI 1: OBJEKTI I KONTRATES

1.1 Kredimarrësi bie dakort që paraqitja në Banke nga Kredimarrësi e një autorizimi debitimi të llogarisë së tij në Banke (ketu e më poshte do të quhet Llogaria), në një shume të cila e tejkalon gjendjen e kesaj Llogarie, do të përbejë një kerkese nga ana e

Kredimarrësit për një kredi në shumën me të cilën tejkalohet gjendja e llogarive. Përveç rasteve kur specifikohet ndryshe, një autorizim debitimi do të konsiderohet çdo autorizim pagese nga ana e Kredimarrësit, i cili pranohet nga Banka.

- 1.2 Kjo kontratë ka për objekt dhenien e kredive në kufi në llogarive rrjedhëse, me kërkesë të Kredimarrësit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë, me qëllim dhenien e likuiditëve Kredimarrësit për kapital punës. Kjo kredi nuk mund të perdoret nga kredimarrësi për qëllime të ndryshme nga ato të cituara në këtë paragraf.

## NENI 2: SHUMA E KREDISE

- 2.1 Banka i jep kredi në llogarive rrjedhëse Kredimarrësit, deri në shumën prej 12'000'000ALL (dymbëdhjetë milion lek). Kjo shumë do të autorizohet në llogarive të klientit. Levrimi fondëve do të bëhet me transferat bankare në drejtim të furnitorëve përundrejt faturave dhe para-faturave të cilat nuk duhet të jenë më të vona se muaji Maj 2017.

## NENI 3: KOHEZGJATJA

- 3.1 Kjo kontratë kredie kufi do të ketë një afat kohezgjatje deri me datë 01 Qershor 2018 duke filluar nga dita e autorizimit të kredive në llogarive rrjedhëse, e rinovueshme në perfundim të këtij afati me kërkesë të kredimarrësit dhe miratim të bankës, për periudhat pasardhëse, deri në 10 vjet, nga data e fillimit të saj. Palet bien dakord që 30 dite përpara plotësimit të çdo afati duke filluar nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate, kundrejt kërkesës së Kredimarrësit për rinovim, Kredidhësi do të bëjë një rishikim të situatës financiare dhe ligjore të kredimarrësit dhe të pasurive të vendosura si garanci. Në perfundim të rishikimit Kredidhësi do të njoftojë me shkrim kredimarrësin për çdo vendim të marrë në lidhje me rinovimin dhe limitin e përcaktuar në pikën 2.1 të kësaj kontrate, deri në 15 ditë pas perfundimit të çdo afati. Në çdo rinovim të këtij limiti Kredidhësi ka të drejtë të vendosë edhe për zvogëlimin e limitit të përcaktuar në nenin 2.1 të kësaj kontrate. Njoftimi me shkrim i Kredimarrësit për pranimin e rinovimit përben provë të plote se kjo kontratë është rinovuar me të njëjtat kushte, për limitin e kredive të treguar në njoftim.
- 3.2 Në çdo rast kjo kontratë nuk do të ketë vlerë ligjore për palet nëse Kredimarrësi nuk kërkon perdorimin e kredive sic parashikohet në nenin 2, brenda 6 (gjashtë) muajve nga dita e nënshkrimit përpara Notoerit Publik.
- 3.3 Kredimarrësi do të paguajë një shumë prej 0.5% (zero pike pese për qind) të shumës së Kredive për shpenzime administrative të pagueshme në momentin e autorizimit të kredive kufi. Në çdo rinovim për një periudhë 12 mujore, kredimarrësi do të paguajë të njëjtin komision 0.5% mbi limitin e kredive të rinovuara.
- 3.4 Në perfundim të çdo periudhe, nëse Kredidhësi nuk aprovon rinovimin e kredive kufi, apo kur perfundon afati 10 vjeçar, Kredimarrësi detyrohet të kthejë të gjithë shumën e detyrimit.

## NENI 4: LLOGARIA E KREDISE

- 4.1 Linja e Kredive do të mundësohet në llogarive rrjedhëse me të cilën Kredimarrësi operon pranë Raiffesen Bank. Kredimarrësi dhe/ose Kredimarrësit bien dakord që shumën e kredive të disbursohet në llogarive të Kredimarrësit të përcaktuara në Nenin 1.
- 4.2 Kredimarrësi në llogarive të të cilat disbursohet kredia si dhe të gjithë kredimarrësit e tjerë bien dakord që Banka të perdorë çdo balancë kreditore në llogarive të tij në të cilën është akorduar linja e kredive apo në çdo llogari tjetër që Kredimarrësit mund të ketë pranë Bankës, për të terhequr atë detyrim që Kredimarrësit i kanë Bankës për arsye të ndryshme, pa i derguar me pare njoftim Kredimarrësve.
- 4.3 Palet kanë rënë dakord që gjendjet e llogarive të nxjerra nga librat e bankës dhe të leshuara nga punonjësi i saj, të cilat tregojnë transaksionet e kryera për llogari të Kredimarrësit dhe/ose Kredimarrësve, përbejnë provë të plote për të mbështetur pretendimet e Bankës ndaj Kredimarrësit dhe/ose Kredimarrësve.


## NENI 5: MENYRA E FINANCIMIT DHE SHLYERJES SE KREDISE

- 5.1 Disbursimi i Kredive do të bëhet për permbushjen e qelimit të kredive sipas nenit 1, kundrejt paraqitjes së dokumentacionit dhe instruksioneve të pagesës nga ana e kredimarrësit.
- 5.2 Kredimarrësi paguan 0.5% (sero pike pese për qind) të shumës së kredive për kostot administrative, në momentin e aktivizimit/rinovimit të kredive në llogarive rrjedhëse.
- 5.3 Kredimarrësit do t'i aplikohet interes mbi balancën debitore të llogarive rrjedhëse për shumën e kredive i cili do të jetë Tribor një vjeçar i ndryshueshem në çdo rinovim dhe i fiksuar deri në maturim + 2.5% (dy pike pese) në vit, në asnjë rast kjo normë interesi nuk do të jetë më e vogël se 6.2% (gjashtë pike dy) vjetore.

Palet bien dakord që në rastet kur Norma Bazë e interesit Tribor ka vlerë negative, banka në kalkulimin e interesit do ta konsiderojë me vlerë 0 (zero).

- 5.4 Interesi do të llogaritet çdo ditë dhe do të paguhet çdo fund muaji, mbi balancën debitore të llogarive rrjedhëse të kredive, duke filluar nga dita e pare e perdorimit të kredive në bazë të shumës së perdorur.





Per limitet e kredise ne Euro ose USD, interesi do te llogaritet ne baze te vitit me 360 (treqind e gjashtedhete) dite. Vlera e interesit cdo muaj do te llogaritet mbi pjesen e perdorur te limitit te kredise x interesin vjetor te kredise x numri i diteve / 360 dite.

*Llogaritja e Interesit*  
*Shembull*  
*Limiti i Kredise i perdorur 50,000*  
*Maturiteti 12 muaj*  
*Interesi 8% ne vit*  
*Vlera totale e interesit mujor:333*

Per limitet e kredise ne ALL, interesi do te llogaritet ne baze te vitit me 365 (treqind e gjashtedhete e pese) dite. Vlera e interesit cdo muaj do te llogaritet mbi pjesen e perdorur te limitit te kredise x interesin vjetor te kredise x numri i diteve / 365 dite.

*Llogaritja e Interesit*  
*Shembull*  
*Limiti i Kredise i perdorur 50,000*  
*Maturiteti 12 muaj*  
*Interesi 8% ne vit*  
*Vlera totale e interesit mujor:329*

Ne momentin e nenshkrimtimit te kontrates Norma Efektive e Interesit (NEI) eshte 7.21% ne vit. Megjithate, Vlera e sakte e NEI-T do te shprehet ne planin e amortizimit, i cili do t'i dorezohet klientit pas disbursimit te kredise. Sqarimi i detajuar i NEI –t gjendet ne Ankesin 1 te kesaj kontrate.

5.5 Palet bien dakort qe Banka ka te drejte te debitoje llogarine rrjedhese, per shumen e interesit te maturuar cdo dite te fundit te muajit. Kur kjo dite bie dite pushimi pagesa kryhet ne ditën pasardhese te punes

5.6 Kthimi i shumes se kryegjese do te behet ne perfundim te afatit te maturimit te kredise sipas kesaj kontrate.

5.7 Kredimarresi eshte pergjegjes per perdorimin e kredise deri ne limitin e miratuar. Ne rast se Kredimarresi e kalon limitin e miratuar nga Banka, ai do te paguaje interes debitor (30)% ne vit per kredine ne Lëke ose (20)% ne vit per kredine ne Euro/USD, e llogaritur mbi shumen me te cilen kalohet limiti i miratuar, gjate kohes qe eshte kaluar limiti, sipas kushteve te kesaj kontrate per shumen.

*Llogaritja e penalitetit ne rast mospagese te limitit te maturuar eshte sa me poshte:*  
*Shembull:*  
*Limiti: 1,000,000 leke*  
*Dite vonese: 10 dite*  
*Penalitet per tu paguar=1,000,000\*30%\*10/365=8,219.2 leke*

5.8 Ne rast se Kredimarresi eshte ne pamundesi per te paguar vleren e kredise ose nje pjese te saj ne afatin e caktuar ai do te paguaje interes debitor (30)% ne vit per kredine ne Lëke ose (20)% ne vit per kredine ne Euro/USD per vleren e kredise, e llogaritur cdo dite mbi te vleren e kredise se pakthyer, deri ne momentin e kthimit te kredise vullnetarisht apo dhe me ane te procedurave te ekzekutimit te detyrueshem siaps legjislacionit ne fuqi dhe bazuar ne kushtet e kesaj kontrate. Palet konsiderojne detyrim te pashlyer sipas kesaj kontrate te gjithë shumen e kredise, interesat e papaguara te kontrates bashke me interesat debitore , te gjithë komisionet e tjera te pagueshme per marrjen e kredise, respektimin e kontrates dhe ato per venien ne ekzekutim te detyrueshem te kontrates derisa banka te kete rimarre ne llogarite e saj te gjithë kete shume.

*Llogaritja e penalitetit ne rast mospagese te interes te papaguar eshte sa me poshte:*  
*Shembull:*  
*Kesti i rradhes eshte 10,509 leke*  
*Dite ne vonese 10 dite*  
*Penaliteti i paguar=10,509\*30%\*10/365=86.4leke*

5.9 Palet bien dakord dhe Banka ka te drejte te debitoje llogarine e Kredimarresit per te paguar cdo komision bankar, tarifa te regjistrimit te marreveshjeve te hipotekes dhe te barreve sigururesse, tarifa te vleresimit te pasurive te vendosura si garanci dhe cdo tarife tjeter te pagueshme nga kredimarresi per marrjen e kredise edhe ne rast se keto debitime jane kundrejt kredise ne llogari rrjedhese, kur Kredimarresi nuk ka balance kreditore ne llogarine e tij rrjedhese.

5.10 Ne rast se kredimarresi mbyll tepricen debitore qe ka prane RBAL-se sipas kesaj kontrate, perpara afatit parashikuar ne kete kontrate duke kerkuar zgjidhjen e kontrates, dhe kerkon lirimin e kolateralit te bllokuar ne favor te RBAL-se atehere kredimarresi do te paguaje nje penalitet qe do te jete 5 % e shumes se parapaguar.

*Shembull per pagimin teresor:*  
*Kryegjeja e mbetur eshte 3,000,000 Lëke*  
*Komisioni i paguar = 3,000,000\*5% = 150,000Lëke*

Shëmbull për pagimin pjesor:  
Shuma që do të parapaguhet është 200,000 Lëke  
Komisioni i paguar = 200,000\*5% = 10,000 Lëke

5.11 Kredimarrësi do të paguajë një shumë prej xxx% (me shkrim) vjetore të shumës së papërdorur të Kredisë së komision angazhimi

Bashkangjitur kësaj kontrate është Aneksi 1, 2,3 dhe 4 i cili përmban ndërt të tjera Normën Efektive të interesit , rrezikun e kredimarrjes së valute të huaj dhe Ngjarjen e Luhatjes së Tregut.

#### NENI 6: SIGURIMI I KTHIMIT TË LINJËS SË KREDISE NGA KREDIMARRËSI DHE DOREZANESI

- 6.1 Kredimarrësi siguron kredinë kufi të dhënë nga Banka me garancitë e vena nga vete ai dhe dorezanesi sipas kontratës së hipotekimit nr. 2064 rep. nr. 974 kol date 25.07.2017, Marreveshje Siguruese nr. 2065 rep. nr. 978 kol date 25.07.2017, Marreveshje Siguruese nr. 2067 rep. nr. 980 kol date 25.07.2017 dhe Marreveshje siguruese pengu kuotat e pjesëmarrjes në shoqëri nr. 2066 rep. nr. 979 kol date 25.07.2017.
- 6.2 Keto garanci do të jenë të vlefshme dhe në fuqi pa patur nevojë për t'u reregjistruar apo konfirmuar në cdo rinovim, deri në kthimin e plote të të gjithë shumave që kredimarrësi i detyrohet kredidhënësit sipas kësaj kontrate.
- 6.3 Banka, në rast të mospërbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kjo Kontrate nga ana e Kredimarrësit, ka të drejtë të kërkojë sekuestrimin, sipas procedurave të njohura nga legjislacioni në fuqi, e pronave të paluajtshme dhe të luajtshme të vena si hipoteke apo barre siguruese në favor të saj.
- 6.4 Banka në rast se garancitë e dhëna nga Kredimarrësi, për shkakë të ndryshme, nuk e mbulojnë kredinë e dhënë plus interesat, kërkon vendosjen e garancive shtese. Në rast refuzimi nga ana e Kredimarrësit për të përbushur detyrimin e mesipër, Bankës i lind të drejta të kërkojë zgjidhjen e Kontratës dhe kthimin e menjehershëm të saj.
- 6.5 Kredimarrësi është i detyruar të marrë të gjitha masat dhe të kryejë cdo shpenzim të kërkuar për të ruajtur vlerën e garancisë, përfaqësuar nga cilado formë. I njëjti detyrim ekziston edhe kur Banka dhe Kredimarrësi janë në konflikt gjyqësor, për sa kohë që sendi nuk ka kaluar plotësisht në posedim të Bankës.
- 6.6 Me anë të kësaj kontrate Kredimarrësi/Kredimarrësit/Dorezanesi/Dorezanesit bien dakort dhe autorizon paraprakisht Bankën, që pa miratim të tij, banka të preke me inisiativë llogaritë që ai/ata mund të disponojë në Banke, në rast se Kredimarrësi/Kredimarrësit/Dorezanesi/Dorezanesit është në vonesë në pagimin e kësaj të rradhes, interesave dhe penaliteteve që vijnë sipas kësaj kontrate si dhe komisioneve vjetore të aplikuara për kredinë sipas kontratës dhe kushteve të punës në fuqi të Bankës. Gjithashtu Kredimarrësi/ Dorezanesi detyrohet të mbyllë me fondet e veta cdo tepricë debitore që mund të lindin nga përdorimi i kredisë në monedha të ndryshme si dhe autorizojnë bankën të preke me inisiativë llogaritë që ai/ata mund të disponojë në Banke për mbylljen e këtyre tepricave debitore.

#### NENI 7: DETYRIMET E KREDIMARRËSIT

- 7.1 Kredimarrësi në këtë kontratë kredie me kufi në llogari rrjedhese është përgjegjës dhe merr përsipër detyrimet si më poshtë:
- Kredimarrësi do të njoftojë menjëherë Bankën për (i) ngjarjet e çdo Rasti Mospërbushje dhe çdo rast tjetër të njohur prej tij, i cili, me dhënien e njoftimit dhe/ose me kalimin e kohës, do të bëhet një Rast Mospërbushje, (ii) çdo padi të ngritur kundër Kredimarrësit, dhe (iii) vërtetimin e çdo kushti apo ngjarje e cila mund të ketë materialisht efekt mbi kushtet dhe aftësinë financiare të Kredimarrësit për të përbushur detyrimet e tij;
  - Kredimarrësi, me shpenzimet e veta, do të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për të mbajtur Kontraten e Hipotekës në fuqi dhe për t'i mbajtur ato si të ekzekutueshme në përputhje me kushtet e tyre, duke përfshirë të gjitha (i) depozitimet dhe regjistrimet, (ii) pagimin e tarifave dhe shpenzimeve të tjera, (iii) lëshimin e dokumentave të tjerë plotësues, (iv) shkarkimin nga të gjitha pretendimet apo pengesat që prekin të drejtat e Bankës në lidhje me të drejtat pasurore të Kontratës së Hipotekës (v) publikimet apo njoftimet për palët e treta, dhe (vi) depozitimet e dokumentave mbi titujt e të drejtave.
  - Kredimarrësit detyrohen të qarkullojnë të gjithë aktivitetin e tyre financiar nga biznesi dhe cdo aktivitet tjetër të lidhur me këtë nepermjet llogarive pranë Raiffeisen Bank sh.a. Kushti nuk do të konsiderohet i plotësuar nëse Kredimarrësit krediton dhe debitojnë të gjithë shumën në llogari brenda një afati 15 dite pune.
  - Kredimarrësi detyrohet dhe garanton të lejojë dhe të krijojë të gjithë mundësitë për Bankën dhe Palet e Interesuara që të kryejnë monitorimin , kontrollin dhe auditimin dhe të mundësojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që evidentojnë përdorimin e fondeve të kredisë për qëllimin dhe sipas kushteve të percaktuara në këtë kontratë dhe në përputhje me Garancinë në kuader të Projektit për Zhvillim dhe Inovacion të Sipërmarrjeve të Ballkanit Perëndimor .Kredimarrësi në plotësim të sa percaktuar më sipër do të lejojë Bankën dhe Palet e Përfshira të njihen me të dhenat financiare për

evidentimin e aktivitetit tregtar dhe te vizitohet dhe / ose inspektojne e rivleresojne te gjitha mjediset e biznesit ku ai ushtron aktivitetin e tij .

- e) Kredimarrësi do të përdore fondet e perfituara nga kjo kredi vetëm për realizimin e qëllimit të financimit të përcaktuar në këtë kontratë.
- f) Kredimarrësi është i detyruar të paguajë të gjitha shpenzimet për noterizimin e kontratave, regjistrimin pranë regjistrimit të Barreve Siguruese apo Zyres së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme si dhe çdo shpenzim tjetër ligjor që mund të lindë gjatë zbatimit të kësaj kontrate.
- g) Shpenzimet për vlerësimin e pronave dhe sendeve që shërbejnë si garanci për linjat e kredive do të konsiderohen si shpenzime të kredimarrësit dhe do të paguhet nga klienti, sa herë që banka do të kërkojë një raport vlerësimi. Kjo pagesë do të bëhet pas dorëzimit të raportit të vlerësimit nëpërmjet bankës tek vlerësuesi i licensuar dhe i kontraktuar prej saj. Kredimarrësi pranon që raporti i vlerësimit do të shërbejë ekskluzivisht për nevojat e bankës dhe vlerat e pronave dhe sendeve janë të vlefshme vetëm për kohën në të cilën raporti i vlerësimit është kryer. Kredimarrësi, me kërkesë të tij, mund të pajiset nga banka me informacion mbi vlerësimin e kolateralit . Palet pranojnë që ky vlerësim nuk mund të shërbejë si prove në ndonjë proces gjyqësor të mundshëm ndërmjet paleve, apo me zyrën e përmbartimit. Në rast se kredimarrësi nuk ka gjendje në llogarinë e tij për të kryer pagesën e tarifës së vlerësimit, banka do të kryejë gjithsesi pagesën brenda afatëve të kërkuara me iniciativë dhe do të rimburohet qoftë edhe duke debituar llogarinë e kredimarrësit nëse nuk ka gjendje kreditore. Njofimi për këtë detyrim do të dërgohet kredimarrësit nga Banka me postë të thjeshtë ose elektronike në adresën e deklaruar prej tij.
- h) Kredimarrësi do të sigurojë pranë shoqërisë së sigurimit të miratuar nga banka pronën e tij të vendosur si kolateral në favor të Bankës të paktën për vlerën e kredisë, dhe do të rinovojë çdo vit policën e sigurimit. Kredimarrësi do të vendosë Bankën si përfituese të këtyre policave të sigurimit dhe do të paraqesë në Bankë kopje të rinovuara të policave të sigurimit 30 (tridhjetë ditë) ditë para afatit të mbarimit të tyre, për çdo vit. Në rast se kredimarrësi nuk kryen rinovimin e policës së sigurimit në afatin e kërkuar, banka ka të drejtë të debitojë llogarinë e kredimarrësit për vlerën e primit të sigurimit dhe të bejë sigurimin e pronës pranë shoqërisë së sigurimit. Në rast se kredimarrësi nuk ka gjendje në llogarinë e tij për të kryer pagesën e primit të sigurimit, banka do të kryejë gjithsesi sigurimin brenda afatëve të kërkuara me iniciativë dhe kredimarrësi detyrohet të rimburojë menjëherë Bankën, për vlerën e primit të sigurimit të paguar prej saj si rrjedhojë e mospagesës së primit në kohë nga ana Kredimarrësit.
- i) Ortaku i vetëm dhe/ose administrator i shoqërisë kredimarrëse, garanton se në rast se kërkohet nga Banka do të sigurojë pranë shoqërisë së sigurimit të miratuar nga banka jetën e tij në favor të Bankës, dhe do të rinovojë policën e sigurimit të jetes çdo vit, në mënyrë të kënaqshme për Bankën. Kredimarrësi do të vendosë Bankën si përfituese të shumës së sigurimit dhe do të paraqesë në Bankë kopje të rinovuara të policave të sigurimit 30 (tridhjetë ditë) ditë para afatit të mbarimit të tyre për çdo vit. Në rast se kredimarrësi nuk kryen rinovimin e policës së sigurimit në afatin e kërkuar, banka ka të drejtë të debitojë llogarinë e kredimarrësit për vlerën e primit të sigurimit dhe të bejë sigurimin e jetes pranë shoqërisë së sigurimit. Në rast se kredimarrësi nuk ka gjendje në llogarinë e tij për të kryer pagesën e primit të sigurimit, banka do të kryejë gjithsesi sigurimin brenda afatëve të kërkuara me iniciativë dhe kredimarrësi detyrohet të rimburojë menjëherë Bankën, për vlerën e primit të sigurimit të paguar prej saj si rrjedhojë e mospagesës së primit në kohë nga ana Kredimarrësit.
- j) Në rast se Kredimarrësi dhe ortaku ka siguruar me pare garancite dhe jetën e tij, Banka ka të drejtë të kërkojë transferimin e kontratave të sigurimit në favor të Bankës. Kredimarrësi pranon që çdo kompensim që rrjedh nga kontratat e sigurimit të kalojnë Bankës deri në masën e kërkuar për shlyerjen e detyrimeve të papaguara nga Kredimarrësi dhe ai nuk do të ketë të drejta mbi të.
- k) Kredimarrësi është i detyruar të paguajë rregullisht kredinë deri në shlyerjen e plote të saj si dhe çdo shumë të terhequr në tejkallim të limitit të miratuar, së bashku me të gjitha interesat dhe penalitetet e përcaktuara në Nenin 5 të kësaj kontrate.
- l) Kredimarrësi është i detyruar të lejojë Bankën ose përfaqësuesit e saj të njihet me të dhenat financiare për evidentimin e aktivitetit tregtar dhe të vizitohet dhe / ose inspektojne e rivleresojne te gjitha mjediset ku ai ushtron aktivitetin e tij. Kredimarrësi bie dakort të mos lere si garanci për asnjë institucion financiar dhe të trete asnjë nga garancite e ofruara në favor të Raiffesisen Bank për sigurimin e detyrimeve dhe asnjë nga asetet e regjistruara në emer të tij ( negative pledge clause).
- m) Kredimarrësi detyrohet dhe garanton që brenda 2 (dy) muajve nga data e disbursimit të pare të kësaj linje kredie bankare të paraqesë pranë bankës dokumentacionin e nevojshëm të autobuzave të rinj që do të blihet në mënyrë që banka të kryejë dhe të perfundojë raportin e vlerësimit të tyre si dhe të bejë bllokimi e autobuzave vetëm në favor të Raiffeisen Bank sha. Përfaqësuesit e bankës do të monitorojnë përbushjen e këtij kushti.
- n) Në rast se kredimarrësi kërkon të rinovojë limitin e kredisë për 12 muajt pasardhës, detyrohet të paraqesë në bankë 30 ditë përpara përfundimit të çdo periudhe 12 mujore pasqyrat financiare të vitit të mëparshëm financiar, dokumenta ligjore të rinovuara të statusit ligjor të shoqërisë dhe të garancive të vendosura si kolateral sipas pikes 6.01. Gjithashtu kredimarrësi bie dakord me faktin që kredidhënesi mund të kërkojë në këto raste rivlerësim të asetëve të vendosura si garanci me

shpenzimet e kredimarresit. Ne rast se gjate rishikimit te situates financiare dhe ligjore te kredimarresit sipas parashikimeve te pikes 3.01 te kesaj kontrate vertetohen se ka ndodhur nje ose te gjitha ndryshimet si me poshte :

- Qarkullimi ne llogarine e kredise me RBAL ne gjate periudhes 12 mujore ka qene me pak ne vlere totale se shumja e kredise e percaktuar ne nenin 2.
- Vlera e pasurive te vendosura si garanci sipas nenit 6 pika 6.01 ka rene nen vlerat e mbulimit te kerkuara nga banka sipas politikave te brendshme te financimit dhe rregulloreve te Bankes se Shqiperise ne fuqi.
- Gradimi i kredimarresit dhe/ose kredimarresit ( customer rating) sipas sistemeve te brendshme te gradimit te bankes ne baze te te cilave klienti dhe/ose klientet jane klasifikuar per te marre kredi eshte perkeqesuar me dy nivele.

kredidhenesi automatikisht i kerkon kredimarresit dhe/ose kredimarresve kthimin e gjithe shumave qe ai i detyrohet kredidhenesit sipas kontrates se kredise kufi.

7.2 Kredimarresi dhe/ose kredimarresve per sa kohe nuk ka shlyer detyrimin monetar apo detyrime te tjera te kerkuara nga Banka, detyrohet te njoftoje banken dhe te marre miratimin e saj paraprak me shkrim ne rastet e meposhtme:

- a) Perpara se te kryeje ndryshime ne strukturen organizative apo te biznesit te tij, ndryshime ne pronesine e aksioneve te shoqerise, te ndryshoje adresen e tij/seline apo cdo ndryshim ne statutin e shoqerise dhe ne organet drejtuese te saj.
- b) Perpara se te marre persiper detyrime te tjera monetare ose te marre kredi para prane nje banke tjeter, nje institucioni financiar apo te tjere ne cfaredo lloj forme ose te garantoje detyrime te nje subjekti te trete (institucion financiar apo te tjere).
- c) Perpara se te bleje pjeserisht ose plotesisht prona te nje subjekti te trete ose te beje kapitalizimin e ri te mjeteve te tij financiare.
- d) Perpara se te shese apo te jape me qira mjete kryesore te nevojshme per ecurina normale te aktivitetit te tij.
- e) Perpara se te beje ndonje financim direkt apo indirekt per palet e lidhura (aksioneri, bashkeshortet e tyre apo ndonje shoqeri tjeter e zoteruar apo kontrolluar prej tyre) nepermjet transakcioneve tregtare apo financiare.

7.3 Kredimarrësi siguron Kredidhenesin qe:

- 7.3.1 ne perdorim te disbursimeve te Kredise do te respektojë legjislacionin për mbrojtjen Mjedisore dhe Sociale ne fuqi kohe pas kohe;
- 7.3.2 do të pajiset, do të mbajë dhe do të sigurojë përputhshmërinë me të gjitha Lejet Mjedisore, Sigurise Sociale, Masa te shendetit dhe Sigurise ne Pune, Trajtimit te Ujerave , Ndotjes dhe Lejeve te tjera të kërkueshme per ushtrimin e aktivitetit te tij si edhe do të kryeje të gjithë veprimet e arsyeshme përpara ndryshimeve të ardhshme të njohura apo detyrimeve sipas këtyre;
- 7.3.3 do të zbatojnë procedura për monitorimin e përputhjes me dhe parandalimin e lindjes së përgjegjësisë sipas legjislacionit mjedisor dhe ate social;

Kredimarrësi siguron qe menjëherë me marrjen dijeni të faktit do të njoftojë me shkrim Kredidhenesin, për

- (i) çdo Pretendim Mjedisor apo social kundër tij aktual, në proces apo i mundshëm; dhe
- (ii) çdo fakt apo rrethanë që në mënyrë të arsyeshme mund të shkaktojë ngutjen apo mundësinë e ngritjes së një Pretendimi Mjedisor apo social kundër tij;
- (iii) Kredimarresi duhet të njoftojë menjëherë Bankën për çdo ngjarje apo kusht i cili mund të ketë një Efekt Material Negativ mbi aktivitetin, biznesin e Kredimarresit, veprimet dhe kushtet financiare apo aftësinë e Kredimarresit për të kryer ndonjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate; dhe i çdo incidenti ose aksidenti në lidhje me Kredimarresin ose objektin e financimit që ka të ngjarë të ketë një efekt material mbi mjedisin, shëndetin ose sigurinë apo ndonjë ndryshimi të propozuar në natyrën e aktivitetit apo biznesit ose operationeve të Kredimarresit ose ndonjë pretendim sipas ndonjë politike sigurimi dhe kur pretendimi që ngrihet kundër tij, në rast se për të merret një vendim negativ, ka apo në mënyrë të arsyeshme mund të ketë Efekt Material Negativ.

Te gjithe parashikimet e pikes me siper do te zbatohen dhe Kredimarresi merr persiper qe do te marre te gjithe masat per te ushtruar veprimtane e tij ne perputhje me kerkesat e legjislacionit shqiptar dhe te Dokumentacionin e shoqerise, aktivitetit dhe Licensat.

7.4 Mosplotesimi i nje prej kushteve te percaktuara ne kete kontrate kredie me kufi nga ana e kredimarresit pervec se konsiderohet rast mospermbushje ne kuptim te nenit 9 te kesaj Kontrate, do te shoqerohet me rritjen e menjehershme te normes se interesit te percaktuar ne nenin 5 pika 5.3 te kesaj kontrate Kredie me Kufi, me + 0.5 % ( zero pike pese perqind) ne momentin e konstatimit te kushtit te thyer.

## NENI 8: TE DREJTA DHE DETYRIME TE DOREZANESIT

- 8.1 Dorezanesi garanton pa rezerva Banken se do te pergjigjet para saj per permbushjen e detyrimit total te Kredimarresit, ne rast se Kredimarresi nuk permbush detyrimet e tij, me cdo pasuri te tij te luajtshme, te paluajtshme, me cdo llogari apo depozite te tij bankare dhe jo duke u kushtezuar vetem ne keto;
- 8.2 Dorezanesi eshte i detyruar solidarisht me kredimarresin kryesor pa kushte dhe ne menyre te pakthyeshme per ekzekutimin e detyrimit si dhe per njohjen dhe permbushjen e te gjitha parashikimeve te kesaj kontrate
- 8.3 Dorezanesi pergjigjet per aq sa detyrohet Kredimarresi, duke perfshire edhe pagimin e kamates, shperblimin e demit te shkakuar nga vonesa e ekzekutimit dhe te shpenzimeve te tjera gjyqesore, perbarimore etj, qe ka bere Banka ne lidhje me kete kredi.
- 8.4 Kerkesa e pare e Bankes nuk i neshtrohet faktut nese Kredimarresi duhet te kryejte te gjitha veprimet e nevojshme te kerkuara nga Banka per ekzekutimin e detyrimit, pasi pavaresisht nga kjo dorezanesi eshte i detyruar ti pergjigjet kerkesave te bankes njesoj si kredimarresi.
- 8.5 Dorezania nuk perfundon me ripagimin pjesor te detyrimit nga Kredimarresi, per aq kohe sa kontrata e kredise eshte ne fuqi.
- 8.6 Detyrimi i Dorezanesit zvogelohet proporcionalisht me zvogelimin e detyrimit te Kredimarresit.
- 8.7 Dorezanesi detyrohet te njoftoje Banken per cdo ndryshim te adrese se tij.

## NENI 9: MOSPËRMBUSHJA E DETYRIMEVE DHE ZGJIDHJA E KONTRATES

- 9.1 Pervec sa eshte parashikuar ne Aneksin 4 kjo Kontrate Kredie ne Kufi mund te zgjidhet menjehere nga Banka apo Kredimarresi nepermjet nje njoftimi te shkruar te zgjidhjes qe i paraqitet pales tjetere ne kete Kontrate. Banka gjithashtu mund te kanceloje limitin e paperdorur te shumës se kredise edhe pse Banka mund te mos kete disbursuar per kredimarresin te gjithe shumen e kredise me kufi ne llogarinë e tij rrjedhese apo nese rezultojne pjese te paperdorura te limitit te kesaj kredie. Kjo zgjidhje nuk do te ndikojte ne detyrimet dhe te drejtat respektive te Kredimarresit ne lidhje me detyrimet e deriatehershme.
- 9.2 Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate mosplotësimi i ndonje prej neneve te kësaj Kontrate dhe i kontratave te tjera te cilat konsiderohen pjese integrale e saj do të konsiderohet si mospermbushje e Kontrates. Rastet e mospermbushjes jane rastet ne te cilat bankes i lind e drejta te zgjidhe kontraten dhe kredimarresi/bashkekredimarresi dorezanesi detyrohen te kthejne menjehere te gjithe detyrimin qe kane ndaj bankes. Kjo Kontrate Kredije ne Llogarinë Rrjedhese mund te zgjidhet nga Banka, sipas gjykimit te saj, pa lajmerim te shkruar te Kredimarresit, ne rast se verifikohet nje nga rrethanat e meposhtme.

Raste te mospermbushjes do të përfshijnë por nuk do të kufizohen ne:

- a) Nëse Kredimarresi vazhdimisht e tejkalon kufirin e aprovuar të Linjës së Kredisë;
- b) Pushojne se egzistuarit dhe/ose jane shkeluar kriteret e pranimit dhe deklarimet e kredimarresit ne baze te te cilave eshte realizuar financimi sipas kesaj kontrate kredie, financim i cili është mundësuar falë mbështetjes së Bashkimit Europian në kuadër të Programit për Zhvillim dhe Inovacion të Sipërmarrjeve të Ballkanit Perëndimor
- c) Nëse Kredimarresi nuk e ka minimumin e shumës së parave qarkulluese përmes llogarisë së tij rrjedhese të Linjës së aprovuar të kredisë.
- d) Nëse Kredimarresi nuk e kthen shumën e plotë të Linjës së Kredisë në fund të periudhes se parashikura ne nenin 2 te kesaj kontrate, apo cdo shume tjetere nga cdo kontrate tjetere qe kredimarresi ka lidhur me banken. Palet konsiderojne detyrim te pashlyer sipas kesaj kontrate te gjithe shumen e kredise, interesat e papaguara te kontrates bashke me interesat debitore, te gjithe komisionet e tjera te pagueshme per marrjen e kredise, respektimin e kontrates dhe ato per venien ne ekzekutim te kontrates derisa banka te kete rimarre ne llogarite e saj te gjithe kete shume.
- e) Falsifikimi, paraqitja e informacioneve mashtruese, fshehja e informacioneve nga Kredimarresi dhe Dorezanesi në mënyrë verbale ose të shkruar, ndonjë deklarate, paraqitja e planeve të biznesit, prezentimi financiar që mund të rrezikoj pozitën kolaterale të Bankës ose kthimin e plotë të detyrimit të Kredimarresit dhe Dorezanesit;
- f) Nese Kredimarresi dhe/ose Dorezanesi ndodhen ne nje nga ngjarjet me efekt material negativ;
- g) Çfarëdo aktiviteti i paligjshem i Kredimarresit;

- h) Kredimarrësi dhe/ ose secili per personave nenshkruer te kontrates është shpallur fajtor për mashtrim (duke përfshirë çdo mashtrim me çështjet interesave financiare të BE-së) nga një Gjykatë Kompetente (vendase ose e një prej vendeve të Bashkimit Europian) në lidhje me këtë kontratë por jo duke u kufizuar vetëm me të. Kredimarrësi dhe cdo person tjetër nenshkruer i kontrates njofton menjëherë Kreditorin sapo merr dijeni apo behet i vetedijshëm për një gjykim të tillë dhe kthen menjëherë të gjitha shumat e paguara dhe të perfituara sipas kësaj kontrate kredie.
- i) Mospërbushja e ndonjë prej detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë dhe në cdo kontratë dhe në cdo Kontratë tjetër të lidhur ndërmjet paleve, ose në ndonjë ligj tjetër;
- j) Në rast se me urdher apo autorizim të Shtetit apo qeverisë (i) drejtimi I Kredimarrësit zëvendësohet pjesërisht apo totalisht dhe/ose pushteti i tij për të vazhduar biznesin apo veprimet e Kredimarrësit kufizohet pjesërisht apo totalisht, (ii) kapitali I Kredimarrësit ose teresia e të ardhurave dhe/ose pronave të Kredimarrësit konfiskohen ose përndryshe shpronësohen;
- k) Ka ndodhur një ndryshim rrenjesor në strukturën e tanishme të kapitalit të Kredimarrësit për sa i përket kontrollit të pjesëmarrjes së shumicës;
- l) Kredimarrësi pranon në formë të shkruar pamundësinë për të paguar ose që nuk do të jete në gjendje të paguajë borxhet në datën e caktuar, ose falimenton, ose paraqet cdo kërkesë ose ndermerr një veprim për lehtësim I aplikueshem sipas ndonjë ligji për falimentim, riorganizim, paafesi paguese ose moratorium;
- m) Fillojnë procedura për riorganizim, shkritje ose likuidim të Kredimarrësit (përveç rasteve kur ka aftësi paguese dhe në terma paraprakisht të miratuara me shkrim nga Banka) ose për përcaktimin e një marrësi, kujdestari apo nepunësi të ngjashëm për cdo apo të gjitha të ardhurat dhe pronat e Kredimarrësit;
- n) Kredimarrësi nderpret apo kercenon të nderprejë veprimet e tij ose, përveç se kur perben një veprim normal të biznesit, shet, jep me qera, transferon ose përndryshe tjeterson të gjitha apo pjesë të pronave të tij (qofte me një veprim të vetëm apo me disa veprime) ose të gjitha apo pjesë të pronave të tij sekuestron apo përvetesohen nga apo për llogari të cdo autoriteti qeveritar apo të ndonjë lloji tjetër ose merren në mënyrë të detyrueshme.
- o) Kredimarrësi përfshihet në një Çështje Ligjore/Gjyqësore që ka lidhje me Ortaket.
- p) Kredimarrësi përfshihet në një Çështje Ligjore/Gjyqësore që ka të bëjë me Fuqitë e Perfagesimit që i jepen administratorit/administratoreve të Kompanisë;
- q) një urdher apo vendim i gjykatës kundër Kredimarrësit e konsideron atë si të falimentuar apo të paafte për të paguar ose urdhëron për shpërndarjen apo likuidimin e veprimtarisë së tij tregtare; apo depozitimi i një kërkesë për shpallje falimentimi ose për procedura administrimi për Kredimarrësin sipas legjislacionit të zbatueshëm; apo Kredimarrësi fillon procedurat e falimentimit ose të deklarimit si subjekt pa aftësi paguese, ose jep miratimet e nevojshme për fillimin kundër tij të procedurave të falimentimit ose të deklarimit si subjekt pa aftësi paguese, ose depoziton një kërkesë apo përgjigjet apo miraton depozitimin e një kërkesë të tillë për emërimin e likuidatorit ose administratorit të falimentimit ose pranon me shkrim për pamundësinë e tij për shlyerjen e detyrimeve në afat; ose cdo ngjarje tjetër i cili sipas legjislacionit të zbatueshëm ka të njëjtin efekt me ngjarjet e cituara në këtë Nen.
- r) Çdo rast i mospërbushjes nga ana e Kredimarrësit do të konsiderohet si mospërbushje e Dorezanesit dhe Banka do të ketë të njëjtat të drejta për kerkim të detyrimit ndaj dorezanesit siç janë përcaktuar sipas Nenit 10 të kësaj Kontrate. Këto të drejta përfshijnë por nuk kufizohen me marrjen në posedim dhe shitjen e ndonjë apo gjithë kolateralit siç është përcaktuar në Nenin 6 dhe Kontraten e (Hipotekes, Marrëveshjes Siguruese apo cfare doloj tjetër mjeti sigurimi ligjor).

9.3. Në rast se ndodh apo vazhdon të ekzistojë qofte edhe vetëm një Rast Mospërbushje, Banka ka të drejtë të ndermarre të gjitha veprimet që ajo i gjykon të arsyeshme dhe / ose kerkojë zgjidhjen e kontrates dhe rikthimin e kryegjese dhe interesave të akumuluar, si dhe cdo shume të tjetër të perlllogaritur dhe të paguashme ndaj saj.

Në rast se nuk realizohet kthimi vullnetarisht nga klienti i të gjitha shumave që i detyrohet bankes si me lart, banka ka të drejtë:

- a) T'i drejtohet gjykatës për leshimin e urdherit të ekzekutimit sipas nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile.
- b) Të fillojë ekzekutimin e detyrueshem të kredise.
- c) Edhe gjatë ekzekutimit të detyrueshem, kredimarrësit do të vazhdojnë t'i llogariten interesa dhe penalitete sipas kësaj kontrate kredie bankare deri në kthimin e plote të të gjitha shumave që ai i detyrohet bankes.

9.4 Të gjitha kostot dhe shpenzimet administrative, gjyqësore, noterizimeve, komisioneve, tarifave për negociimin, perfundimin e mbarevajtjes dhe ekzekutimin e të drejtave të Bankes, përfshirë kolateralin sipas kontrates së hipotekes, perballohen nga Kredimarrësit/Hipotekuesi/Dorezanes.

#### NENI 10: SIGURIMI I PAGESËS SE KREDISE

10.1 Kredimarrësi do të sigurojë prane shoqërisë së sigurimit të miratuar nga banka pasurite e tij të luajtshme të paluajtshme të vendosur si kolateral në favor të Bankës të pakten për vlerën e kredise, dhe do të rinovojë çdo vit policën e sigurimit. Kredimarrësi do të vendosë Bankën si përfituese të këtyre policave të sigurimit dhe do të paraqesë në Bankë kopje të rinovuara të policave të sigurimit 30 (tridhjetë ditë) ditë para afatit të mbarimit të tyre, për çdo vit. Në rast se kredimarrësi nuk kryen rinovimin e policës së sigurimit në afatit e kërkuar, banka ka të drejtë të debitojë llogarinë e kredimarrësit për vlerën e primit të sigurimit dhe të bejë sigurimin e pronës prane shoqërisë së sigurimit. Banka këtë të drejtë e ushtron me iniciativën e saj pa qenë nevoja të marrë miratim të metejshëm, jo vetëm në rastet kur llogaritë e klientet kanë gjendje kreditore, por dhe në rastet kur llogaria/te nuk kanë gjendje të mjaftueshme apo nuk kanë fare gjendje kreditore. Në keto raste, llogaria e kredimarrësit për shumën që i perket primit të sigurimit, konsiderohet si overdraft i paautorizuar dhe kredimarrësi detyrohet jo vetëm të paguajë shumën por dhe interesat e publikuara në kushtet e punës së bankës për overdraftin e paautorizuar.

10.2 Kredimarrësi, Hipotekuesi pranon që çdo kompensim dhe/apo demshperblim që rrjedh nga polica e sigurimit të kredise të kalojë Bankës dhe ai nuk do të ketë të drejtë mbi të.

10.3 Kredimarrësi bie dakort që Banka t'i verë në dispozicion shoqërisë së sigurimit të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm të kredise/ kredimarrësit, përfshirë dhe dokumentacionin e një kolaterali të dytë që mund të zvendesoje kolateralin e vendosur sipas kësaj kontrate, për efekt të marrjes në sigurim dhe pagimit të shumës së sigurimit në rast se ndodh ngjarja e sigurimit.

10.4 Në rast të një shtese të mevonshme të shumës së kredise, kredimarrësi do të paguajë primin shtese të sigurimit të kredise me nënshkrimin të kontratës së re të kredise, në të kundërt shumën shtese e kredise nuk disbursohet.

10.5 Në rast të shlyerjes së parakohshme të kredise, kredimarrësi do të jetë përfitues i një pjese të primit të paguar, e cila do të perlllogaritë në atë moment nga shoqëria e sigurimit, në bazë të pjesës së mbetur të afatit të kredise.

10.6 Në rast se Kredimarrësi, Hipotekuesi dhe Shoqëria e Sigurimit janë në proces gjyqësor për probleme të kompesimit/demshperblimit sipas kësaj kontrate kredie atëherë të gjitha shpenzimet do të perballohen nga Kredimarrësi.

## NENI 11 – DEKLARIME DHE GARANCI

Kredimarrësi deklaron dhe garanton Bankën se:

- a. Kredimarrësi nuk është në shkëlqje të ndonjë dispozite të ndonjë kontrate në të cilën Kredimarrësi është palë, e cila do të kishte ndonjë efekt material mbi kushtet dhe aftësinë financiare të Kredimarrësit për të përmbushur detyrimet e tij në kuptim të kësaj Kontrate;
- b. Nuk ka asnjë procedim, kërkesë padi, proces ose hetim të çelur ose të ngjitur përpara ndonjë gjykate ose autoriteti qeveritar, vendas ose të huaj, ose për aq sa ka dijeni Kredimarrësi - pas verifikimeve të kryera prej tij -, nuk ka ndonjë procedim, kërkesë padi, proces ose hetim që e kërcënon apo është paraqitur kundër Kredimarrësit, ose ndonjë pasurie të tij ose të drejtë të tij, që do të kishin efekt material mbi kushtet dhe mundësinë financiare të Kredimarrësit për të përmbushur detyrimet e tij në kuptim të kësaj Kontrate;
- c. Të gjithë dokumentat, raportet, apo informacionet e tjera në formë të shkruar, të cilat i janë vënë në dispozicion Bankës nga Kredimarrësi janë të vërteta dhe të sakta dhe nuk përmbajnë ndonjë gabim në deklaram dhe këto akte nuk kanë lënë jashtë tyre ndonjë fakt material ose fakt të nevojshëm i cili krijon keqkuptime;
- d. Kredimarrësi ka kompetencat, autoritetin dhe zotësinë ligjore të nevojshme për të lidhur këtë Kontratë dhe ekzekutuar veprimet e parashikuara në të, në përputhje me termat e Kontratës së Kredise, dhe përfaqësuesit e Kredimarrësit janë autorizuar në mënyrë të rregullt për të nënshkruar këtë Kontratë në emër dhe për llogari të Kredimarrësit;
- e. Nënshkrimi, dorëzimi, dhe ekzekutimi i kësaj Kontrate Kredie nga Kredimarrësi është autorizuar në mënyrë të rregullt dhe të saktë me të gjitha aktet e nevojshme të Kredimarrësit, dhe përveç rasteve kur është parashikuar shprehimisht në këtë Kontratë, nuk do të kërkohet autorizimi, miratimi, heqja dorë, licenca, caktimi apo autorizimi, deklarimi, njoftimi për regjistrim në ndonjë person ose autoritet publik, dhe nuk përbën dhe nuk do të përbëjë ndonjë shkëlqje ose mospërmbushje në kuptim të ndonjë detyrimi të mëparshëm të Kredimarrësit;
- f. Kredimarrësi pranon se Fondi Europian i Investimit ("EIF"), agjentët e EIF, Zyra Europiane e Auditorëve ("ECA"), Komisioni dhe agjentët e Komisionit (duke përfshirë Zyrën Europiane Kundër Mashtrimit ("OLAF ") dhe çdo institucion tjetër i Bashkimit Europian ose pjesëtar i Bashkimit Europian i cili ka të drejtë të verifikojë përdorimin e garancisë në kuadër të Projektit për Zhvillim dhe Inovacion të Sipërmarrjeve të Ballkanit Perëndimor dhe çdo palë tjetër e autorizuar në bazë të ligjit në fuqi i cili ka të drejtë të auditojë ose monitorojë aktivitetet (të gjithë së bashku, "Palët e Interesuara") do të ketë të drejtë të kryejë kontrolle dhe të kërkojë informacion në lidhje me këtë marrëveshje dhe zbatimin e saj. Kredimarrësi do të lejojë inspektimin e aktivitetit operacional të biznesit dhe të pasqyrave e të dhënave financiare nga secila prej Palëve të Interesuara. Meqenëse këto kontrolle mund të përfshijnë monitorime të rastësishme, Kredimarrësi do të lejojë aksesin në ambjentet e biznesit, gjatë orëve normale të punës për secilën nga Palët e Interesuara.

- g. Kredimarrësi si dhe të gjitha palet nenshkruese të kontratës autorizojnë dhe lejojnë Bankën që t'i mundësojë Paleve të Interesuara cdo dokument ose informacion në lidhje me veten e tij dhe/ose financimin sipas kësaj kontrate
- h. Kredimarrësi angazhohet, që (i) në çdo kohë do të jetë dhe do të veprojë në të gjitha aspektet në përputhje me standardet përkatëse dhe legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave, luftën kundër terrorizmit dhe mashtimit tatumor për të cilin ai mund të jetë subjekt dhe (ii) të mos të jetë i themeluar apo të mos vendoset vullnetarisht nën juridiksionin e një shteti i cili konsiderohet si jo bashkepunues me ndonjë nga Palet e Interesuara dhe/ose kategorizohet nga ndonjë prej Paleve të Interesuara si një juridiksion i cili nuk është në përputhje me politikën / legjislacionin fiskal të Paleve të Interesuara (përveç rasteve kur kjo vjen si rezultat i një ngjarje ose rrethana që është përtej kontrollit të tij).
- i. (A) Kredimarrësi duhet që në cdo rast të veprojë në përputhje me të gjitha ligjet dhe aktet nenligjore (vendase si dhe ato të Bashkimit Evropian), për të cilat Kredimarrësi mund të jetë subjekt dhe, shkelja e të cilave mund të:
- (i) ndikojë negativisht në përmbushjen e detyrimeve të kësaj kontrate;
  - (ii) cenojë interesat e Kredidhësit dhe/ose Paleve të Interesuara;
- (B) Kredimarrësi nuk do të kryejë asnjë parregullsi apo mashtrim (përfshirë çdo mashtrim me çështjet interesave financiare të BE-së).
- Kredimarrësi deklaron, garanton dhe angazhohet se në cdo kohë do të jetë në përputhje me kriteret e pranimit me qellim nenshkrimit të kësaj Kontrate dhe se do të informojë me shkrim menjëherë Kredidhësin sapo të marrë dijeni dhe /ose behet i vetedijshëm për çdo shkelje të deklarimeve, garancive dhe angazhimeve të ndermarra nga ana e tij.
- j. Kjo Kontratë përbën titull ekzekutiv të vlefshëm për Kredimarrësin, të zbatueshëm kundrejt Kredimarrësit në përputhje me termat e saj.

## NENI 12: NJOFTIMI ZYRTAR MIDIS PALEVE

- 11.1 Të gjithë njoftimet, komunikimet midis paleve të kësaj Kontrate do të behen me shkrim të dorëzuara personalisht nga punonjësit e Bankes ose me poste të thjeshte.
- 11.2 Njoftimet ndërmjet paleve do të dërgohen në adresat e depozituara prej paleve të shënuara në këtë kontratë apo në dosjen përkatëse të Kredimarrësit.
- 11.3 Kur njoftimet dërgohen me poste konsiderohen të marra ditën e 4-t pas postimit të tyre.

## NENI 13: VERIFIKIMI DHE RAPORTIMI I TË DHENAVE

Palet në këtë kontratë bien dakord dhe deklarojnë si më poshtë: Duke kuptuar se, të dhënat tona demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nenligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar si dhe sekretin profesional si dhe për faktin se Banka Raiffeisen dhe Regjistri i Kredive të Bankes së Shqipërisë kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar trajtimin e sigurt të të dhënave të mesiperme:

Autorizoj Raiffeisen Bank që, për qëllimet që përfshijnë:


1. vlerësimin e aplikimit për të marrë kredi;
2. vlerësimin e rrezikut të kredisë gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies time kontraktore të kredisë me bankën Raiffeisen dhe/ose
3. vlerësimin e besueshmërisë time si person i lidhur me kredimarrësit,
4. financimin e kësaj kredie fale mbështetjes së Bashkimit Europian në kuadër të Programit për Zhvillim dhe Inovacion të

Sipërmarrjeve të Ballkanit

Perëndimor

të njihet me detyrimet e mia ndaj bankave/ degëve të bankave të huaja/ subjekteve kredidhënëse, nëpërmjet përdorimit të autorizuar të të dhënave/informacionit të Regjistrin të Kredive, në mënyrë që të vlerësojë sasinë e detyrimeve financiare, garancitë dhe besueshmërinë/ aftësinë për të shlyer detyrimet financiare. Gjithashtu, jap pëlqimin tim që banka Raiffeisen, të përdorë emrin dhe të dhënat e mia identifikuese dhe financiare që mbahen në Regjistrin e Kredive, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë

Ky autorizim konsiderohet i dhënë për të gjithë personat nenshkruar të kontratës, pra si për kredimarrësit dhe të dhënat e tyre, ashtu dhe për dorezuesit dhe apo hipotekuesit




## NENI 14 – NDALIMI I HEQJES DORE

Asnjë mënyrë sjellje dhe pamundësi ose vonesë e Bankës në realizimin e të drejtave, kompetencave ose mjeteve juridike, nuk do të konsiderohet si heqje dorë ose se bie ndesh me të drejtat, kompetencat ose mjetet juridike të vet Bankës. Asnjë e drejtë, kompetencë ose mjet juridik i Bankës nuk do të përjashtojë ndonjë të drejtë, kompetencë ose mjet juridik tjetër të cilësuar këtu ose që bëhet më pas e disponueshme nga ligji, praktika, aktet nënligjore e të tjera.

## NENI 15 : DISPOZITA TE FUNDIT

15.1 Kjo kontrate perben titull ekzekutiv.

15.2 Aneksë të kësaj kontrate janë :

- Aneksi 1 –sqanimet per NEI-n
- Aneksi 2 - Nje koment mbi huamarrjen ne valute dhe rritjen e normes se interesit gjate periudhes se kredise.
- Aneksi 3 - Forma e aplikimit te disbursimit
- Aneksi 4 - Ngjarja e Luhatjes se Tregut dhe norma e rifinancimit

15.3 Kjo Kontratë Kredie do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Palet do të zgjidhin me mirekuptim çdo konflikt që ka për bazë këtë kontratë, përndryshe kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë.

15.4 Kjo Kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga Noteri Publik.

15.5 Çdo amendament i kësaj Kontrate duhet të bëhet me shkrim dhe të nënshkruhet nga të gjitha palët në të njëjtën mënyrë si kjo Kontratë.

15.6 Marreveshja Siguruese dhe/ose Kontrata e hipotekimit janë pjesë integrale e kësaj Kontrate.

15.7 Kjo Kontratë Kredie nënshkruhet në prani të perkthyesit në 5 kopje, një për kredimarrësin, një për hipotekuesin, dy për bankën dhe një për noterin

## KREDIDHENES/BANKA:

Raiffeisen Bank SHA

Perfaqesuar nga

Erion BALLI

Rudina HORJETI

## KREDIMARRRES:

Shoqeria "TIRANA - URBAN - TRANS"sha

Perfaqesuar nga

Hazbi PARLLAKU

## BASHKEKREDIMARRRES:

Shoqeria "PARLLAKU" shpk

Perfaqesuar nga

Hazbi PARLLAKU

## DOREZANES:

Hazbi PARLLAKU

NOTER

**Aneks 1  
Kontrate**

**I. Banka ve ne dijëni kredimarrësin, si me poshtë vijon:**

- Norma e interesit për 12 muaj nga data e disbursimit të parë do të jetë Tribor 1Y + 2.5% vjetore, min 6.2% në vit.
- Për kredite afatgjata, pjesa e papaguar e kryegjese në fillim të kësaj periudhe është 12'000'000 ALL dhe në fund do të jetë \_\_\_.
- Për kredite me kufi, kufiri i kredisë do të jetë sa ai i përshkruar në nenin 2 të kontratës së kredisë me kufi.
- Me kërkesë të kredimarrësit, Banka i ve në dispozicion gjendjen e llogarise për çdo periudhë të kredisë që kërkohej.
- Interesat e kredisë me kufi llogariten çdo muaj mbi shumën e përdorur nga kredimarrësi.
- Në bazë të normës së interesit të parashikuar në nenin 1, plani i ripagimit të kredisë për Shoqërinë "TIRANA - URBAN - TRANS" sha Shoqërinë "Parllaku" shpk për 12 muajt e ardhshëm, duke përfshirë shumën e çdo kesti dhe datën e ripagimit do të jetë si më poshtë vijon:

Plani i Ripagimit:

**II. Norma Efektive e Interesit**

Në momentin e nënshkrimit të kontratës Norma Efektive e Interesit (NEI) është 7.21% % në vit. Megjithatë, Vlera e saktë e NEI-T do të shprehet në planin e amortizimit, i cili do të dorëzohet klientit pas disbursimit të kredisë.

**ANEKSI 2**

**Informacion mbi kredimarrjen në valute dhe i ndryshimin të normës së interesit**

I Nderuar Klient,

Me poshtë gjëni një koment mbi rrezikun që paraqet për ju :

▪ **Ndryshimi i Normës së Interesit**

Raiffeisen BANK sh.a., e përcakton normën e interesit të kredisë suaj bazuar tek Tribor/Euribor/Libor(1-vjeçar) për Kredite në ALL/EUR/USD/CHF/GBP.

TRIBOR është Norma e Interesit Nderbankar për LEKU-n. Kjo normë llogaritet nga Banka e Shqipërisë(BSH) dhe publikohet çdo ditë biznesi në orën 11(ora shqiptare).

EURIBOR është Norma e Interesit Nderbankar për EURO-n. Kjo normë llogaritet nga Federata Bankare Europiane(FBE) dhe publikohet çdo ditë biznesi në orën 11(ora belge).

LIBOR është Norma e Interesit Nderbankar për USD-n. Kjo normë llogaritet nga Interbank Londer dhe publikohet çdo ditë biznesi në orën 11(ora angleze).

Normat e Tribor/Euribor/Libor ndryshojnë çdo ditë pune bankare dhe mund të gjëni të publikuar edhe në sportelet e RBAL.

Ju kujtojmë se, në rast se ju merrni një Kredi në Raiffeisen BANK, kështu mund të ndryshojnë mbas afatit të përcaktuar në kontratën e kredisë. Norma e interesit të kredisë, mbas afatit të përcaktuar në kontratë, mund të jetë më e lartë se norma e interesit në ditën e lidhjes së kontratës së kredisë. Po kështu, dhe norma e interesit në rastin e « ngjarjes së luhatjes së tregut » mund të jetë më e lartë se norma e interesit në datën e lidhjes së kontratës.

▪ **kredimarrja në Valute**

Në rast se ju merrni një kredi në valute të huaja, kështu mund të paguhet në të njëjtën valute.

Nëse, nëse të ardhurat tuaja janë në Lek, duhet të keni parasysh që, për shkak të ndryshimeve të kursit këmbimit të valutave, në momente të caktuara mund të nevojiten më tepër LEK për të paguar koston tuaj.

Thëksojmë se, edhe pse vlerat e monedhave janë të qëndrueshme gjatë kësaj periudhe, ato mund të ndryshojnë ndjeshëm në të ardhmen.

Bazuar sa më lart, ju lutemi të merrni në konsideratë këto rreziqe përpara se të firmosni Kontratën tuaj të Kredisë.

Në rast se keni ndonjë pyetje rreth ndryshimit të normës së interesit apo rreth kredimarrjes në valute të ndryshme, mos hezitoni të pyesni Analistin e Kredisë. Në rast se ata nuk janë në gjendje t'ju përgjigjen pyetjeve tuaja, drejtohuni tek Drejtori i Degës.

**Deklaratë nga Kredimarrësi**

Une, \_\_\_\_\_ kam lexuar dhe diskutuar përmbajtjen e këtij dokumenti me Analistin e Kredisë. Une kuptoj dhe pranoj rrezikun e ndryshimit të normës apo rrezikun e kredimarrjes në valute.

Nënshkrimi i Kredimarrësit \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_

**KREDIMARRËS:**

Shoqëria "TIRANA - URBAN - TRANS" sha

Perfaqësuar nga

Hazbi PARLLAKU

*Hazbi Parllaku*

**BASHKËKREDIMARRËS:**

Shoqëria "PARLLAKU" shpk

Perfaqësuar nga

Hazbi PARLLAKU

*Hazbi Parllaku*

**DOREZANES:**

Hazbi PARLLAKU

*Hazbi Parllaku*



*[Handwritten signature]*

### ANEKSI 3 - FORMA E APLIKIMIT TË DISBURSIMIT

[Të shkruhet në Letër me Kokë të Kredimarrësit]

[Data]

Për: (Kredidhënësi -Emri dhe Adresa)

Subjekti:Nr. \_\_\_\_ i Aplikimit të Disbursimit

I/E Nderuar Zotëri/Zonjë:

1.Jeni të lutur t'i referoheni termave të Kontratës se Kredise datë \_\_\_\_ ("Kontrata e Kredise") ndërmjet \_\_\_\_ ("Kredimarrësi"), dhe ("Kredidhënësi).

2.Shprehjet e përkufizuara në Kontratën e Kredise do të kenë të njëjtin kuptim këtu.

3.Me anë të kësaj letre kërkojmë Disbursimin e mëposhtëm në përputhje me të gjitha dispozitat e Kontrates së Kredisë:

Monedha e kërkuar: [fut Monedhën e Kredisë]

Shuma (në shifra dhe me fjalë): \_\_\_\_\_

Banka : \_\_\_\_\_

Datë Valuta:

#### Udhëzimet e Pagesës (Detajet e Bankës së Kredimarrësit):

Emri i Llogarisë së Kredimarrësit: \_\_\_\_\_

Numri i Llogarisë së Kredimarrësit: \_\_\_\_\_

Emri i Bankës së Kredimarrësit: \_\_\_\_\_

Adresa e Bankës së Kredimarrësit: \_\_\_\_\_

#### Detajet e Bankës Korrespondente të Kredimarrësit:

Emri i Korrespondentes: \_\_\_\_\_

Adresa e Korrespondentes: \_\_\_\_\_

Emri i Llogarisë së Kredimarrësit: \_\_\_\_\_

Numri i Llogarisë së Kredimarrësit: \_\_\_\_\_

Referenca: \_\_\_\_\_

4. Për qëllimet e nenit 9 të Kontratës se Kredise, ne deklarojmë dhe garantojmë se:

- (a) të gjitha kontratat, dokumentet dhe instrumentet që i janë dorëzuar Kredidhënësit janë të pakushtëzuara, në fuqi dhe efekt të plotë;
- (b) deklaratimet dhe garancitë e bëra nga Kredimarrësi në Kontratat e Kredive dhe Kontratat e Garancive janë të vërteta, dhe që nga kjo date, me të njëjtin efekt sikur këto deklarime dhe garanci të ishin bërë në datën e kësaj kontrate;
- (c) nuk ka ndodhur dhe as është duke vazhduar ose është e pashmangshme ndonjë mosmarrëveshje;
- (d) Kredimarrësi, si rezultat i këtij Disbursimi, nuk do të shkelë Statutin, ndonjë dispozitë të kontratës ose dokument në të cilin Kredimarrësi është palë (duke përfshirë të Kontratën e Kredisë) ose me të cilën Kredimarrësi është i detyruar, ose ndonjë ligj në fuqi për Kredimarrësin;
- (e) nuk ka ndodhur asgjë që mund të ketë një efekt të pafavorshëm material mbi biznesin e Kredimarrësit, operacionet ose gjendjen financiare ose aftësinë e Kredimarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas Kontratës së Kredise ose Kontratave të Garancive; dhe
- (f) të ardhurat nga ky Disbursim janë të nevojshme nga Kredimarrësi për qëllimet e percaktuara në Kete Kontrate.

I Juaj Singërisht,

Kredimarrësi

Emri:

Titulli:



**ANEKSI 4 – Ngjarja e luhatjes se tregut dhe norma e rifinancimit**

**I Nderuar Klient,**

Me poshte gjeni nje koment sqarues ne lidhje me parashikimet e kesaj kontrate kredie ne rastet e ndodhjes se ngjarjes se luhatjes se tregut. Luhatjet e tregut dhe parapagimi i detyrueshem

- (a) Nese ndeshemi me nje Ngjarje te Luhatjes se Tregut ne lidhje me nje Kredi, ne cdo Periudhe Interesi, norma e interesit per kete kredi sipas Periudhes perkatese te Interesit do te jete norma ne perqindje per vit, e cila eshte shuma e:
- (i) Marzhi – i cili eshte perqindja e interesit mbi normen e publikuar te interesit ne Euro/USD/Leke e cila perfitohet nga banka;
  - (ii) norma qe Kredidhenesi i ka njoftuar Kredimarresit deri ne oren 12.00 sipas ores lokale, ne Diten e Kuotimit, perpara dites se pare te Periudhes perkatese te interesit, e cila shpreh si nje perqindje per vit, koston me te cilen Kredidhenesi eshte financuar ne tregun e parase nga palet e treta per financimin ne Euro/USD/Leke (me poshte “Norma e Interesit ne Luahjte te Tregut”); dhe
  - (iii) Shpenzimet e Detyrueshme, per pjesemarrjen e Kredidhenesit ne Kredi, nese ka te tilla;

Ne kete Kontrate “Ngjarje e Luhatjes se Tregut” do te thote:

- (i) ne ose rreth ores 12.00 sipas ores lokale ne Diten e Kuotimit, per Periudhen perkatese te Interesit asnje ose vetem nje Faqe ku publikohen Normat e Interesit do te jete e disponueshme per Kredidhenesin per te percaktuar Normen e Rifinancimit ose;
  - (ii) ne ose rreth ores 12.00 sipas ores lokale ne Diten e Kuotimit per Periudhen perkatese te Interesit, Kredidhenesi informon me shkrim Kredimarresin se shpenzimet per sigurimin e fondeve ne Euro/USD/Leke tejkalojne Normen e Rifinancimit.
- (b) Nese nje Ngjarje e Luhatjes se Tregut eshte deklaruar nga Kredidhenesi, dhe Kredimarresi ka njoftuar Kredidhenesin jo me vonë se ora 17.00 e ores lokale ne Diten e Kuotimit, nje dite para dites se pare te Periudhes perkatese te Interesit, qe **Norma e Interesit** e Luhatjes se tregut njoftuar nga Kredidhenesi ne vijim te paragrafit (a) (ii) me siper nuk eshte e pranueshme per te;
- (i) Kredimarresi duhet qe brenda 30 diteve nga dhenia e ketij njoftimi te mospranimi te normes se rifinancimit te parapaguaje pjesen e papaguar te Kryegjese, se bashku me interesat e perlogaritura sipas nenit 4, duke filluar nga dita e pare e Periudhes se Interesit deri ne ditën aktuale te parapagimit, si dhe gjithë shumat e tjera qe kredimarresi i detyrohet Kredidhenesit sipas kesaj kontrate; dhe
  - (ii) Angazhimi i Kredidhenesit sipas kesaj kontrate perfundon me efekt te menjehershem.
- (d) Nese Kredimarresi deshton ne njoftimin e Kredidhenesit sic ishte parashikuar ne afatin e percaktuar ne paragrafin (b) me siper, do te konsiderohet e pranuar Norma e Rifinancimit e Luhatjes se tregut, e njoftuar nga Kredidhenesi sipas paragrafit (a) (ii) me siper.

**Percaktimi i normes se rifinancimit**

Ne cdo periudhe rishikimi te normes se rifinancimit, kjo norma e interesit do te llogaritet si vlere aritmetike e normave te interesit te ofrimit te depozitave me afat te barabarte ose te krahasueshem me periudhen e interesit (e rumbullkosur deri ne 4 shifra pas presjes dhjetore), te tregur ne faqen : Reuters page: KLIEMMM, deri ne oren 11.00 sipas ores lokale, te dites se kuotimit.

**Dita e Kuotimit**, do te kuptohet dy dite pune para dites se pare te periudhes se interesit, ne te cilen do te percaktohet norma e rifinancimit, per periudhen pasardhese te interesit. Ne rast se dita e kuotimit eshte dite pushimi, si dite kuotimi do te merret dita pasardhese e punes, pas dites se kuotimit.

Ne rast se ne Diten e Kuotimit, ne faqen : Reuters : KLIEMMM, deri ne oren 11.00 sipas ores lokale, nuk jane te shfaqura normat e interesit, banka ka te drejte te aplikojë nje norme tjeter rifinancimi, sipas atyre te shfaqura ne faqe te tjera te cilat i ofrojne keto norma ne ditën e kuotimit.

Bazuar sa me lart, ju lutemi te merrni ne konsiderate keto rreziqe perpara se te firmosni Kontraten tuaj te Kredise.

Ne rast se keni ndonje pyetje rreth ketyre parashikimeve , mos hezitoni te pyesni Analistin e Kredise. Ne rast se ata nuk jane ne gjendje t'u pergjigjen pyetjeve tuaja, drejtrohuni tek Drejtori i Deges.

Deklarate nga Kredimarresi

Une, \_\_\_\_\_ kam lexuar dhe diskutuar permbytjen e ketij dokumenti me Analisti e Kredise. Une kuptoj dhe pranoj rrezikun e ndryshimit te normes se interesit ne kushtet e ndodhjes se ngjarjes se luhatjes se tregut.

Nenshkrimi i Kredimarresit \_\_\_\_\_

**KREDIMARRES:**

Shoqeria “TIRANA - URBAN - TRANS”sha

Perfaqsuar nga

Hazbi PARLLAKU

**BASHKEKREDIMARRES:**

Shoqeria “PARLLAKU” shpk

Perfaqsuar nga

Hazbi PARLLAKU

**DOREZANES:**

Hazbi PARLLAKU

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



Handwritten signature or initials.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA E NOTERISË TIRANE

REP. NR. 2062

KOL. NR. 95 / 13



### KONTRATË KREDIE BANKARE

Sot me datë 5/07/2017, para meje Alket Mancka, Notere Publike ne Dhomen e Noterise Tirane me adrese ne Rrugen Asim Ferri, u paraqiten personalisht palet:

#### KREDIDHENESI:

Raiffeisen Bank Sh.A., një bankë e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në Rruga e Kavajës, Tiranë, Shqipëri, dhe regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr.17426, datë 10.07.1997, me NIPT nr.J61911005B, e përfaqësuar nga përfaqësuesit e saj ligjor Z. Erion BALLI dhe Znj. Rudina HORJETI (këtëj e tutje, "Banka" ose "Kredidhenesi"); dhe

#### KREDIMARRESI:

Shoqëria "TIRANA - URBAN - TRANS" sh.a, e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tirane, me vendimin nr. 26697, datë 10.11.2001, NUIS K21407001A, date regjistrimi 07/02/2002 me seli ne Tirane, Rr. "Abdi Toptani" nr.5, e perfaqesuar ne baze te Vendimit te Keshillit te Mbikeqyrjes se Shoqerise nr.3257 rep, date 08.06.2017 nga administratori i shoqerise Z.Hazbi Parllaku (ketej e tutje kredimarres);

#### BASHKEKREDIMARRRES:

Shoqëria "PARLLAKU" shpk, e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tirane, me vendimin nr. 4104, datë 03.05.1993, NUIS J61826145P, date 03/05/1993 me seli ne adresen Petrele Mullet Objekt per ndertim, Godine nje kateshe, 10 km, ne rrugen Tirane - Elbasan, prane Lumit Erzen", Tirane, e perfaqesuar nga ortaku i vetem dhe administrator i shoqerise Z.Hazbi Parllaku (ketej e tutje Kredimarresi)

#### DOREZANES:

Hazbi Parllaku i biri i Selimit, dtl.12.06.1955, lindur ne Kukës dhe banues ne adresen Rr "Mihal Grameno", nr. 212, Tirane, identifikuar me leternjoftim nr. 031584869.

te cilet vendosin te lidhin kete kontrate me kushtet dhe termat e meposhtme, bazuar ne nenet 1031 e ne vijim, nenet, 560-584, 585-600 te K.Civil, Ligji per Barret Siguruese etj.

Banka dhe Kredimarresi këtëj e tutje do të quhen "Palët".

Financimi i dhënë Shoqëria "TIRANA - URBAN - TRANS" sh.a, sipas kesaj kontrate kredie është mundësuar falë mbështetjes së Bashkimit Europian në kuadër të Programit për Zhvillim dhe Inovacion të Sipërmarjeve të Ballkanit Perëndimor.

Përfaqësuesit ligjorë të Palëve kanë zotësi të plotë për të vepruar dhe unë Noteri vërtetoj identitetin e tyre. Palët kërkuar nënshkrimin e kësaj Kontrate Kredie Bankare (këtëj e tutje, "Kontrata").

#### NENI 1 – PËRKUFIZIMET

Nëse përmbajtja nuk e kërkon ndryshe, kudo që do të përdoren në këtë Kontratë, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

- |                               |   |
|-------------------------------|---|
| "Ditë Pune"                   | nënkupton, çdo ditë në të cilën bankat tregtare janë të hapura për veprime bankare të zakonshme.  |
| "Borxh"                       | nënkupton, të gjitha detyrimet e Kredimarresit, si në formën e kryegjësë ose interesit (dhe/ose interesit për mospërmbushje), qofshin këta aktual, të ardhshëm ose të rastit, për pagimin ose ripagimin e parave Bankës sipas kushteve të kësaj Kontrate. |
| "Afati Kamatvonesës"          | nënkupton, në lidhje me çdo shumë të pa-paguar sipas kësaj Kontrate, një periudhë që fillon nga dita në të cilën kjo pagesë bëhet e kërkueshme dhe që mbaron në ditën e fundit të muajit që vijon pas datës në të cilën pagesa bëhet e kërkueshme.        |
| "Disbursim"                   | nënkupton, disbursimin e një pjese të Kredise herë pas here në përputhje me Nenin 2 ose, siç mund t'a kërkojë përmbajtja, disbursimin e një pjese të shumës së kryegjësë të papaguar.   |
| "Rasti i Mospërmbushjes"      | nënkupton secilin prej rasteve ose ngjarjeve të parashikuara në Nenin 12.   |
| "Data e Pagimit të Interesit" | nënkupton Ditën e Parë të Punës që vijon pas mbarimit të Periudhës së Interesit.  |

"Peñudhë Interesi"	nënkupton, pëñudhën gratë së cilës zbatohet interesi kontraktor, pëñudhë e cila fillon nga data e Disbursimit së Kredise dhe që mbaron pas 1 (një) muaji kalendarik.
"Kredia"	nënkupton shumën maksimale të kredise parashikuar në Nenin 2 ose, siç mund t'a kërkojë pëmbajtja, shumën e kryegjëse së papaguar.
"Garanci"	nënkupton çdo hipotekë, peng, barrë siguroese, ose çdo mjet tjetër për sigurimin e detyrimit, të vendosur apo krijuar nga Kredimarrësi në favor të Bankës me qëllim garantimin e pëmbushjes së detyrimeve të Kredimarrësit sipas kësaj Kontrate.
"Marreveshje siguroese"	nënkupton çdonjëerën dhe të gjitha Kontratat ndërmjet Palëve të cilat vendosin apo krijojnë Garanci.
"Efekt material negativ"	nënkupton, në gjykimin e Kredidhenesit, çdo efekt, ngjarje, ose ceshtje, e cila është materialisht kundër: <ul style="list-style-type: none"> <li>(i) biznesit, aseteve, ose situatës financiare të Kredimarrësit/Dorezanesit; ose</li> <li>(ii) aftësia e kredimarrësit/dorezanesit për të pëmbushur detyrimet e tij sipas kësaj kontrate.</li> </ul>
"Garantor/Dorezanes"	nënkupton çdo person juridik apo fizik që ofron një garanci sipas parashikimeve të Nenin 585 e në vazhdim të Kodit Civil.
"Garancia"	Garancia e leshuar nga Fondi Europian i Investimeve në kuader të Programit për Zhvillimin dhe Inovacion të Sipërmarrjeve të Ballkanit Perëndimor
"Palet e Interesuara"	Fondi Europian i Investimit ("EIF"), agjentët e EIF, Zyra Europiane e Auditorëve ("ECA"), Komisioni dhe agjentët e Komisionit (duke përfshirë Zyrën Europiane Kundër Mashtimit ("OLAF ") dhe çdo institucion tjetër i Bashkimit Europian ose pjesëtar i Bashkimit Europian i cili ka të drejtë të verifikojë përdorimin e garancisë në kuadër të Projektit për Zhvillim dhe Inovacion të Sipërmarrjeve të Ballkanit Perëndimor dhe çdo palë tjetër e autorizuar në bazë të ligjit në fuqi i cili ka të drejtë të auditojë ose monitorojë aktivitetet
Kriteret e Pranimit	Nënkupton kriteret e përputhshmerisë dhe pranueshmerisë të aplikuara nga Banka për pranuar financimin e Kredimarrësit në kuader të Programit për Zhvillim dhe Inovacion të Sipërmarrjeve të Ballkanit Perëndimor

## NENI 2 – KREDIA, OBJEKTI , QELLIMI I SAJ DHE MENYRA E DISBURSIMIT

- 2.1 Në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate, Banka është dakord t'i japë Kredimarrësit një shumë prej **16'000'000ALL (gjashtëmbëdhjetë milion lek)**. Qëllimi i dhenies së kredise është për të financuar investim për blerje të 7 (shtate) autobuzave. Disbursimi i fondeve do të bëhet në llogari të kredimarrësit. Levrimi i fondeve do të bëhet me transferta bankare në drejtim të palet shitesë sipas kontratës së shitjes së nënshkruar mes paleve apo faturave perkatëse të cilat nuk duhet të jenë më të hershme se muaji Maj 2017.
- 2.2 Kredia do të disbursohet nga Banka për Kredimarrësin pasi ky të ketë plotësuar të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj kontrate kredie. Disbursimi i fondeve do të bëhet në llogari të kredimarrësit. Levrimi i fondeve do të bëhet me transferta bankare në drejtim të palet shitesë sipas kontratës së shitjes së nënshkruar mes paleve apo faturave perkatëse të cilat nuk duhet të jenë më të hershme se muaji Maj 2017.
- 2.3 Për qëllime të kësaj Kontrate, Kredimarrësi do të çelë dhe do të mbajë një llogari pranë Bankës, në të cilën do të disbursohet kredia dhe nga e cila do të debitoohen keshtet mujore. Në mënyrë alternative, Banka mund të disbursojë Kredinë në llogari të tjera sipas përshkrimit të Kredimarrësit në kërkesën për disbursim (me udhëzimet për transferimin e këtyre shumave, nën përgjegjësinë dhe me shpenzimet e Kredimarrësit, tek llogaritë e përcaktuara nga Kredimarrësi në kërkesën e tij për disbursim). Nëse Kredimarrësi nuk plotëson kushtet për disbursim sic parashikohet në nenin 3, brenda 6 (gjashtë) muajve nga dita e nënshkrimit përpara Noterit Publik, kjo kontrate do të jetë e pavlefshme nuk do të ketë vlerë ligjore për palet. Banka ka të drejtë të mos disbursojë pjesë të padisburuara të kredise nëse gjykon se kredimarrësi është në rastet e mospëmbushjes së parashikuara në Nenin 12 të kësaj kontrate ose situata financiare e kredimarrësit është përkeqësuar ndjeshëm.

## NENI 3 – KUSHTET PARAPRAKE PËR DISBURSIMIN FILLESTAR DHE CDO DISBURSIM

Përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe me shkrim, detyrimi i Bankës për të bërë Disbursimin e Kredise, sipas pëlqimit dhe diskrecionit të Bankës, i nënshtrohet pëmbushjes paraprake të kushteve të mëposhtme:

- a. Banka merr prova që vërtetojnë se Marreveshjet Siguruese janë plotësisht në fuqi dhe janë depozituar dhe regjistruar rregullisht; se Garancia është e vlefshme dhe efektive dhe se të drejtat e Bankës që rrjedhin nga Marreveshjet Siguruese janë të ekzekutueshme.
- b. Kredimarrësi siguron çdo dokument tjetër të kërkuar nga Banka dhe plotëson të gjitha kushtet e detyrueshme përpara disbursimit.
- c. Kredimarrësi paraqet prane bankës faturat dhe para-faturat e lehuara nga furnitorët si dhe transfertat bankare përkatëse.
- d. Plotësimi i Kërkesës për Disbursim sipas Aneksit 3 bashkëngjitur kontratës.
- e. Kredimarrësi të paraqesë prane bankës kontratën/at e shit-blerjes së autobuzave apo faturat përkatëse për blerjen e 7 (shtatë) autobuzave si dhe transfertat bankare në drejtim të palet shitesë.

#### NENI 4 - INTERESI

- 4.1 Kredimarrësi do të paguajë interes për shumën e papaguar të kryegjësë së Kredise në vlerën e interesit Tribor një vjeçar i ndryshueshem cdo vit dhe i fiksuar për një vit në datën e disbursimit të parë + 2.5% (dy pike pëse për qind) në vit, në asnjë rast kjo normë e interesit nuk do të jetë më e vogël se 6.2% (gjashtë pike dy) vjetore, duke u llogaritur nga dita e parë e një Periudhe Interesi. Interesi do të paguhet në Datën e pagimit të interesit.

Palet bien dakort që në rastet kur Norma Bazë e interesit Tribor ka vlerë negative, banka në kalkulimin e interesit do ta konsiderojë me vlerë 0 (zero).

Përveç rasteve të luhatjeve të tregut të parashikuara në Aneksin 4, në cdo rast rishikimi i normës së interesit do të bëhet në ditën pasardhëse të punës pas datës së pagesës së kësaj të 12-të dhe mbaron me plotësimin e një periudhe të 12-mujore. I njëjti proces përlllogaritjeje do të përsëritet në periudha të njëjta, deri në datën e maturimit të kredise. Kredimarrësi duhet të paraqitet në bankë për t'u njohur me normën e interesit për periudhën pasardhëse 12-mujore.

Në rast se Kredimarrësi nuk bien dakort me ndryshimin e normës së interesit sipas nenit të mësipërm, Kredimarrësi janë të detyruar të informojnë menjëherë mospranimin e kësaj ndryshimi. Në këtë rast Kredimarrësi detyrohen të kryejnë ripagimin e plote të shumës së mbetur të kredise, duke paguar penaltetin përkatës që aplikohet në rastet e parapagimit.

Interesi do të llogaritet në baze të vitit me 360 (treqind e gjashtëdhjetë) dite. Vlera e interesit cdo muaj do të llogaritet mbi pjesën e mbetur të kryegjësë të kredise x interesin vjetor të kredise / 360 dite x numri i diteve të muajit për cdo kësht.

*Llogaritja e Interesit*

*Shembull*

*Kredi 50,000 Leka*

*Maturiteti 48 muaj*

*Interesi 8% në vit*

*Vlera totale e interesit: 8591 Leka*

Në momentin e nënshkrimit të kontratës Norma Efektive e Interesit (NEI) është 6.35% në vit. Megjithatë, Vlera e saktë e NEI-T do të shprehë në planin e amortizimit, i cili do të dorëzohet klientit pas disbursimit të kredise. Sqarimi i detajuar i NEI –t gjendet në Aneksin 1 të kësaj kontrate.

- 4.2 Në rast se Kredimarrësi është në pamundësi për të paguar vlerën e kredise ose një pjesë të saj në afatit e caktuar ai do të paguajë interes kontraktual të sipërpermendur i rritur me 10% (dhjetë për qind), e llogaritur cdo ditë mbi të vlerën e kredise së paktyer, deri në momentin e kthimit të kredise vullnetarisht apo dhe me anë të procedurave të ekzekutimit të detyrueshem siaps legjislacionit në fuqi dhe bazuar në kushtet e kësaj kontrate. Palet konsiderojnë detyrim të pashlyer sipas kësaj kontrate të gjithë shumën e kredise, interesat e papaguara të kontratës bashkë me interesat debitorë, të gjithë komisionet e tjera të pagueshme për marrjen e kredise, respektimin e kontratës dhe ato për venien në ekzekutim të detyrueshem të kontratës derisa banka të ketë rimarrë në llogaritë e saj të gjithë këto shume.

*Llogaritja e penaltetit në rast mospagese të kësaj të papaguar është sa më poshtë:*

*Shembull:*

*Kesti 100,250 leke*

*Dite vonese: 12 dite*

*Penalitet për tu paguar =  $100,250 * 12 * 13\% / 360 = 434.42$  leke*

- 4.3 Cdo përcaktim nga Banka e përqindjes së interesit të zbatueshem për shumën e papaguar dhe të Afatit të Kamatvonesës do të jetë përfundimtar, i pakundërshtueshem dhe detyrues për Kredimarrësin, përveç rastit kur Kredimarrësi provon bindshëm dhe pranohet nga Banka se ky përcaktim përmban gabime të dukshme.

*Bashkëngjitur kësaj kontrate është Aneksi 1, 2, 3 dhe 4 i cili përmban nder të tjera Normën Efektive të interesit, rrezikun e kredimarrjes së valute të huaj dhe Ngjarjen e Luhatjes së Tregut.*

## NENI 5 – RIPAGIMI

- 5.1 Kredimarrësi do të ripaguajë Kredinë në këste mujore fikse të perbera nga kryegjje + interesat perkates duke filluar nga dita e disbursimit deri me date 01 Qershor 2024.

Në datën e disbursimit dhe cdo 12 muaj pas kesaj dite, Kredimarrësit do t'i jepet nga perfaqesuesit e Bankes një plan ripagimi për cdo vit të kohezgjatjes së kredise, që tregon shumat e çdo kësti duke përfshirë interesin dhe kryegjjenë dhe datën e cdo kësti.

Kredimarrësi do të paguajë një komision prej 0.5% të shumës së kredise (zero pike pesë për qind) në ditën e disbursimit për shpenzime administrative.

- 5.2 Datat për pagesën e kryegjjes së Kredise përputhen me Datat e Pagimit të Interesit.

- 5.3 Me ane të kesaj kontrate Kredimarrësi/ Dorezanesi bien dakort dhe autorizon paraprakisht Banken, që pa miratim të tij, banka të preke me iniciative llogarite që ai/ata mund të disponojë në Banke, në rast se Kredimarrësi/Bashkekredimarrësi është në vonesë në pagimin e keshtit të rradhes, interesave dhe penaliteteve që vijnë sipas kesaj kontrate si dhe komisioneve vjetore të aplikuara për kredine sipas kontrates dhe kushteve të punës në fuqi të Bankes. Gjithashtu Kredimarrësi/ Dorezanesi detyrohet të mbyllë me fondet e veta cdo tepricë debitore që mund të lindin nga perdorimi i kredise në monedha të ndryshme si dhe autorizojnë banken të preke me iniciative llogarite që ai/ata mund të disponojë në Banke për mbylljen e ketyre tepricave debitore.

## NENI 6 – PARAPAGIMI

- 6.1 Kredimarrësi mund të parapaguajë pjesë të Kredise të barabarte me shumën e kryegjjes apo shumefisha të tij në cdo kohë. Në këtë rast Kredimarrësi do të paguajë një penaltet që do të jetë 5% e shumës së parapaguar.

*Shembull për pagimin teresor:*

*Kryegjja e mbetur është 300,000 Leke*

*Komisioni i paguar = 300,000\*5% = 15,000 Leke*

*Shembull për pagimin pjesor:*

*Shuma që do të parapaguhet është 100,000 Leke*

*Komisioni i paguar = 100,000\*5% = 5,000 Leke*

- 6.2 Në të njëjtën kohë Kredimarrësi do t'i paguajë Bankës të gjitha interesat e mbledhura dhe shumat e tjera të pagueshme mbi kryegjjenë e Kredise që do të parapaguhet, si edhe të gjitha shumat e tjera të pagueshme sipas kesaj Kontrate.

- 6.3 Kredimarrësi do të njoftojë Bankën për qëllimin e tij për të parapaguar Kredinë nëpërmjet një njoftimi me shkrim, ku do të specifikohen termat dhe kushtet e parapagimit. Çdo njoftim i tillë për parapagim nga Kredimarrësi do të jetë i parevokueshëm dhe i detyrueshëm për Kredimarrësin dhe, pas dërgimit të këtij njoftimi, Kredimarrësi detyrohet të parapaguajë Kredinë në përputhje me termat që parashikohen në atë njoftim. Shumat e parapaguara të Kredise nga Kredimarrësi nuk mund të rimerren si Kredi.

## NENI 7 - SIGURIMI I KTHIMIT TË LINJËS SË KREDISE NGA KREDIMARRËSI DHE DOREZANESI

- 7.1 Kredimarrësi siguron kredinë kufi të dhënë nga Banka me garancite e vena nga vete ai dhe dorezanesi sipas kontrates së hipotekimit nr. 2064 rep. nr. 377 kol date 25.07.2017, Marreveshje Siguruese nr. 2060 rep. nr. 378 kol date 25.07.2017, Marreveshje Siguruese nr. 2067 rep. nr. 389 kol date 25.07.2017 dhe Marreveshje siguruese pengu kuotat e pjesëmarrjes në shoqëri nr. 2066 rep. nr. 388 kol date 25.07.2017.

- 7.2 Këto garanci do të jenë të vlefshme dhe në fuqi pa patur nevojë për t'u reregjistruar apo konfirmuar në cdo rinovim, deri në kthimin e plote të të gjithë shumave që kredimarrësi i detyrohet kredidhënesit sipas kesaj kontrate.

- 7.3 Banka, në rast të mospërbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kjo Kontrate nga ana e Kredimarrësit, ka të drejtë të kërkojë sekuestrimin, sipas procedurave të njohura nga legjislacioni në fuqi, e pronave të paluajtshme dhe të luajtshme të vena si hipoteke apo barre siguruese në favor të saj.

- 7.4 Banka në rast se garancite e dhëna nga Kredimarrësi, për shkak të ndryshme, nuk e mbulojnë kredinë e dhënë plus interesat, kërkon vendosjen e garancive shtese. Në rast refuzimi nga ana e Kredimarrësit për të përbushur detyrimin e mesiperm, Bankes i lind e drejta të kërkojë zgjidhjen e Kontrates dhe kthimin e menjehershëm të saj.

- 7.5 Kredimarrësi është i detyruar të marrë të gjitha masat dhe të kryejë çdo shpenzim të kërkuar për të ruajtur vlerën e garancisë, përfaqësuar nga cilado formë. I njëjti detyrim ekziston edhe kur Banka dhe Kredimarrësi janë në konflikt gjyqësor, për sa kohë që sendi nuk ka kaluar plotësisht në posedim të Bankës.
- 7.6 Me anë të kësaj kontrate Kredimarrësi/Bashkekredimarrësi/Dorezanesi bien dakort dhe autorizon paraprakisht Bankën, që pa miratim të tij, banka të preke me inisiativë llogarite që ai/ata mund të disponojë në Bankë, në rast se Kredimarrësi/Bashkekredimarrësi është në vonesë në pagimin e kesit të rradhës, interesave dhe penaliteteve që vijnë sipas kësaj kontrate si dhe komisioneve vjetore të aplikuara për kredinë sipas kontratës dhe kushteve të punës në fuqi të Bankës.

## NENI 8 - PAGESA

- 8.1 Të gjitha pagesat e kryegjësë, interesit, komisioneve, tarifave, shpenzimeve dhe çdo shumë tjetër në favor të Bankës në kuptim të kësaj Kontrate duhen bërë, pa u kompesuar ose zbritur pretendimet kreditore, në Euro ose, në rast të kostove dhe shpenzimeve të Bankës, në monedhën me të cilën këto kosto dhe shpenzime janë kryer, në vlerën sipas datës së kryerjes, në llogarinë dhe vendin ose vendet që Banka do të përcaktojë dhe do t'ia njoftojë kohë pas kohe Kredimarrësit.
- 8.2 Përveç rasteve kur Palët kanë rënë dakort ndryshe, shumat e disbursuara nga Banka për Kredimarrësin do të paguhet në atë monedhë për të njëjtën vlerë.
- 8.3 Nëse data e saktë për çdo pagesë në kuptim të kësaj Kontrate bie në një ditë jo-pune, atëherë pagesa do të kryhet në ditën vijuese të punës.
- 8.4 Brenda kufirit të lejuar me ligj, Banka do të ketë të drejtë të kompesojë çdo shumë që Banka i detyrohet Kredimarrësit, të maturuar apo jo, kundrejt çdo shume që Kredimarrësi i detyrohet Bankës, pavarësisht nga fakti nëse Banka i ka kërkuar ose jo Kredimarrësit pagesën e kësaj shume dhe pavarësisht nga monedha ose vendi i pagesës së po kësaj shume. Brenda kufirit të lejuar me ligj, Banka do të ketë të drejtë të zbrisë nga të ardhurat e çdo Disbursimi, çdo detyrim, komision, tarifë, shpenzim, dhe shuma të tjera që Kredimarrësi i detyrohet Bankës dhe njoftimi i llogarisë lëshuar nga Banka duhet të reflektojë këto zbritje.
- 8.5 Kredimarrësi bie dakord që Banka të perdore çdo balance kreditore në llogarinë e tij në të cilën është akorduar linja e kredise apo në çdo llogari tjetër që Kredimarrësi mund të ketë pranë Bankës, për të terhequr atë detyrim që Kredimarrësi i ka Bankës për arsye të ndryshme, pa i dërguar me pare njoftim Kredimarrësit.

## NENI 9 – DEKLARIME DHE GARANCI

Kredimarrësi deklaron dhe garanton Bankën se:

- Kredimarrësi nuk është në shkelje të ndonjë dispozite të ndonjë kontrate në të cilën Kredimarrësi është palë, e cila do të kishte ndonjë efekt material mbi kushtet dhe aftësinë financiare të Kredimarrësit për të përmbushur detyrimet e tij në kuptim të kësaj Kontrate;
- Nuk ka asnjë procedim, kërkesë padi, proces ose hetim të çelur ose të ngritur përpara ndonjë gjykate ose autoriteti qeveritar, vendas ose të huaj, ose për aq sa ka dijeni Kredimarrësi - pas verifikimeve të kryera prej tij -, nuk ka ndonjë procedim, kërkesë padi, proces ose hetim që e kërcënon apo është paraqitur kundër Kredimarrësit, ose ndonjë pasurie të tij ose të drejtë të tij, që do të kishin efekt material mbi kushtet dhe mundësinë financiare të Kredimarrësit për të përmbushur detyrimet e tij në kuptim të kësaj Kontrate;
- Të gjithë dokumentat, raportet, apo informacionet e tjera në formë të shkruar, të cilat i janë vënë në dispozicion Bankës nga Kredimarrësi janë të vërteta dhe të sakta dhe nuk përmbajnë ndonjë gabim në deklaram dhe këto akte nuk kanë lënë jashtë tyre ndonjë fakt material ose fakt të nevojshëm i cili krijon keqkuptime;
- Kredimarrësi ka kompetencat, autoritetin dhe zotësinë ligjore të nevojshme për të lidhur këtë Kontratë dhe ekzekutuar veprimet e parashikuara në të, në përputhje me termat e Kontratës së Kredise, dhe përfaqësuesit e Kredimarrësit janë autorizuar në mënyrë të rregullt për të nënshkruar këtë Kontratë në emër dhe për llogari të Kredimarrësit;
- Nënshkrimi, dorëzimi, dhe ekzekutimi i kësaj Kontrate Kredie nga Kredimarrësi është autorizuar në mënyrë të rregullt dhe të saktë me të gjitha aktet e nevojshme të Kredimarrësit, dhe përveç rasteve kur është parashikuar shprehimisht në këtë Kontratë, nuk do të kërkohet autorizimi, miratimi, heqja dorë, licenca, caktimi apo autorizimi, deklarimi, njoftimi për regjistrim në ndonjë person ose autoritet publik, dhe nuk përbën dhe nuk do të përbëjë ndonjë shkelje ose mospërmbushje në kuptim të ndonjë detyrimi të mëparshëm të Kredimarrësit;
- Kredimarrësi pranon se Fondi Europian i Investimit ("EIF"), agjentët e EIF, Zyra Europiane e Auditorëve ("ECA"), Komisioni dhe agjentët e Komisionit (duke përfshirë Zyrën Europiane Kundër Mashtrimit ("OLAF ") dhe çdo institucion tjetër i Bashkimit Europian ose pjesëtar i Bashkimit Europian i cili ka të drejtë të verifikojë përdorimin e garancisë në kuadër të Projektit për Zhvillim dhe Inovacion të Sipërmarrjeve të Ballkanit Perëndimor dhe çdo palë tjetër e autorizuar në bazë të ligjit në fuqi i cili ka të drejtë të auditojë ose monitorojë aktivitetet (të gjithë së bashku, "Palët e Interesuara") do

të ketë të drejtë të kryejë kontrole dhe të kërkojë informacion në lidhje me këtë marrëveshje dhe zbatimin e saj. Kredimarrësi do të lejojë inspektimin e aktivitetit operacional të biznesit dhe të pasqyrave e të dhënave financiare nga secila prej Palëve të Interesuara. Meqenëse këto kontrole mund të përfshijnë monitorime të rastësishme, Kredimarrësi do të lejojë aksesin në ambjentet e biznesit, gjatë orëve normale të punës për secilën nga Palët e Interesuara.

- g. Kredimarrësi si dhe të gjitha palët nënshkruese të kontratës autorizojnë dhe lejojnë Bankën që të mundesoje Paleve të Interesuara cdo dokument ose informacion në lidhje me veten e tij dhe/ose financimin sipas kesaj kontrate
- h. Kredimarrësi angazhohet, që (i) në çdo kohë do të jetë dhe do të veprojë në të gjitha aspektet në përputhje me standardet përkatëse dhe legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave, luftën kundër terrorizmit dhe mashtrimin tatimor për të cilin ai mund të jetë subjekt dhe (ii) të mos të jetë i themeluar apo të mos vendoset vullnetarisht nën juridiksionin e një shteti i cili konsiderohet si jo bashkepunues me ndonjë nga Palet e Interesuara dhe/ose kategorizohet nga ndonjë prej Paleve të Interesuara si një juridiksion i cili nuk është në përputhje me politikat / legjislacionin fiskal të Paleve të Interesuara (përveç rasteve kur kjo vjen si rezultat i një ngjarje ose rrethana që është përtej kontrollit të tij).
- i. (A) Kredimarrësi duhet që në cdo rast të veprojë në përputhje me të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore (vendase si dhe ato të Bashkimit Evropian), për të cilat Kredimarrësi mund të jetë subjekt dhe, shkelja e të cilave mund të:
- (i) ndikojë negativisht në përmbushjen e detyrimeve të kësaj kontrate;
  - (ii) cenoje interesat e Kredidhënesit dhe/ose Paleve të Interesuara;

(B) Kredimarrësi nuk do të kryejë asnjë parregullsi apo mashtrim (përfshirë çdo mashtrim me çështjet interesave financiare të BE-së).

Kredimarrësi deklaron, garanton dhe angazhohet se në cdo kohë do të jetë në përputhje me kriteret e pranimit me qëllim nënshkrimin e kesaj Kontrate dhe se do të informojë me shkrim menjëherë Kredidhënesin sapo të marrë dijeni dhe /ose behet i vetedijshëm për çdo shkelje të deklarimeve, garancive dhe angazhimeve të ndërmarra nga ana e tij.

- j. Kjo Kontratë përbën titull ekzekutiv të vlefshëm për Kredimarrësin, të zbatueshëm kundrejt Kredimarrësit në përputhje me termat e saj.

## NENI 10 - DETYRIME TË KREDIMARRËSIT

10.1 Përveç rasteve kur Banka bie dakort me shkrim, për aq kohë sa Borxhi do të jetë i papaguar dhe derisa të kryhet pagesa e plotë e Borxhit, Kredimarrësi detyrohet, premtion dhe bie dakort sa më poshtë vijon:

- a. Kredimarrësi do të njoftojë menjëherë Bankën për (i) ngjarjet e çdo Rasti Mospërmbushje dhe çdo rast tjetër të njohur prej tij, i cili, me dhënien e njoftimit dhe/ose me kalimin e kohës, do të bëhet një Rast Mospërmbushje, (ii) çdo padi të ngritur kundër Kredimarrësit, dhe (iii) vërtetimin e çdo kushti apo ngjarje e cila mund të ketë materialisht efekt mbi kushtet dhe aftësinë financiare të Kredimarrësit për të përmbushur detyrimet e tij;
- b. Kredimarrësi, me shpenzimet e veta, do të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për të mbajtur Kontraten e Hipotekes në fuqi dhe për t'i mbajtur ato si të ekzekutueshme në përputhje me kushtet e tyre, duke përfshirë të gjitha (i) depozitimet dhe regjistrimet, (ii) pagimin e tarifave dhe shpenzimeve të tjera, (iii) lëshimin e dokumentave të tjerë plotësues, (iv) shkarkimin nga të gjitha pretendimet apo pengesat që prekin të drejtat e Bankës në lidhje me të drejtat pasurore të Kontrates së Hipotekes (v) publikimet apo njoftimet për palët e treta, dhe (vi) depozitimet e dokumentave mbi utojt e të drejtave.
- c. Kredimarrësit detyrohen të qarkullojnë të gjithë aktivitetin e tyre financiar nga biznesi dhe cdo aktivitet tjetër të lidhur me këto nepermjet llogarive pranë Raiffeisen Bank sh.a. Kushti nuk do të konsiderohet i plotësuar nëse Kredimarrësit kreditojnë dhe debitojnë të gjithë shumën në llogari brenda një afati 15 dite pune.
- d. Kredimarrësi detyrohet dhe garanton të lejojë dhe të knjojë të gjithë mundesite për Bankën dhe Palet e Interesuara që të kryejnë monitorimin, kontrollin dhe auditimin dhe të mundesoje të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që evidentojnë performancën e fondeve të kredise për qëllimin dhe sipas kushteve të percaktuara në këtë kontratë dhe në përputhje me Garancinë në kuader të Projektit për Zhvillim dhe Inovacion të Sipërmarrjeve të Ballkanit Perëndimor. Kredimarrësi në plotësim të sa percaktuar me sipër do të lejojë Bankën dhe Palet e Përfshira të njihen me të dhenat financiare për evidentimin e aktivitetit tregtar dhe të vizitojnë dhe / ose inspektojnë e rivlerësojnë të gjitha mjediset e biznesit ku ai ushtron aktivitetin e tij.
- e. Kredimarrësi do të përdorë fondet e perfituara nga kjo kredi vetëm për realizimin e qëllimit të financimit të percaktuar në këtë kontratë.

- f. Shpenzimet per vleresimin e pronave dhe sendeve qe sherbejne si garanci per linjat e kredive do te konsiderohen si shpenzime te kredimarrësit dhe do te paguhen nga klienti, sa here qe banka do te kerkoje nje raport vleresimi. Kjo pagese do te behet pas dorezimit te raportit te vleresimit nepermjet bankes tek vleresuesi i licensuar dhe i kontraktuar prej saj. Kredimarrësi pranon qe raporti i vleresimit do te sherbeje ekskluzivisht per nevojat e bankes dhe vlerat e e pronave dhe sendeve jane te vlefshme vetem per kohen ne te cilen raporti i vleresimit eshte kryer. Kredimarrësi, me kerkese te tij, mund te pajiset nga banka me informacion mbi vleresimin e kolateralit . Palet pranojne qe ky vleresim nuk mund te sherbeje si prove ne ndonje proces gjyqsor te mündshem ndermjet paleve, apo me zyren e permbarimit. Ne rast se kredimarrësi nuk ka gjendje ne llogarine e tij per te kryer pagesen e tanifes se vleresimit, banka do te kryeje gjithsesi pagesen brenda afateve te kerkuara me iniciative dhe do te rimbursohet qofte edhe duke debituar llogarine e kredimarrësit nese nuk ka gjendje kreditore. Njofümi per kete detyrim do ti dergohet kredimarrësit nga Banka me poste te thjeshte ose elektronike ne adresen e deklaruar prej tij.
- g. Kredimarrësi do të sigurojë prane shoqerise se sigurimit te miratuar nga banka pronen e tij te vendosur si kolateral ne favor te Bankes te pakten per vleren e kredise, dhe do te rinovojë cdo vit policen e sigurimit. Kredimarrësi do të vendosë Bankën si përfituese të këtyre policave të sigurimit dhe do të paraqesë në Bankë kopje të rinovuara të policave të sigurimit 30 (tridhjetë ditë) ditë para afatit të mbarimit të tyre, per cdo vit. Ne rast se kredimarrësi nuk kryen rinovimin e polices se sigurimit ne afatin e kerkuar, banka ka te drejte te debitoje llogarine e kredimarrësit per vleren e primit te sigurimit dhe te beje sigurimin e prones prane shoqerise se sigurimit. Ne rast se kredimarrësi nuk ka gjendje ne llogarine e tij per te kryer pagesen e primit te sigurimit, banka do te kryeje gjithsesi sigurimin brenda afateve te kerkuara me iniciative dhe kredimarrësi detyrohet të rimbursojë menjëherë Bankën, per vleren e primit te sigurimit te paguar prej saj si rrjedhojë e mospagesës se primit në kohë nga ana Kredimarrësit.
- h. Ne rast se Kredimarrësi dhe ortaku ka siguruar me pare garancite dhe jeten e tij, Banka ka te drejte te kerkoje transferimin e kontratave te sigurimit ne favor te Bankes. Kredimarrësi pranon qe cdo kompensim qe rrjedh nga kontratat e sigurimit të kalojnë Bankes deri ne masen e kerkuar per shlyerjen e detyrimeve te papaguara nga Kredimarrësi dhe ai nuk do te kete te drejta mbi te.
- i. Kredimarrësi është i detyruar të paguajë rregullisht kredine deri ne shlyerjen e plote te saj si dhe cdo shume te terhequr ne tejkalim te limitit te miratuar, se bashku me te gjitha interesat dhe penalitet e percaktuara ne Nenin 4 te kesaj kontrate.
- j. Te lejoje Banken ose perfaqesuesit e saj te njihet me te dhenat financiare per evidentimin e aktivitetit tregtar dhe te vizitoje dhe / ose inspektoje e rivleresojë te gjitha mjediset ku ai ushtron aktivitetin e tij.
- l. Kredimarrësi bie dakort te mos lere si garanci per asnje institucion financiar dhe te trete asnje nga garancite e ofruara ne favor te Raiffesisen Bank per sigurimin e te gjitha detyrimeve ndaj bankes ( negative pledge clause).
- m. Kredimarrësi është i detyruar të paguajë të gjitha shpenzimet per noterizimin e kontratave, regjistrimin prane regjistrat te Barreve Siguruese apo Zyres se Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme si dhe cdo shpenzim tjeter ligjor qe mund te linde gjate zbatimit te kesaj kontrate.
- n. Kredimarrësi detyrohet dhe garanton se do te marre miratimin paraprak me shkrim te bankes, perpara se te kryeje ndryshime ne strukturen organizative apo te biznesit te tij, ndryshime ne pronesine e aksioneve te shoqerise, te ndryshoje adresen e tij/seline apo cdo ndryshim ne statutin e shoqerise dhe ne organet drejtuese te saj.
- o. Kredimarrësi detyrohet dhe garanton se do te marre miratimin paraprak me shkrim te bankes, perpara se te marre persiper detyrime te tjera monetare ose te marre kredi para prane nje banke tjeter, nje institucioni financiar apo te tjere ne cfaredo lloj forme ose te garantoje detyrime te nje subjekti te trete (institutcion financiar apo te tjere).
- p. Kredimarrësi detyrohet dhe garanton qe te paraqese prane bankes brenda 3 (tre) muajve nga data e nenshkrimit te kesaj kontrate, dokumentet mjedisore dhe sociale sipas kerkeses se bankes, ne menyre qe banka te kryeje proceduren e vleresimit te këtyre dokumentave mjedisore, sociale dhe perputhshmerine e tyre me legjislacionin ne fuqi.
- q. Kredimarrësi detyrohet dhe garanton qe brenda 2 (dy) muajve nga data e disbursimit te pare te kesaj linje kredie bankare te paraqese prane bankes dokumentacionin e nevojshem te autobuzave te rinj qe do te blihet ne menyre qe banka te kryej dhe te perfundoje raportin e vlersimit te tyre si dhe te beje bllokimi e autobuzave vetem ne favor te Raiffeisen Bank sha. Perfaqesuesit e bankes do te monitorojne permbushjen e ketij kushti.
- r. Rishikimi i situates se pergjithshme te kredimarrësit do te behet cdo 12 muaj nga data e disbursimit dhe pergjate gjithë afatit te kredise. Per kete kredimarrësi detyrohet te paraqese ne banke 30 dite perpara perfundimit te cdo periudhe 12 mujore pasqyrat financiare te vitit te meparshem financiar, dokumenta ligjore te rinovuara te statusit ligjor te shoqerise dhe te garancive te vendosura si kolateral sipas pikes 7.01. Gjithashtu kredimarrësi bie dakord me faktin qe kredidhenesi mund te kerkoje ne keto raste rivleresim te aseteve te vendosura si garanci me shpenzimet e huamarresit. Ne rast se gjate rishikimit te situates financiare dhe ligjore te kredimarrësit vertetohen se ka ndodhur nje ose te gjitha ndryshimet si me poshte:

- Qarkullimi në llogarë e huase me Raiffeisen Bank sh.a, gjatë periudhës 12-te mujore ka qenë me pak në vlerë totale se shuma e kredise e percaktuar në nenin 2.
- Vlera e pasurive të vendosura si garanci sipas nenit 7 pika 7.01 ka rënë nën vlerat e mbulimit të kerkuara nga banka sipas politikave të brendshme të financimit dhe rregulloreve të Bankes së Shqipërisë në fuqi.
- Gradimi i kredimarrësit dhe/ose kredimarrësit (customer rating) sipas sistemeve të brendshme të gradimit të bankes në bazë të cilave klienti dhe/ose klientet janë klasifikuar për të marrë kredi është përkeqësuar me dy nivele.

Kredidhënesi automatikisht i kërkon kredimarrësit dhe/ose kredimarrësve të marrë masa për plotësimin e kushteve sipër përmendur ose kthimin e gjithë shumave që ai i detyrohet kredidhënesit sipas kontratës së kredise.

10.2. Përveç rasteve kur Banka bie dakord me shkrim ndryshe, për aq kohë sa Borxhi, ose ndonjë pjesë e tij do të mbetet i papaguar, dhe derisa të paguhet plotësisht shumat që duhet të paguhet sipas kësaj Kontrate, Kredimarrësi premtion dhe garanton se nuk do të përmbushë, marrë përsipër, garantojë apo lejojë apo bëhet përgjegjës për detyrime të tjera veç Kredisë.

10.3 Kredimarrësi siguron Kredidhënesin që:

- 10.3.1 në përdorim të disbursimeve të Kredise do të respektojë legjislacionin për mbrojtjen Mjedisore dhe Sociale në fuqi kohe pas kohe;
- 10.3.2 do të pajiset, do të mbajë dhe do të sigurojë përputhshmëri me të gjitha Lejet Mjedisore, Sigurise Sociale, Masa të shëndetit dhe Sigurise në Punë, Trajtimin të Ujërave, Ndotjes dhe Lejeve të tjera të kërkueshme për ushtrimin e aktivitetit të tij si edhe do të kryejë të gjithë veprimet e arsyeshme përpara ndryshimeve të ardhshme të njohura apo detyrimeve sipas këtyre;
- 10.3.3 do të zbatojnë procedurën për monitorimin e përputhjes me dhe parandalimin e lindjes së përgjegjësisë sipas legjislacionit mjedisor dhe ate social;

Kredimarrësi siguron që menjëherë me marrjen e faktit do të njoftojë me shkrim Kredidhënesin, për

- (i) çdo Pretendim Mjedisor apo social kundër tij aktual, në proces apo i mundshëm; dhe
- (ii) çdo fakt apo rrethanë që në mënyrë të arsyeshme mund të shkaktojë ngritjen apo mundësinë e ngritjes së një Pretendimi Mjedisor apo social kundër tij;

Kredimarrësi duhet të njoftojë menjëherë Bankën për çdo ngjarje apo kusht i cili mund të ketë një Efekt Material Negativ mbi aktivitetin, biznesin e Kredimarrësit, veprimet dhe kushtet financiare apo aftësinë e Kredimarrësit për të kryer ndonjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate; dhe i çdo incidenti ose aksidenti në lidhje me Kredimarrësin ose objektin e financimit që ka të ngjarë të ketë një efekt material mbi mjedisin, shëndetin ose sigurinë apo ndonjë ndryshim të propozuar në natyrën e aktivitetit apo biznesit ose operacioneve të Kredimarrësit ose ndonjë pretendim sipas ndonjë politike sigurimi dhe kur pretendimi që ngrihet kundër tij, në rast se për të merret një vendim negativ, ka apo në mënyrë të arsyeshme mund të ketë Efekt Material Negativ.

Te gjithë parashikimet e pikës së sipër do të zbatohen dhe Kredimarrësi merr përsipër që do të marrë të gjithë masat për të ushtruar veprimtarinë e tij në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar dhe të Dokumentacionin e shoqërisë, aktivitetit dhe Licensat.

10.4 Mosplotësimi i një prej kushteve të percaktuara në këtë kontratë kredie bankare nga ana e kredimarrësit përveç se konsiderohet rast përmbushje në kuptim të nenit 12 të kësaj Kontrate, do të shoqërohet me rritjen e menjëhershme të normës së interesit të percaktuar në nenin 4 pika 4.1 të kësaj kontrate Kredie Bankare, me + 0.5 % (zero pike pesë përqind) në momentin e konstatimit të kushtit të thyer.

## NENI 11: TË DREJTA DHE DETYRIME TË DOREZANESIT

11.1 Dorezanesi garanton pa rezerva Bankën se do të përgjigjet para saj për përmbushjen e detyrimit total të Kredimarrësit, në rast se Kredimarrësi nuk përmbush detyrimet e tij, me çdo pasuri të tij të luajtshme, të paluajtshme, me çdo llogari apo depozite të tij bankare dhe jo duke u kushtezuar vetëm në keto,

11.2 Dorezanesi është i detyruar solidarisht me Kredimarrësin kryesor pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme për ekzekutimin e detyrimit si dhe për njohjen dhe përmbushjen e të gjitha parashikimeve të kësaj kontrate

11.3 Dorezanesi përgjigjet për aq sa detyrohet Kredimarrësi, duke përfshirë edhe pagimin e kamates, shpërblimin e demit të shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit dhe të shpenzimeve të tjera gjyqësore, përbarimore etj, që ka bërë Banka në lidhje me këtë kredi.

11.4 Kërkesa e parë e Bankes nuk i neshtrrohet faktit nëse Kredimarrësi duhet të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme të kerkuara nga Banka për ekzekutimin e detyrimit, pasi pavarësisht nga kjo dorezanesi është i detyruar të përgjigjet kërkesave të bankes nëse ajo i kredimarrësi.

11.5 Dorezania nuk përfundon me ripagimin pjesor të detyrimit nga Kredimarrësi, për aq kohë sa kontrata e kredise është në fuqi.

11.6 Detyrimi i Dorezanesit zvogëlohet proporcionalisht me zvogëlimin e detyrimit të Kredimarrësit.

11.7 Dorezansi detyrohet të njoftojë Bankën për çdo ndryshim të adrese së tij.

## NENI 12: MOSPËRMBUSHJA E DETYRIMEVE DHE ZGJIDHJA E KONTRATËS

12.1 Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate mosplotësimi i ndonjë prej neneve të kësaj Kontrate dhe i kontratave të tjera të cilat konsiderohen pjesë integrale e saj do të konsiderohet si mospërbushje e Kontrates. Rastet e mospërbushjes janë rastet në të cilat bankës i lind e drejta të zgjidhe kontratën dhe kredimarrësi/bashkekredimarrësi dorezansi detyrohet të kthejë menjëherë të gjithë detyrimin që kanë ndaj bankës.

Kjo Kontrate Kredie Bankare mund të zgjidhet nga Banka, sipas gjykimit të saj, pa lajmenim të shkruar të Kredimarrësit, në rast se verifikohet një nga rrethanat e mëposhtme. Raste të mospërbushjes do të përfshijnë por nuk do të kufizohen në:

- a) Kredimarrësi nuk paguan, kur kërkohet, kryegjënë ose interesin në lidhje me Kredinë siç kërkohet nga kjo Kontratë Kredie apo çdo kontratë tjetër kredie të lidhur ndërmjet tij dhe Raiffeisen Bank;
- b) Pushojnë së egzistuari dhe/ose janë shkelur kriteret e pranimit dhe deklaratimet e kredimarrësit në baze të të cilave është realizuar financimi sipas kësaj kontrate kredie, financim i cili është mundësuar falë mbështetjes së Bashkimit Europian në kuadër të Programit për Zhvillim dhe Inovacion të Sipërmarrjeve të Ballkanit Perëndimor
- c) Nëse Kredimarrësi nuk e ka minimumin e shumës së parave qarkulluese përmes llogarisë së tij rrjedhëse sipas kushteve të kësaj kontrate;
- d) Nëse Kredimarrësi nuk e kthen shumën e plotë të Kredisë dhe çdo detyrim të pashlyer sic është parashikur në nenin 2 të kontrates. Palet konsiderojnë detyrim të pashlyer sipas kësaj kontrate të gjithë shumën e kredisë, interesat e papaguara të kontrates bashkë me interesat debitorë, të gjithë komisionet e tjera të pagueshme për marrjen e kredisë, respektimin e kontrates dhe ato për venien në ekzekutim të kontrates derisa banka të ketë rimarrë në llogaritë e saj të gjithë këto shume.
- e) Falsifikimi, paraqitja e informacioneve mashtruese, fshehja e informacioneve nga Kredimarrësi dhe Dorezansi në mënyrë verbale ose të shkruar, ndonjë deklaratë, paraqitja e planeve të biznesit, prezantimi financiar që mund të rrezikoj pozitën kolaterale të Bankës ose kthimin e plotë të detyrimit të Kredimarrësit dhe Dorezansit;
- f) Nëse Kredimarrësi dhe/ose Dorezansi ndodhen në një nga ngjarjet me efekt material negativ;
- g) Çfarëdo aktiviteti i paligjshëm i Kredimarrësit;
- h) Kredimarrësi dhe/ose secili për personave nënshkruar të kontrates është shpallur fajtor për mashtrim (duke përfshirë çdo mashtrim me çështjet interesave financiare të BE-së) nga një Gjykatë Kompetente (vendase ose e një prej vendeve të Bashkimit Europian) në lidhje me këto kontratë por jo duke u kufizuar vetëm me të Kredimarrësi dhe çdo person tjetër nënshkruar të kontrates njofton menjëherë Kredidhësin sapo merr dijeni apo behet i vetedijshëm për një gjykim të ulla dhe kthen menjëherë të gjitha shumat e paguara dhe të përfituara sipas kësaj kontrate kredie.
- i) Mospërbushja e ndonjë prej detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë dhe në çdo kontratë tjetër të lidhur ndërmjet paleve;
- j) Në rast se me urdher apo autorizim të Shtetit apo qeverisë (i) drejtimi i Kredimarrësit zevendesohet pjesërisht apo totalisht dhe/ose pushteti i tij për të vazhduar biznesin apo veprimet e Kredimarrësit kufizohet pjesërisht apo totalisht, (ii) kapitali i Kredimarrësit ose teresia e të ardhurave dhe/ose pronave të Kredimarrësit konfiskohen ose përdryshe shpronësohen;
- k) Ka ndodhur një ndryshim rrenjesor në strukturën e tanishme të kapitalit të Kredimarrësit për sa i përket kontrollit të pjesëmarrjes së shumicës;
- l) Kredimarrësi pranon në formë të shkruar pamundesinë për të paguar ose që nuk do të jete në gjendje të paguajë borxhet në datën e caktuar, ose falimenton, ose paraqet çdo kërkesë ose ndermerr një veprim për lehtësim i aplikueshem sipas ndonjë ligji për falimentim, riorganizim, paafesi paguese ose moratorium;
- m) Fillojnë procedura për riorganizim, shkrimje ose likuidim të Kredimarrësit (përveç rasteve kur ka aftësi paguese dhe në terma paraprakisht të miratuara me shkrim nga Banka) ose për percaktimin e një marrësi, kujdestari apo nepunësi të ngjashëm për çdo apo të gjitha të ardhurat dhe pronat e Kredimarrësit;
- n) Kredimarrësi ndërpret apo kërcenon të ndërprejë veprimet e tij ose, përveç se kur përben një veprim normal të biznesit, shet, jep me qera, transferon ose përdryshe tjeterson të gjitha apo pjesë të pronave të tij (qoftë me një veprim të vetëm apo me disa veprime) ose të gjitha apo pjesë të pronave të tij sekuestrohen apo përvetesohen nga apo për llogari të çdo autoriteti qeveritar apo të ndonjë lloji tjetër ose merren në mënyrë të detyrueshme.

- o) Kredimarrësi përfshihet në një Cështje Ligjore/Gjyqësore që ka lidhje me Ortaket.
- p) Kredimarrësi përfshihet në një Cështje Ligjore/Gjyqësore që ka të bëjë me Fuqite e Perfaqësimit që i jepën administratorit /administratoreve të Shoqërisë;
- q) një urdhër apo vendim i gjykatës kundër Kredimarrësit e konsideron atë si të falimentuar apo të paafte për të paguar ose urdhëron për shpërndarjen apo likuidimin e veprimtarisë së tij tregtare; apo depozitimi i një kërkesë për shpallje falimentimi ose për procedurë administrimi për Kredimarrësin sipas legjislacionit të zbatueshëm; apo Kredimarrësi fillon procedurat e falimentimit ose të deklanimit si subjekt pa aftësi paguese, ose jep miratimet e nevojshme për fillimin kundër tij të procedurave të falimentimit ose të deklanimit si subjekt pa aftësi paguese, ose depoziton një kërkesë apo përgjigjet apo miraton depozitimin e një kërkesë të tillë për emërimin e likuidatorit ose administratorit të falimentimit ose pranon me shkrim për pamundësinë e tij për shlyerjen e detyrimeve në afat, ose çdo ngjarje tjetër i cili sipas legjislacionit të zbatueshëm ka të njëjtin efekt me ngjarjet e cituara në këtë Nen.
- r) Çdo rast i mospërbushjes nga ana e Kredimarrësit do të konsiderohet si mospërbushje e Dorezanesit dhe Banka do të ketë të njëjtat të drejta për kërkim të detyrimit ndaj dorezanesit siç janë përcaktuar sipas Nenit 11 të kësaj Kontrate. Këto të drejta përfshijnë por nuk kufizohen me marrjen në posedim dhe shitjen e ndonjë apo gjithë kolateralit siç është përcaktuar në Nenin 7 dhe Kontraten e (Hipotekës, Marrëveshjes Siguruese apo çfaredolloj tjetër mjeti sigurimi ligjor).

12.2. Në rast se ndodh apo vazhdon të ekzistojë qoftë edhe vetëm një Rast Mospërbushje, Banka ka të drejtë të ndermarre të gjitha veprimet që ajo i gjykon të arsyeshme dhe / ose kerkojë zgjidhjen e kontratës dhe rikthimin e kryegjese dhe interesave të akumuluar, si dhe çdo shume të tjetër të perlogaritur dhe të paguashme ndaj saj.

Në rast se nuk realizohet kthimi vullnetarisht nga klienti i të gjitha shumave që i detyrohet bankës si me lart, banka ka të drejtë:

- a) T'i drejtohet gjykatës për leshimin e urdherit të ekzekutimit sipas nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile.
- b) Të fillojë ekzekutimin e detyrueshëm të kredisë.
- c) Edhe gjatë ekzekutimit të detyrueshëm, kredimarrësit do të vazhdojnë t'i llogariten interesa dhe penalitete sipas kesaj kontrate kredie bankare deri në kthimin e plote të të gjitha shumave që ai i detyrohet bankës.

12.3 Të gjitha kostot dhe shpenzimet administrative, gjyqësore, noterizimeve, komisioneve, tarifave për negociimin, perfundimin e mbarevajtjes dhe ekzekutimit e të drejtave të Bankës, përfshirë kolateralin sipas kontratës së hipotekës dhe marrëveshjeve siguruese, perballohen nga Kredimarrësi/Bashkekredimarrësi/hipotekuesi/dorezanes.

### NENI 13: SIGURIMI I PAGESES SE KREDISE

13.1 Kredimarrësi do të sigurojë pranë shoqërisë së sigurimit të miratuar nga banka pasuritë e tij të luajtshme të paluajtshme të vendosur si kolateral në favor të Bankës të paktën për vlerën e kredisë, dhe do të rinovojë çdo vit policën e sigurimit. Kredimarrësi do të vendosë Bankën si përfituese të këtyre policave të sigurimit dhe do të paraqesë në Bankë kopje të rinovuara të policave të sigurimit 30 (tridhjetë ditë) ditë para afatit të mbarimit të tyre, për çdo vit. Në rast se kredimarrësi nuk kryen rinovimin e policës së sigurimit në afatin e kërkuar, banka ka të drejtë të debitojë llogarinë e kredimarrësit për vlerën e primit të sigurimit dhe të bëjë sigurimin e pronës pranë shoqërisë së sigurimit. Banka ketë të drejtë e ushtron me iniciativën e saj pa qenë nevoja të marrë miratim të metejshëm, jo vetëm në rastet kur llogaritë e klientet kanë gjendje kreditore, por dhe në rastet kur llogaria/te nuk kanë gjendje të mjaftueshme apo nuk kanë fare gjendje kreditore. Në këto raste, llogaria e kredimarrësit për shumën që i perket primit të sigurimit, konsiderohet si overdraft i paautorizuar dhe kredimarrësi detyrohet jo vetëm të paguajë shumën por dhe interesat e publikuara në kushtet e punës së bankës për overdraftin e paautorizuar.

13.2 Kredimarrësi, Hipotekuesi pranon që çdo kompensim dhe/apo demshperblim që rrjedh nga policat e sigurimit të kredisë të kalojë Bankës dhe ai nuk do të ketë të drejta mbi të.

13.3 Kredimarrësi bie dakort që Banka t'i verë në dispozicion shoqërisë së sigurimit të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm të kredisë/ kredimarrësit, përfshirë dhe dokumentacionin e një kolateralit të dytë që mund të zevendesojë kolateralin e vendosur sipas kesaj kontrate, për efekt të marrjes në sigurim dhe pagimit të shumës së sigurimit në rast se ndodh ngjarja e sigurimit.

13.4 Në rast të një shtese të mevonshme të shumës së kredisë, kredimarrësi do të paguajë primin shtese të sigurimit të kredisë me nënshkrimin të kontratës së re të kredisë, në të kundërt shumën shtese të kredisë nuk disbursohet.

13.5 Në rast të shlyerjes së parakohshme të kredisë, kredimarrësi do të jete përfitues i një pjese të primit të paguar, e cila do të perlogaritet në atë moment nga shoqëria e sigurimit, në bazë të pjesës së mbetur të afatit të kredisë.

13.6 Në rast se Kredimarrësi, Hipotekuesi dhe Shoqëria e Sigurimit janë në proces gjyqësor për probleme të kompesimit/demshperblimit sipas kesaj kontrate kredie atehere të gjitha shpenzimet do të perballohen nga Kredimarrësi.

### NENI 14 - VERIFIKIMI DHE RAPORTIMI I TË DHENAVE



Palet ne kete kontrate bien dakord dhe deklarone si me poshte :Duke kuptuar se, të dhënat tona demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë do të trajtohen ne perputhje me kuadrin ligjor dhe nenligjor ne fuqi per mbrojtjen e te dhenave personale, sekretin bankar si dhe sekretin profesional si dhe per faktin se Banka Raiffeisen dhe Regjistrin e Kredive te Bankes se Shqiperise kane marre te gjitha masat e nevojshem per te garantuar trajtimin e sigurt te te dhenave te mesiperme:

Autorizoj Raiffeisen Bank që, për qëllimet që përfshijnë:

1. vlerësimin e aplikimit për të marrë kredi;
2. vlerësimin e rrezikut të kredisë gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies time kontraktore të kredisë me bankën Raiffeisen dhe/ose
3. vlerësimin e besueshmërisë time si person i lidhur me kredimarrësit,
4. financimin e kesaj kredie fale mbështetjes së Bashkimit Europian në kuadër të Programit për Zhvillim dhe Inovacion të Sipërmarrjeve të Ballkanit Perëndimor.

i) të njihet me detyrimet e mia ndaj bankave/ degëve të bankave të huaja/ subjekteve kredidhënëse, nëpërmjet përdorimit të autorizuar të të dhënave/informacionit të Regjistrin të Kredive, në mënyrë që të vlerësojë sasinë e detyrimeve financiare, garancitë dhe besueshmërinë/afësinë për të shlyer detyrimet financiare. Gjithashtu, jap pëlqimin tim që banka Raiffeisen, të përdorë emrin dhe të dhënat e mia identifikuese dhe financiare që mbahen në Regjistrin e Kredive, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë

ii) te grumbulloje, perpunoje te dhenat personale te secilit prej personave nenshkrues te kesaj kontrate dhe Marreveshjeve Siguroese dhe/ose personave te lidhur me palen kredimarrrese si edhe t'i transferoje keto te dhena personale tek çdonjera prej Paleve te Interesuara me kerkesen e ketyre te fundit. Ne kete kuader, çdo e dhene personale qe mund t'i transferohet Paleve te Interesuara do te ruhet nga keto te fundit per nje afat deri me 7- vite pas marrjes se ketij informacioni. Mbetet detyrim i personave nenshkrues te kesaj kontrate qe, ne rast se do te kerkohet informacion sa i perket te dhenave personale te personave te lidhur me kredimarrresin te cilet nuk jane nenshkrues te kesaj kontrate dhe/ose Marreveshjes Siguroese, te sigurohet qe te marre miratimin e tyre me shkrim perpara se t'i paraqese ato prane Bankes duke u kujdesur qe t'i njoftoje paraprakisht se keto te dhena do t'i transferohen Paleve te Interesuara ne perputhje me kete paragraf. Ne kuader te perpunimit te te dhenave personale nga Palet e Interesuara, secili prej individëve te dhenat personale te te cilit do te transferohen, ka te drejte te kerkoje verifikimin, korrigjimin, fshirjen apo modifikimin e te dhenave personale duke i'u drejtuar bankes me shkrim dhe duke kuptuar qe kjo e fundit do te njoftoje menjehere Palet e Interesuara per kete qellim.

Ky autorizim konsiderohet i dhene per te gjithë personat nenshkrues te kontrates , pra si per kredimarrresit dhe te dhenat e tyre, ashtu dhe per dorezanesit dhe apo hipotekuesit.

## NENI 15 – TE NDRYSHME

15.1 Kjo Kontratë Kredie do të mbetet në fuqi deri në datën kur detyrimet ndersjellta te paleve te jene plotesuar ne perputhje me kushtet dhe afatet e kesaj kontrate.

15.2 Kjo Kontratë përbën titull ekzekutiv të vlefshëm për Kredimarrësin, të zbatueshëm kundrejt Kredimarrësit në përpunje me termat e saj.

15.3 Kjo Kontratë Kredie dhe dokumentat e cituara këtu përbëjnë të gjithë detyrimin e palëve në lidhje me këtë objekt dhe do të mbizotërojnë ndaj çdo qëllimi ose kuptimi në lidhje me me këtë operacion. Çdo ndryshim, heqje dorë nga Banka në lidhje me ndonjë kusht ose afat, ose miratim i dhënë nga Banka sipas kësaj Kontrate Kredije, do të bëhet me shkrim, nënshkruhet nga Banka, dhe në rast të ndryshimit edhe nga Kredimarrësi. Në rast se Banka heq dorë nga ndonjë prej kushteve të ndonjë Disbursimi, me marrjen e Disbursimit, Kredimarrësi do të konsiderohet se ka pranuar të gjitha kushtet dhe afatet e heqjes-dorë.

15.4 Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër që bëhet apo do të bëhet sipas kësaj Kontrate Kredije për Bankën apo për Kredimarrësin do të bëhet me shkrim. Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë Kredije, ky njoftim, kërkim ose çdo lloj komunikimi tjetër konsiderohet se është kryer apo bërë në mënyrën e duhur kur dorëzohet nëpërmjet postës së rregjistruar, ose me faks, te pala e duhur, ose të bërë në adresën e specifikuar ne kete kontrate, ose në ndonjë adresë tjetër per te cilen palet kane marre njoftim si dhe ne numrat e kontaktit te deklaruar nga palet.

15.5 Aneks te kesaj kontrate jane :

- Aneksi 1 –sqarimet per NEI-n
- Aneks 2 - Nje koment mbi kredimarrjes ne valute dhe rritjen e normes se interesit gjate periudhes se kredise.
- Aneks 3 - Forma e aplikimit te disbursimit
- Aneks 4 - Ngjarja e Luhatjes se Tregut dhe norma e rifinancimit

## NENI 16 – NDALIMI I HEQJES DORE

Asnjë mënyrë sjellje dhe pamundësi ose vonesë e Bankës në realizmin e të drejtave, kompetencave ose mjeteve juridike, nuk do të konsiderohet si heqje dorë ose se bie ndesh me të drejtat, kompetencat ose mjetet juridike të vet Bankës. Asnjë e drejtë, kompetencë ose

mjet juridik i Bankës nuk do të përjashtojë ndonjë të drejtë, kompetencë ose mjet juridik tjetër të cilësuar këtu ose që bëhet me pas e disponueshme nga ligji, praktika, aktet nënligjore e të tjera.

**NENI 17 – LIGJI DHE JURIDIKSIONI**

Kjo Kontratë Kredie do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe të gjitha mosmarrëveshjet apo pretendimet që lindin apo lidhen me këtë Kontratë Kredije do të zgjidhet nga Gjykata e Shkallës së Parë Tirane.

**NË PRANINË E PALËVE**, që veprojnë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kjo Kontratë Kredije nënshkruhet në prani të përthyesit në 5 kopje, dy për kredimarrësit/dorezanes, dy për bankën dhe një për noterin.

**KREDIDHENES/BANKA:**

**Raiffeisen Bank SHA**

*Perfaqesuar nga*

**Erion BALLI**

*[Signature]*



**Rudina HORJETI**

*[Signature]*

**KREDIMARRRES:**

**Shoqeria "TIRANA - URBAN - TRANS" sha**

*Perfaqesuar nga*

**Hazbi PARLLAKU**

*[Signature]*



**BASHKEKREDIMARRRES:**

**Shoqeria "PARLLAKU" shpk**

*Perfaqesuar nga*

**Hazbi PARLLAKU**

*[Signature]*



**DOREZANES:**

**Hazbi PARLLAKU**

*[Signature]*

**NOTER**

*[Large Signature]*



**Aneks 1  
Kontrate**

**I. Banka ve ne dijani kredimarresin, si me poshte vijon:**

- a. Norma e interesit per 12 muaj nga data e disbursimit te pare do te jete Tribor 1Y + 2.5% vjetore, min 6.2% ne vit.
- b. Per kredite afatgjata, pjesa e papaguar e kryegjese ne fillim te kesaj periudhe eshte 16'000'000.ALL dhe ne fund do te jete 0.00.ALL
- c. Per kredite me kufi, kufiri i kredise do te jete sa ai i pershkruar ne nenin 2 te kontrates se kredise me kufi.
- d. Me kerkese te kredimarresit, Banka i ve ne dispozicion gjendjen e llogarise per cdo periudhe te kredise qe kerkohet.
- e. Interesat e kredise me kufi llogariten cdo muaj mbi shumen e perdorur nga kredimarresi.
- f. Ne baze te normes se interesit te parashikuar ne nenin 1, plani i ripagimit te kredise per Shoqerine "TIRANA - URBAN - TRANS" sha Shoqerine "Parllaku" shpk per 12 muajt e ardhshem, duke perfshire shumat e cdo kesti dhe daten e ripagimit do te jete si me poshte vijon:

Plani i Ripagimit:

Nr	Data	Kesti	Interesi	Principali	Tepica e principalit
1	12-Jul-17	238,727.31	83,080.00	155,647.31	15,924,352.69
2	11-Aug-17	238,727.31	82,275.82	156,451.49	15,767,901.19
3	11-Sep-17	238,727.31	81,467.49	157,259.82	15,610,641.37
4	12-Oct-17	238,727.31	80,654.98	158,072.33	15,452,569.04
5	9-Nov-17	238,727.31	79,838.27	158,889.04	15,293,680.00
6	10-Dec-17	238,727.31	79,017.35	159,709.97	15,133,970.03
7	9-Jan-18	238,727.31	78,192.18	160,535.14	14,973,434.89
8	9-Feb-18	238,727.31	77,362.75	161,364.57	14,812,070.33
9	11-Mar-18	238,727.31	76,529.03	162,198.28	14,649,872.04
10	11-Apr-18	238,727.31	75,691.01	163,036.31	14,486,835.73
11	12-May-18	238,727.31	74,848.65	163,878.66	14,322,957.07
12	11-Jun-18	238,727.31	74,001.94	164,725.37	14,158,231.70

**II. Norma Efektive e Interesit**

Ne momentin e nenshkimit te kontrates Norma Efektive e Interesit (NEI) eshte 6.35% ne vit. Megjithate, Vlera e sakte e NEI-T do te shprehet ne planin e amortizimit, i cili do t'i dorezohet klientit pas disbursimit te kredise.

**ANEKSI 2**

**Informacion mbi kredimarshjen ne valute dhe i ndryshimin te normes se interesit**

I Nderuar Klient,

Me poshte gjeni nje koment mbi rrezikun qe paraqet per ju :

▪ **Ndryshimi i Normes se Interesit**

Raiffeisen BANK sh.a., e percakton normen e interesit te kredise suaj bazuar tek Tribor/Euribor/Libor(1-vjecar) per Kredite ne ALL/EUR/USD/CHF/GBP.

TRIBOR eshte Norma e Interesit Nderbankar per LEKU-n. Kjo norme llogaritet nga Banka e Shqiperise(BSH) dhe publikohet cdo dite biznesi ne oren 11(ora shqiptare).

EURIBOR eshte Norma e Interesit Nderbankar per EURO-n. Kjo norme llogaritet nga Federata Bankare Europiane(FBE) dhe publikohet cdo dite biznesi ne oren 11(ora belge).

LIBOR eshte Norma e Interesit Nderbankar per USD-n. Kjo norme llogaritet nga Interbank Londer dhe publikohet cdo dite biznesi ne oren 11(ora angleze).

Normat e Tribor/Euribor/Libor ndryshojne cdo dite pune bankare dhe mund t'i gjeni te publikuar edhe ne sportelet e Raiffeisen Bank sha.

Ju kujtojme se, ne rast se ju merrni nje Kredi ne Raiffeisen BANK, keset mujore do te ndryshojne mbas afatit te percaktuar ne kontraten e kredise.

Norma e interesit te kredise, mbas afatit te percaktuar ne kontrate, mund te jete me e larte se norma e interesit ne ditën e lidhjes se kontrates se kredise. Po keshu, dhe norma e interesit ne rastin e « ngjarjes se luhartes se tregut » mund te jete me e larte se norma e interesit ne daten e lidhjes se kontrates.

▪ **Huamarrja ne Valute**

Ne rast se ju merrni nje kredi ne valute te huaj, keset mujore do te paguhen ne te nejeten valute.

Nderkohe, nese te ardhurat tuaja jane ne Lek, duhet te keni parasysh qe, per shkak te ndryshimeve te kursit kembimit te valutave, ne momente te caktuara mund te nevojiten me tepër LEK per te paguar kesin mujor.

Theksojme se, edhe pse vlerat e monedhave jane te qendreshme gjate kesaj periudhe, ato mund te ndryshojne ndjeshem ne te ardhmen.

Bazuar sa me lart, ju lutemi te merrni ne konsiderate keto rreziqe perpara se te firmosni Kontraten tuaj te Kredise.

Ne rast se keni ndonje pyetje rreth ndryshimit te normes se interesit apo rreth huamarrjes ne valuta te ndryshme, mos hezitoni te pyesni Analistin e Kredise. Ne rast se ata nuk jane ne gjendje t'u pergjigjen pyetjeve tuaja, drejtohuni tek Drejtori i Deges.

**Deklarate nga Kredimarresi**

Une, \_\_\_\_\_ kam lexuar dhe diskutuar permbajtjen e ketij dokumenti me Analistin e Kredise. Une kuptoj dhe pranoj rrezikun e ndryshimit te normes apo rrezikun e huamarrjes ne valute.

Nenshkrimi i Kredimarresit \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_

**KREDIMARRES:**

Shoqeria "TIRANA - URBAN - TRANS" sha

Perfaqesuar nga

Hazbi PARLLAKU

**BASHKEKREDIMARRES:**

Shoqeria "PARLLAKU" shpk

Perfaqesuar nga

Hazbi PARLLAKU



*[Handwritten mark]*



ANEKSI 3 - FORMA E APLIKIMIT TË DISBURSIMIT

[Të shkruhet në Letër me Kokë të Kredimarrësit]

[Data]

Për: (Kredidhënësi -Emri dhe Adresa)

Subjekti:Nr. \_\_\_\_ i Aplikimit të Disbursimit

I/E Ndenuar Zotëri/Zonjë:

1.Jeni të lutur t'i referoheni termave të Kontratës së Kredise datë \_\_\_\_ ("Kontrata e Kredise") ndërmjet \_\_\_\_ ("Kredimarrësi"), dhe ("Kredidhënësi).

2.Shprehjet e përkufizuara në Kontratën e Kredise do të kenë të njëjtin kuptim këtu.

3.Me anë të kësaj letre kërkojmë Disbursimin e mëposhtëm në përputhje me të gjitha dispozitat e Kontrates së Kredisë:

Monedha e kërkuar: [fut Monedhën e Kredisë]

Shuma (në shifra dhe me fjalë): \_\_\_\_\_

Banka : \_\_\_\_\_

Datë Valuta:

**Udhëzimet e Pagesës (Detajet e Bankës së Kredimarrësit):**

Emri i Llogarisë së Kredimarrësit: \_\_\_\_\_

Numri i Llogarisë së Kredimarrësit: \_\_\_\_\_

Emri i Bankës së Kredimarrësit: \_\_\_\_\_

Adresa e Bankës së Kredimarrësit: \_\_\_\_\_

**Detajet e Bankës Korrespondente të Kredimarrësit:**

Emri i Korrespondentes: \_\_\_\_\_

Adresa e Korrespondentes: \_\_\_\_\_

Emri i Llogarisë së Kredimarrësit: \_\_\_\_\_

Numri i Llogarisë së Kredimarrësit: \_\_\_\_\_

Referenca: \_\_\_\_\_

4. Për qëllimet e nenit 9 të Kontratës së Kredise, ne deklarojmë dhe garantojmë se:

- të gjitha kontratat, dokumentet dhe instrumentet që i janë dorëzuar Kredidhënësit janë të pakushtëzuara, në fuqi dhe efekt të plotë;
- deklarimet dhe garancitë e bëra nga Kredimarrësi në Kontratat e Kredive dhe Kontratat e Garancive janë të vërteta, dhe që nga kjo date, me të njëjtin efekt sikur këto deklarime dhe garanci të ishin bërë në datën e kësaj kontrate;
- nuk ka ndodhur dhe as është duke vazhduar ose është e pashmangshme ndonjë mosmarrëveshje;
- Kredimarrësi, si rezultat i këtij Disbursimi, nuk do të shkelë Statutin, ndonjë dispozitë të kontratës ose dokument në të cilin Kredimarrësi është palë (duke përfshirë të Kontratën e Kredisë) ose me të cilin Kredimarrësi është i detyruar, ose ndonjë ligj në fuqi për Kredimarrësin;
- nuk ka ndodhur asgjë që mund të ketë një efekt të pafavorshëm material mbi biznesin e Kredimarrësit, operacionet ose gjendjen financiare ose aftësinë e Kredimarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas Kontratës së Kredise ose Kontratave të Garancive; dhe
- të ardhurat nga ky Disbursim janë të nevojshme nga Kredimarrësi për qëllimet e percaktuara në Kete Kontrate.

I Juaji Sinqerisht,

Kredimarrësi

Emri:

REPUBLIKA E ALBANI  
SH. P. K. "PARLLAKU"  
TIRANE

**ANEKSI 4 – NGJARJA E LUHATJES SE TREGUT DHE NORMA E RIFINANCIMIT**

I Nderuar Klient,

Me poshte gjeni nje koment sqarues ne lidhje me parashikimet e kesaj kontrate kredie ne rastet e ndodhjes se ngjarjes se luhatjes se tregut.

**Luhatjet e tregut dhe parapagimi i detyrueshem**

- (a) Nese ndeshemi me nje Ngjarje te Luhatjes se Tregut ne lidhje me nje Kredi, ne cdo Periudhe Interesi, norma e interesit per kete kredi sipas Periudhes perkatese te Interesit do te jete norma ne perqindje per vit, e cila eshte shuma e:
  - (i) Marzhi – i cili eshte perqindja e interesit mbi normen e publikuar te interesit ne Euro/USD/Leke e cila perfitohet nga banka;
  - (ii) norma qe Kredidhenesi i ka njoftuar Kredimarresit deri ne oren 12.00 sipas ores lokale, ne Diten e Kuotimit, perpara dites se pare te Periudhes perkatese te interesit, e cila shpreh si nje perqindje per vit, koston me te cilen Kredidhenesi eshte financuar ne tregun e parase nga palet e treta per financimin ne Euro/USD/Leke (me poshte "Norma e Interesit ne Luhatje te Tregut"); dhe
  - (iii) Shpenzimet e Detyrueshme, per pjesemarrjen e Kredidhenesit ne Kredi, nese ka te tilla;
- (b) Ne kete Kontrate "Ngjarje e Luhatjes se Tregut" do te thote:
  - (i) ne ose rreth ores 12.00 sipas ores lokale ne Diten e Kuotimit, per Periudhen perkatese te Interesit asnje ose vetem nje Faqe ku publikohen Normat e Interesit do te jete e disponueshme per Kredidhenesin per te percaktuar Normen e Rifinancimit ose;
  - (ii) ne ose rreth ores 12.00 sipas ores lokale ne Diten e Kuotimit per Periudhen perkatese te Interesit, Kredidhenesi informon me shkrim Kredimarresin se shpenzimet per sigurimin e fondeve ne Euro/USD/Leke tejkalojne Normen e Rifinancimit.
- (c) Nese nje Ngjarje e Luhatjes se Tregut eshte deklaruar nga Kredidhenesi, dhe Kredimarresi ka njoftuar Kredidhenesin jo me vone se ora 17.00 e ores lokale ne Diten e Kuotimit, nje dite para dites se pare te Periudhes perkatese te Interesit, qe **Norma e Interesit** e Luhatjes se tregut njoftuar nga Kredidhenesi ne vijim te paragrafit (a) (ii) me siper nuk eshte e pranueshme per te;
  - (i) Kredimarresi duhet qe brenda 30 diteve nga dhenia e ketij njoftimi te mospranimi te normes se rifinancimit te parapaguaje pjesen e papaguar te Kryegjese, se bashku me interesat e perlogaritura sipas nenit 4, duke filluar nga dita e pare e Periudhes se Interesit deri ne ditin aktual te parapagimit, si dhe gjithe shumate e tjera qe kredimarresi i detyrohet Kredidhenesit sipas kesaj kontrate; dhe
  - (ii) Angazhimi i Kredidhenesit sipas kesaj kontrate perfundon me efekt te menjehershem.
- (d) Nese Kredimarresi deshton ne njoftimin e Kredidhenesit sic ishte parashikuar ne afatin e percaktuar ne paragrafin (b) me siper, do te konsiderohet e pranuar Norma e Rifinancimit e Luhatjes se tregut, e njoftuar nga Kredidhenesi sipas paragrafit (a) (ii) me siper.

**Percaktimi i normes se rifinancimit**

Ne cdo periudhe rishikimi te normes se rifinancimit, kjo norma e interesit do te llogaritet si vlere aritmetike e normave te interesit te ofrimit te depozitave me afat te barabarte ose te krahasueshem me periudhen e interesit (e rrumbullkosur deri ne 4 shifra pas presjes dhjetore), te tregur ne faqen : Reuters page: KLIEMMM, deri ne oren 11.00 sipas ores lokale, te dites se kuotimit.

**Dita e Kuotimit**, do te kuptohet dy dite pune para dites se pare te periudhes se interesit, ne te cilen do te percaktohet norma e rifinancimit, per periudhen pasardhese te interesit. Ne rast se dita e kuotimit eshte dite pushimi, si dite kuotimi do te merret dita pasardhese e punes, pas dites se kuotimit.

Ne rast se ne Diten e Kuotimit, ne faqen : Reuters : KLIEMMM, deri ne oren 11.00 sipas ores lokale, nuk jane te shfaqura normat e interesit, banka ka te drejte te aplikoje nje norme tjeter rifinancimi, sipas atyre te shfaqura ne faqe te tjera te cilat i ofrojne keto norma ne ditin e kuotimit.

Bazuar sa me lart, ju lutemi te merrni ne konsiderate keto rreziqe perpara se te firmosni Kontraten tuaj te Kredise.

Ne rast se keni ndonje pyetje rreth ketyre parashikimeve , mos hezitoni te pyesni Analistin e Kredise. Ne rast se ata nuk jane ne gjendje t'u pergjigjen pyetjeve tuaja, drejtohuni tek Drejtori i Deges.

Deklarate nga Kredimarresi

Une, \_\_\_\_\_ kam lexuar dhe diskutuar permbajtjen e ketij dokumenti me Analisti e Kredise. Une kuptoj dhe pranoj rrezikun e ndryshimit te normes se interesit ne kushtet e ndodhjes se ngjarjes se luhatjes se tregut.

Nenshkrimi i Kredimarresit \_\_\_\_\_

**KREDIMARRES:**

Shoqeria "TIRANA - URBAN - TRANS" sha

Perfaqsuar nga

Hazbi PARLLAKU

*[Signature]*

**BASHKEKREDIMARRES:**

Shoqeria "PARLLAKU" shpk

Perfaqsuar nga

Hazbi PARLLAKU

*[Signature]*



*[Handwritten mark]*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA E NOTERISË TIRANE

REP. NR. 2063

KOL. NR. 976 / 13



### KONTRATË KREDIE BANKARE

Sot me datë 25/07/2017, para meje Alket Hamçke Notere Publike ne Dhomen e Noterise Tirane me adrese ne Rrugen "Asim Çemele", u paraqiten personalisht pale:

#### KREDIDHENESI:

Raiffeisen Bank Sh.A., një bankë e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në Rruga e Kavajës, Tiranë, Shqipëri, dhe regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr.17426, datë 10.07.1997, me NIPT nr.J61911005B, e përfaqësuar nga përfaqësuesit e saj ligjor Z. Erion BALLI dhe Znj. Rudina HORJETI (këtëj e tutje, "Banka" ose "Kredidhenesi"); dhe

#### KREDIMARRESI:

Shoqëria "TIRANA - URBAN - TRANS" sh.a, e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tirane, me vendimin nr. 26697, datë 10.11.2001, NUIS K21407001A, date regjistrimi 07/02/2002 me seli ne Tirane, Rr. "Abdi Toptani" nr.5, e perfaqesuar ne baze te Vendimit te Keshillit te Mbikeqyrjes se Shoqerise nr.3257 rep, date 08.06.2017 nga administratori i shoqerise Z.Hazbi Parllaku (ketej e tutje kredimarresi);

#### BASHKEKREDIMARRES:

Shoqëria "PARLLAKU" shpk, e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tirane, me vendimin nr. 4104, datë 03.05.1993, NUIS J61826145P, date 03/05/1993 me seli ne adresen Petrele Mullet Objekt per ndertim, Godine nje kateshe, 10 km, ne rrugen Tirane - Elbasan, prane Lumit Erzen", Tirane, e perfaqesuar nga ortaku i vetem dhe administrator i shoqerise Z.Hazbi Parllaku (ketej e tutje Kredimarresi)

#### DOREZANES:

Hazbi Parllaku i biri i Selimit, dtl.12.06.1955, lindur ne Kukës dhe banues ne adresen Rr "Mihal Grameno", nr. 212, Tirane, identifikuar me leternjoftim nr. 031584869.

te cilet vendosin te lidhin kete kontrate me kushtet dhe termat e meposhtme, bazuar ne nenet 1031 e ne vijim, nenet, 560-584, 585-600 te K.Civil, Ligji per Barret Siguruese etj.

Banka dhe Kredimarresi këtëj e tutje do të quhen "Palët".

Përfaqësuesit ligjorë të Palëve kanë zotësi të plotë për të vepruar dhe unë Noteri vërtetoj identitetin e tyre. Palët kërkuar nënshkrimin e kësaj Kontrate Kredie Bankare (këtëj e tutje, "Kontrata").

#### NENI 1 – PËRKUFIZIMET

Nëse përmbajtja nuk e kërkon ndryshe, kudo që do të përdoren në këtë Kontratë, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

- "Ditë Pune" nënkupton, çdo ditë në të cilën bankat tregtare janë të hapura për veprime bankare të zakonshme.
- "Borxh" nënkupton, të gjitha detyrimet e Kredimarresit, si në formën e kryegjësë ose interesit (dhe/ose interesit për mospërbushje), qofshin këta aktual, të ardhshëm ose të rasut, për pagimin ose ripagimin e parave Bankës sipas kushteve të kësaj Kontrate.
- "Afati Kamatvonesës" nënkupton, në lidhje me çdo shumë të pa-paguar sipas kësaj Kontrate, një periudhë që fillon nga dita në të cilën kjo pagesë bëhet e kërkueshme dhe që mbaron në ditën e fundit të muajit që vijon pas datës në të cilën pagesa bëhet e kërkueshme.
- "Disbursim" nënkupton, disbursimin e një pjese të Kredise herë pas here në përputhje me Nenin 2 ose, siç mund t'a kërkojë përmbajtja, disbursimin e një pjese të shumës së kryegjësë të papaguar.
- "Rasti i Mospërbushjes" nënkupton secilin prej rasteve ose ngjarjeve të parashikuara në Nenin 12.
- "Data e Pagimit të Interesit" nënkupton Ditën e Parë të Punës që vijon pas mbarimit të Periudhës së Interesit.

"Periudhë Interesi"

nënkupton, periudhën gjatë së cilës zbatohet interesi kontraktor, periudhë e cila fillon nga data e Disbursimit së Kredise dhe që mbaron pas 1 (një) muaji kalendarak.

"Kredia"

nënkupton shumën maksimale të kredise parashikuar në Nenin 2 ose, siç mund t'a kërkojë përmbajtja, shumën e kryegjës së papaguar.

"Garanci"

nënkupton çdo hipoteke, peng, barrë siguroese, ose çdo mjet tjetër për sigurimin e detyrimit, të vendosur apo krijuar nga Kredimarrësi në favor të Bankës me qëllim garantimin e përmbushjes së detyrimeve të Kredimarrësit sipas kësaj Kontrate.

"Marreveshje siguroese"

nënkupton çdonjerën dhe të gjitha Kontratat ndërmjet Palëve të cilat vendosin apo knjojnë Garanci.

"Efekt material negativ"

nënkupton, ne gjykimin e Kredidhënesit, çdo efekt, ngjarje, ose ceshkje, e cila është materialisht kundër:  
(i) biznesit, aseteve, ose situates financiare te Kredimarrësit/Dorezansit; ose  
(ii) aftësia e kredimarrësit/dorezansit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kesaj kontrate.

"Garantor/Dorezanes"

nënkupton çdo person juridik apo fizik qe ofron nje garanci sipas parashikimeve te Nenin 585 e ne vazhdim te Kodit Civil.

## NENI 2 – KREDIA, OBJEKTI , QELIMI I SAJ DHE MENYRA E DISBURSIMIT

- 2.1 Në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate, Banka është dakord t'i japë Kredimarrësit një shumë prej 18'000'000ALL (tetembedhjetemilion lek). Qëllimi i dhenies se kredise eshte per te mbyllur detyrimet e linjes se kredise me kufi qe shoqëria Parllaku shpk ka prane bankes sipas Kontrate Kredie me Kufi nr.1373 rep, nr.485 kol, date 14.04.2014.
- 2.2 Kredia do të disbursohet nga Banka për Kredimarrësin pasi ky te kete plotesuar te gjitha detyrimet e tij sipas kesaj kontrate kredie.
- 2.3 Për qëllime të kësaj Kontrate, Kredimarrësi do të çelë dhe do të mbajë një llogari pranë Bankës, në të cilën do të disbursohet kredia dhe nga e cila do te debitoohen kesket mujore. Në mënyrë alternative, Banka mund të disbursojë Kredine në llogari të tjera sipas përshkrimit të Kredimarrësit në kërkesën për disbursim (me udhëzimet për transferimin e këtyre shumave, nën përgjegjesine dhe me shpenzimet e Kredimarrësit, tek llogaritë e përcaktuara nga Kredimarrësi në kërkesën e tij për disbursim).Nese Kredimarrësi nuk ploteson kushtet per disbursim sic parashikohet ne nenin 3, brenda 6 (gjashte) muajve nga dita e nenshkrimit perpara Noterit Publik, kjo kontrate do te jete e pavlefshme nuk do te kete vlere ligjore per palet. Banka ka te drejte te mos disbursoje pjese te padisburuara te kredise nese gjykon se kredimarrësi eshte ne rastet e mospërmbushjes se parashikuara ne Nenin 12 te kesaj kontrate ose situata financiare e kredimarrësit eshte përkeqësuar ndjeshem.

## NENI 3 – KUSHTET PARAPRAKE PER DISBURSIMIN FILLESTAR DHE CDO DISBURSIM

Përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe me shkrim, detyrimi i Bankës për të bërë Disbursimin e Kredise, sipas pëlqimit dhe diskrecionit të Bankës, i nënshtrohet përmbushjes paraprake të kushteve të mëposhtme:

- Banka merr prova që vërtetojnë se Marreveshjet Siguroese janë plotësisht në fuqi dhe janë depozituar dhe regjistruar rregullisht; se Garancia është e vlefshme dhe efektive dhe se të drejtat e Bankës që rrjedhin nga Marreveshjet Siguroese janë të ekzekutueshme.
- Kredimarrësi siguron çdo dokument tjetër të kërkuar nga Banka dhe ploteson te gjitha kushtet e detyrueshme perpara disbursimit.
- Plotësimi i Kërkeses per Disbursim sipas Aneksit 3 bashkangjitur kontrates.

## NENI 4 - INTERESI

- 4.1 Kredimarrësi do të paguaje interes për shumën e papaguar të kryegjësë së Kredise në vlerën interesi Tribor nje vjecar i ndryshueshem cdo vit dhe i fiksuar per nje vit + 2.5%(dy pike pese) ne vit, ne asnje rast kjo norme interesi nuk do te jete me e vogel se 7.5% (shtate pike pese) vjetore, duke u llogaritur nga dita e parë e një Periudhe Interesi. Interesi do te paguhet ne Daten e pagimit te interesit.

Palet bien dakort qe në rastet kur Norma Bazë e interest Tribor ka vlerë negative, banka në kalkulimin e interesit do ta konsiderojë me vlerë 0 (zero).

Pervec rasteve te luhatjeve te tregut te parashikuara ne Aneksin 4 , ne cdo rast rishikimi i normes se interesit do te behet ne ditën pasardhese te punes pas dates se pageses se kesit te 12-te dhe mbaron me plotesimin e nje periudhe te re 12-mujore. I njejt proces perlllogaritjeje do te perseritet ne periudha te njejta, deri ne datën e maturimit te Kredise. Kredimarrësi duhet te paraqitet ne banke per t'u njohur me normen e interesit per periudhen pasardhese 12-mujore.

Ne rast se Kredimarrësit nuk bien dakort me ndryshimin e normes se interesit sipas nenit te mesiperem, Kredimarrësit jane te detyruar te informojne menjehere mospranimin e ketij ndryshimi. Ne kete rast Kredimarrësit detyrohen te kryejne ripagimin e plote te shumes se mbetur te kredise, duke paguar penalitetin perkates qe aplikohet ne rastet e parapagimit.

Interesi do te llogaritet ne baze te vitit me 360 (treqind e gjashtedhjetë) dite. Vlera e interesit cdo muaj do te llogaritet mbi pjesën e mbetur te kryegjese te kredise x interesin vjetor te kredise / 360 dite x numri i diteve te muajit per cdo kesht.

#### *Llogaritja e Interesit*

*Shembull*

*Kredi 50.000 Leke*

*Maturiteti 48 muaj*

*Interesi 8% ne vit*

*Vlera totale e interesit: 8591 Leke*

Ne momentin e nenshkimit te kontrates Norma Efektive e Interesit (NEI) eshte \_\_\_\_\_ ne vit. Megjithate, Vlera e sakte e NEI-T do te shprehet ne planin e amortizimit, i cili do t'i dorezohet klientit pas disbursimit te kredise. Sqarimi i detajuar i NEI –t gjendet ne Aneksin 1 te kesaj kontrate.

- 4.2 Ne rast se Kredimarrësi eshte ne pamundesi per te paguar vleren e kredise ose nje pjese te saj ne afatin e caktuar ai do te paguaje interes kontraktual te siperpermendur i rritur me 10%(dhjete per qind), e llogaritur cdo dite mbi te vleren e kredise se pakthyer, deri ne momentin e kihimit te kredise vullnetarisht apo dhe me ane te procedurave te ekzekutimit te detyrueshem siaps legjislacionit ne fuqi dhe bazuar ne kushtet e kesaj kontrate. Palet konsiderojne detyrim te pashlyer sipas kesaj kontrate te gjithë shumën e kredise, interesat e papaguara te kontrates bashke me interesat debitore , te gjithë komisionet e tjera te pagueshme per marrjen e kredise, respektimin e kontrates dhe ato per venien ne ekzekutim te detyrueshem te kontrates derisa banka te kete rimarre ne llogarite e saj te gjithë kete shume.

*Llogaritja e penalitetit ne rast mospagese te kesit te papaguar eshte sa me poshte:*

*Shembull:*

*Kesti 100.250 leke*

*Dite ronesee: 12 dite*

*Penalitet per tu paguar=100,250\*12\* 13%/360=434.42 leke*

- 4.3 Cdo përcaktim nga Banka e përqindjes së interesit të zbatueshëm për shumën e papaguara dhe të Afatit të Kamatvonesës do të jetë përfundimtar, i pakundërshtueshëm dhe detyrues për Kredimarrësin, përvec rastit kur Kredimarrësi provon bindshëm dhe pranohet nga Banka se ky përcaktim permban gabime të dukshme.

*Bashkëngjitur kesaj kontrate eshte Aneksi 1, 2, 3 dhe 4 i cili permban nder te tjera Normen Efektive te interesit , rrezikun e kredimarrjes se valute te huaj dhe Ngjarjen e Luhatjes se Tregut.*

## **NENI 5 – RIPAGIMI**

- 5.1 Kredimarrësi do të ripaguajë Kredine në këste mujore duke filluar nga dita e disbursimit deri me date 30 Dhjetor 2020 si me poshte vijon:

- Kredimarrësi duke filluar nga data e disbursimit te pare deri ne muajin Mars 2018 (perفشire dhe kete muaj) do te ripaguaje kredine me keste fikse prej 200'000.ALL cdo muaj te perbera nga (kryegje+interesa). Pas përfundimit te ketij afati, duke filluar nga muaji Prill 2018 (perفشire dhe kete muaj) deri ne përfundim te afatit te kredise bankare, kredimarrësi do te ripaguaje kredine sipas nje plani rregullt ripagimi te perbera nga kryegje fikse +interesat perkatese.

Në datën e disbursimit dhe cdo 12 muaj pas kesaj dite, Kredimarrësit do t'i jepet nga perfaqesuesit e Bankes nje plan ripagimi per cdo vit te kohezgjatjes se kredise, qe tregon shumën e çdo kësti duke përfshirë interesin dhe kryegjënë dhe datën e cdo keshti.

Kredimarrësi do te paguaje nje komision prej 0.5% te shumes se kredise (zero pike pese per qind) ne ditën e disbursimit per shpenzime administrative.

- 5.2 Datat për pagesën e kryegjësë së Kredise përputhen me Datat e Pagimit të Interesit.

- 5.3 Me ane te kesaj kontrate Kredimarrësi/ Dorezanesi bien dakort dhe autorizon paraprakisht Banken, qe pa miratim te tij, banka te preke me inisiativë llogarite qe ai/ata mund te disponoje ne Banke, ne rast se Kredimarrësi/Bashkekredimarrësi eshte ne vonese ne pagimin e kesit te rradhes, interesave dhe penaliteteve qe vijne sipas kesaj kontrate si dhe komisioneve vjetore te aplikuar per kredine sipas kontrates dhe kushteve te punes ne fuqi te Bankes. Gjithashtu Kredimarrësi/ Dorezanesi detyrohet te mbylle me fondet e veta cdo teprice debitore qe mund te lindin nga perdorimi i kredise ne monedha te ndryshme si dhe autorizojne banken te preke me inisiativë llogarite qe ai/ata mund te disponoje ne Banke per mbylljen e ketyre tepricave debitore.

## NENI 6 – PARAPAGIMI

- 6.1 Kredimarrësi mund të parapaguajë pjesë të Kredisë të barabartë me shumën e kryegjese apo shumefisha të tij në çdo kohë. Në këtë rast Kredimarrësi do të paguajë një penaltitet që do të jetë 5% e shumës së parapaguar me financimet nga institucion tjetër financiar apo palë të treta si dhe 0% të shumës së parapaguar me fondet e vet kompanisë.

*Shembull për pagimin i teresor:*  
Kryegjese e mbetur është 300,000 Leke  
Komisioni i paguar = 300,000\*5% = 15,000 Leke

*Shembull për pagimin pjesor:*  
Shuma që do të parapaguhet është 100,000 Leke  
Komisioni i paguar = 100,000\*5% = 5,000 Leke

- 6.2 Në të njëjtën kohë Kredimarrësi do t'i paguajë Bankës të gjitha interesat e mbledhura dhe shumat e tjera të pagueshme mbi kryegjënë e Kredisë që do të parapagohen, si edhe të gjitha shumat e tjera të pagueshme sipas kësaj Kontrate.
- 6.3 Kredimarrësi do të njoftojë Bankën për qëllimin e tij për të parapaguar Kredinë nëpërmjet një njoftimi me shkrim, ku do të specifikohen termat dhe kushtet e parapagimit. Çdo njoftim i tillë për parapagim nga Kredimarrësi do të jetë i përvokueshëm dhe i detyrueshëm për Kredimarrësin dhe, pas dërgimit të këtij njoftimi, Kredimarrësi detyrohet të parapaguajë Kredinë në përputhje me termat që parashikohen në atë njoftim. Shumat e parapaguara të Kredisë nga Kredimarrësi nuk mund të rimerren si Kredi.

## NENI 7 - SIGURIMI I KTHIMIT TË LINJËS SË KREDISE NGA KREDIMARRËSI DHE DOREZANESI

- 7.1 Kredimarrësi siguron kredinë kufi të dhënë nga Banka me garancite e vena nga vete ai dhe dorezanesi sipas kontratës së hipotekimit nr. 2064 rep. nr. 371 kol date 25.07 2017, Marreveshje Siguruese nr. 266 rep. nr. 378 kol date 25.07 2017, Marreveshje Siguruese nr. 2064 rep. nr. 380 kol date 25.07 2017 dhe Marreveshje siguruese pengu kuotat e pjesëmarrjes në shoqëri nr. 2066 rep. nr. 378 kol date 25.07 2017.
- 7.2 Këto garanci do të jenë të vlefshme dhe në fuqi pa patur nevojë për t'u reregjistruar apo konfirmuar në çdo rinovim, deri në kthimin e plote të të gjithë shumave që kredimarrësi i detyrohet kredidhënësit sipas kësaj kontrate.
- 7.3 Banka, në rast të mospërbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kjo Kontrate nga ana e Kredimarrësit, ka të drejtë të kërkojë sekuestrimin, sipas procedurave të njohura nga legjislacioni në fuqi, e pronave të pahuajtshme dhe të luajtshme të vena si hipoteke apo barre siguruese në favor të saj.
- 7.4 Banka në rast se garancite e dhëna nga Kredimarrësi, për shkak të ndryshme, nuk e mbulojnë kredinë e dhënë plus interesat, kërkon vendosjen e garancive shtesë. Në rast refuzimi nga ana e Kredimarrësit për të përbushur detyrimin e mesipërm, Bankës i lind e drejta të kërkojë zgjidhjen e Kontrates dhe kthimin e menjëhershëm të saj.
- 7.5 Kredimarrësi është i detyruar të marrë të gjitha masat dhe të kryejë çdo shpenzim të kërkuar për të ruajtur vlerën e garancisë, përfaqësuar nga cilado formë. I njëjti detyrim ekziston edhe kur Banka dhe Kredimarrësi janë në konflikt gjyqësor, për sa kohë që sendi nuk ka kaluar plotësisht në posedim të Bankës.
- 7.6 Me anë të kësaj kontrate Kredimarrësi/Bashkekredimarrësi/Dorezanesi bien dakort dhe autorizon paraprakisht Bankën, që pa miratim të tij, banka të preke me inisiativë llogarite që ai/ata mund të disponojë në Banke, në rast se Kredimarrësi/Bashkekredimarrësi është në vonesë në pagimin e kësaj të rradhës, interesave dhe penaltiteteve që vijnë sipas kësaj kontrate si dhe komisioneve vjetore të aplikuara për kredinë sipas kontratës dhe kushteve të punës në fuqi të Bankës.

## NENI 8 - PAGESA

- 8.1 Të gjitha pagesat e kryegjësë, interesit, komisioneve, tanfave, shpenzimeve dhe çdo shumë tjetër në favor të Bankës në kuptim të kësaj Kontrate duhen bërë, pa u kompensuar ose zbritur pretendimet kreditore, në Euro ose, në rast të kostove dhe shpenzimeve të Bankës, në monedhën me të cilën këto kosto dhe shpenzime janë kryer, në vlerën sipas datës së kryerjes, në llogarinë dhe vendin ose vendet që Banka do të përcaktojë dhe do t'ia njoftojë kohë pas kohe Kredimarrësit.
- 8.2 Përveç rasteve kur Palët kanë rënë dakort ndryshe, shumat e disbursuara nga Banka për Kredimarrësin do të paguhet në atë monedhë për të njëjtën vlerë.
- 8.3 Nëse data e saktë për çdo pagesë në kuptim të kësaj Kontrate bie në një ditë jo-pune, atëherë pagesa do të kryhet në ditën vijuese të punës.
- 8.4 Brenda kufirit të lejuar me ligj, Banka do të ketë të drejtë të kompesojë çdo shumë që Banka i detyrohet Kredimarrësit, të maturuar apo jo, kundrejt çdo shume që Kredimarrësi i detyrohet Bankës, pavarësisht nga fakti nëse Banka i ka kërkuar ose jo Kredimarrësit pagesën e kësaj shume dhe pavarësisht nga monedha ose vendi i pagesës së po kësaj shume. Brenda kufirit të lejuar me ligj, Banka

do të ketë të drejtë të zbrësë nga të ardhurat e çdo Disbursimi, çdo detyrim, komision, tarifë, shpenzim, dhe shuma të tjera që Kredimarrësi i detyrohet Bankës dhe njoftimi i llogarisë lëshuar nga Banka duhet të reflektojë këto zbritje.

8.5 Kredimarrësi bie dakord që Banka të perdorë çdo balance kreditore në llogarinë e tij në të cilën i është akorduar linja e kredise apo në çdo llogari tjetër që Kredimarrësi mund të ketë pranë Bankes, për të terhequr atë detyrim që Kredimarrësi i ka Bankes për arsye të ndryshme, pa i dërguar me pare njoftim Kredimarrësit.

## NENI 9 – DEKLARIME DHE GARANCI

Kredimarrësi deklaron dhe garanton Bankën se:

- a. Kredimarrësi nuk është në shkelje të ndonjë dispozite të ndonjë kontrate në të cilën Kredimarrësi është palë, e cila do të kishte ndonjë efekt material mbi kushtet dhe aftësinë financiare të Kredimarrësit për të përmbushur detyrimet e tij në kuptim të kësaj Kontrate;
- b. Nuk ka asnjë procedim, kërkesë padi, proces ose hejm të çelur ose të ngjitur përpara ndonjë gjykate ose autoriteti qeveritar, vendas ose të huaj, ose për aq sa ka dijeni Kredimarrësi - pas verifikimeve të kryera prej tij -, nuk ka ndonjë procedim, kërkesë padi, proces ose hejm që e kërcënon apo është paraqitur kundër Kredimarrësit, ose ndonjë pasurie të tij ose të drejtë të tij, që do të kishin efekt material mbi kushtet dhe mundësinë financiare të Kredimarrësit për të përmbushur detyrimet e tij në kuptim të kësaj Kontrate;
- c. Të gjithë dokumentat, raportet, apo informacionet e tjera në formë të shkruar, të cilat i janë vënë në dispozicion Bankës nga Kredimarrësi janë të vërteta dhe të sakta dhe nuk përmbajnë ndonjë gabim në deklaram dhe këto akte nuk kanë lënë jashtë tyre ndonjë fakt material ose fakt të nevojshëm i cili krijon keqkuptime;
- d. Kredimarrësi ka kompetencat, autoritetin dhe zotësinë ligjore të nevojshme për të lidhur këtë Kontratë dhe ekzekutuar veprimet e parashikuara në të, në përputhje me termat e Kontratës së Kredise, dhe përfaqësuesit e Kredimarrësit janë autorizuar në mënyrë të rregullt për të nënshkruar këtë Kontratë në emër dhe për llogari të Kredimarrësit;
- e. Nënshkrimi, dorëzimi, dhe ekzekutimi i kësaj Kontrate Kredie nga Kredimarrësi është autorizuar në mënyrë të rregullt dhe të saktë me të gjitha aktet e nevojshme të Kredimarrësit, dhe përveç rasteve kur është parashikuar shprehimisht në këtë Kontratë, nuk do të kërkohet autorizimi, miratimi, heqja dorë, licenca, caktimi apo autorizimi, deklarimi, njoftimi për regjistrim në ndonjë person ose autoritet publik, dhe nuk përben dhe nuk do të përbëjë ndonjë shkelje ose mospërmbushje në kuptim të ndonjë detyrimi të mëparshëm të Kredimarrësit; dhe
- f. Kjo Kontratë përben titull ekzekutiv të vlefshëm për Kredimarrësin, të zbatueshëm kundrejt Kredimarrësit në përputhje me termat e saj.

## NENI 10 - DETYRIME TË KREDIMARRËSIT

10.1 Përveç rasteve kur Banka bie dakort me shkrim, për aq kohë sa Borxhi do të jetë i papaguar dhe derisa të kryhet pagesa e plotë e Borxhit, Kredimarrësi detyrohet, premtion dhe bie dakort sa më poshtë vijon:

- a. Kredimarrësi do të njoftojë menjëherë Bankën për (i) ngjarjet e çdo Rasti Mospërmbushje dhe çdo rast tjetër të njohur prej tij, i cili, me dhënie të njoftimit dhe/ose me kalimin e kohës, do të bëhet një Rast Mospërmbushje, (ii) çdo padi të ngjitur kundër Kredimarrësit, dhe (iii) vërtetimin e çdo kushti apo ngjarje e cila mund të ketë materialisht efekt mbi kushtet dhe aftësinë financiare të Kredimarrësit për të përmbushur detyrimet e tij;
- b. Kredimarrësi, me shpenzimet e veta, do të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për të mbajtur Kontraten e Hipotekes në fuqi dhe për t'i mbajtur ato si të ekzekutueshme në përputhje me kushtet e tyre, duke përfshirë të gjitha (i) depozitimet dhe regjistrimet, (ii) pagimin e tarifave dhe shpenzimeve të tjera, (iii) lëshimin e dokumentave të tjerë plotësues, (iv) shkarkimin nga të gjitha pretendimet apo pengesat që prekin të drejtat e Bankës në lidhje me të drejtat pasurore të Kontratës së Hipotekes(v) publikimet apo njoftimet për palët e treta, dhe (vi) depozitimet e dokumentave mbi titujt e të drejtave.
- c. Kredimarrësit detyrohen të qarkullojnë të gjithë aktivitetin e tyre financiar nga biznesi dhe çdo aktivitet tjetër të lidhur me këto nepermjet llogarive pranë Raiffeisen Bank sh.a. Kushti nuk do të konsiderohet i plotësuar nëse Kredimarrësit kreditojnë dhe debitojnë të gjithë shumën në llogari brenda një afati 15 dite pune.
- d. Shpenzimet për vlerësimin e pronave dhe sendeve që shërbejnë si garanci për linjat e kredive do të konsiderohen si shpenzime të kredimarrësit dhe do të pagohen nga klienti, sa herë që banka do të kërkojë një raport vlerësimi. Kjo pagesa do të bëhet pas dorëzimit të raportit të vlerësimit nepermjet bankes tek vlerësuesi i licensuar dhe i kontraktuar prej saj. Kredimarrësi pranon që raportit të vlerësimit do të shërbejë ekskluzivisht për nevojat e bankes dhe vlerat e pronave dhe sendeve janë të vlefshme vetëm për kohën në të cilën raporti i vlerësimit është kryer. Kredimarrësi, me kërkesë të tij, mund të pajiset nga banka me informacion mbi vlerësimin e kolateralit. Palet pranojnë që ky vlerësim nuk mund të shërbejë si prove në ndonjë proces gjyqsor të mundshëm ndërmjet paleve, apo me zyrën e përbarimit.

Ne rast se kredimarrësi nuk ka gjendje ne llogarine e tij per te kryer pagesen e tarifës se vleresimit, banka do te kryejë gjithësi pagesen brenda afatëve te kerkuara me iniciative dhe do te rimbursohet qofte edhe duke debituar llogarine e kredimarrësit nese nuk ka gjendje kreditore. Njoftimi per kete detyrim do ti dergohet kredimarrësit nga Banka me poste te thjeshte ose elektronike ne adresen e deklaruar prej tij.

- e. Kredimarrësi do të sigurojë prane shoqërise se sigurimit te miratuar nga banka pronen e tij te vendosur si kolateral ne favor te Bankes te pakten per vleren e kredise, dhe do te rinovojë cdo vit policen e sigurimit. Kredimarrësi do të vendosë Bankën si përfituese të këtyre policave të sigurimit dhe do të paraqesë në Bankë kopje të rinovuara të policave të sigurimit 30 (tridhjetë dite) ditë para afatit të mbarimit të tyre, per cdo vit. Ne rast se kredimarrësi nuk kryen rinovimin e policës se sigurimit ne afatin e kerkuar, banka ka te drejte te debitoje llogarine e kredimarrësit per vleren e primit te sigurimit dhe te beje sigurimin e pronës prane shoqërise se sigurimit. Ne rast se kredimarrësi nuk ka gjendje ne llogarine e tij per te kryer pagesen e primit te sigurimit, banka do te kryejë gjithësi sigurimin brenda afatëve te kerkuara me iniciative dhe kredimarrësi detyrohet të rimbursojë menjëherë Bankën, per vleren e primit te sigurimit te paguar prej saj si rrjedhojë e mospagesës se primit në kohë nga ana Kredimarrësit.
- f. Ne rast se Kredimarrësi dhe ortaku ka siguruar me pare garancite dhe jeten e tij, Banka ka te drejte te kerkoje transferimin e kontratave te sigurimit ne favor te Bankes. Kredimarrësi pranon qe cdo kompensim qe rrjedh nga kontratat e sigurimit ti kalojnë Bankes deri ne masen e kerkuar per shlyerjen e detyrimeve te papaguara nga Kredimarrësi dhe ai nuk do te kete te drejta mbi te.
- g. Kredimarrësi është i detyruar të paguajë rregullisht kredine deri ne shlyerjen e plote te saj si dhe cdo shume te terhequr ne tejkallim te limitit te miratuar, se bashku me te gjitha interesat dhe penalitet e percaktuara ne Nenin 4 te kesaj kontrate.
- h. Te lejoje Banken ose perfaqesuesit e saj te njihet me te dhenat financiare per evidentimin e aktivitetit tregtar dhe te vizitoje dhe / ose inspektojë e rivleresojë te gjitha mjediset ku ai ushtron aktivitetin e tij.
- i. Kredimarrësi bie dakort te mos lere si garanci per asnje institucion financiar dhe te trete asnje nga garancite e ofruara ne favor te Raiffesisen Bank per sigurimin e te gjitha detyrimeve ndaj bankes ( negative pledge clause).
- k. Kredimarrësi është i detyruar të paguajë të gjitha shpenzimet per noterizimin e kontratave, regjistrimin prane regjistrimit te Barreve Siguruese apo Zyres se Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme si dhe cdo shpenzim tjeter ligjor qe mund te linde gjate zbatimit te kesaj kontrate.
- l. Kredimarrësi detyrohet dhe garanton qe gjate gjithe kohezgjatjes se kesaj kontrate kredije te mos shperndaje dividente.
- m. Kredimarrësi detyrohet dhe garanton se do te marre miratimin paraprak me shkrim te bankes, perpara se te kryejë ndryshime ne strukturen organizative apo te biznesit te tij, ndryshime ne pronesine e aksioneve te shoqërise, te ndryshojë adresen e tij/ seline apo cdo ndryshim ne statutin e shoqërise dhe ne organet drejtuese te saj.
- n. Kredimarrësi detyrohet dhe garanton se do te marre miratimin paraprak me shkrim te bankes, perpara se te marre persiper detyrime te tjera monetare ose te marre kredi para prane nje institucioni financiar apo te tjere ne çfaredo lloj forme ose te garantoje detyrime te nje subjektu te trete (institutcion financiar apo te tjere).
- o. Kredimarrësi detyrohet dhe garanton qe te paraqese prane bankes brenda 3 (tre) muajve nga data e nenshkrimit te kesaj kontrate, dokumentet mjedisore dhe sociale sipas kerkeses se bankes, ne menyre qe banka te kryejë proceduren e vleresimit te këtyre dokumentave mjedisore, sociale dhe perputhshmerine e tyre me legjislacionin ne fuqi.
- p. Kredimarrësi detyrohet dhe garanton qe brenda 2 (dy) muajve nga data e disbursimit te pare te kesaj linje kredie bankare te paraqese prane bankes dokumentacionin e nevojshem te autobuzave te rinj qe do te blihet ne menyre qe banka te kryejë dhe te perfundoje raportin e vleresimit te tyre si dhe te beje bllokimi e autobuzave vetem ne favor te Raiffesisen Bank sha. Perfaqesuesit e bankes do te monitorojne permbushjen e ketij kushti.
- q. Rishikimi i situates se pergjithshme te kredimarrësit do te behet cdo 12 muaj nga data e disbursimit dhe pergjate gjithe afatit te kredise. Per kete kredimarrësi detyrohet te paraqese ne banke 30 dite perpara perfundimit te cdo periudhe 12 mujore pasqyrat financiare te vitit te meparshem financiar, dokumenta ligjore te rinovuara te statusit ligjor te shoqërise dhe te garancive te vendosura si kolateral sipas pikes 7.01. Gjithashtu kredimarrësi bie dakord me faktin qe kredidhenesi mund te kerkoje ne keto raste rivleresim te asetëve te vendosura si garanci me shpenzimet e huamarresit. Ne rast se gjate rishikimit te situates financiare dhe ligjore te kredimarrësit vertetohen se ka ndodhur nje ose te gjitha ndryshimet si me poshte :
  - Qarkullimi ne llogarine e huase me Raiffesisen Bank sha , gjate periudhes 12-te mujore ka qene me pak ne vlere totale se shuma e kredise e percaktuar ne nenin 2.
  - Vlera e pasurive te vendosura si garanci sipas nenit 7 pika 7.01 ka rene nen vlerat e mbulimit te kerkuara nga banka sipas politikave te brendshme te financimit dhe rregulloreve te Bankes se Shqiperise ne fuqi.

- Gradimi i kredimarresit dhe/ose kredimarresit ( customer raing) sipas sistemeve te brendshme te gradimit te bankes ne baze te te cilave klienti dhe/ose klientet jane klasifikuar per te marre kredi eshte perkeqesuar me dy nivele.

Kredidhenesi automatikisht i kerkon kredimarresit dhe/ose kredimarresve te marre masa per plotesimin e kushteve siper permendur ose kthimin e gjithe shumave qe ai i detyrohet kredidhenesit sipas kontrates se kredise.

10.2. Përveç rasteve kur Banka bie dakord me shkrim ndryshe, për aq kohë sa Borxhi, ose ndonjë pjesë e tij do të mbetet i papaguar, dhe derisa të paguhet plotësisht shumat që duhet të paguhet sipas kësaj Kontrate, Kredimarresi premtan dhe garantan se nuk do të përmbushë, marrë përsipër, garantojë apo lejojë apo bëhet përgjegjës për detyrime të tjera veç Kredisë.

10.3 Kredimarrësi siguron Kredidhenesin që:

- 10.3.1 ne perdorim te disbursimeve te Kredise do te respektojë legjislacionin për mbrojtjen Mjedisore dhe Sociale ne fuqi kohe pas kohe;
- 10.3.2 do të pajiset, do të mbajë dhe do të sigurojë përputhshmërinë me të gjitha Lejet Mjedisore, Sigurise Sociale, Masa te shendetit dhe Sigurise ne Pune, Trajtimin te Ujerave , Ndotjes dhe Lejeve te tjera të kërkueshme per ushtrimin e aktivitetit te tij si edhe do të kryejë të gjithë veprimet e arsyeshme përpara ndryshimeve të ardhshme të njohura apo detyrimeve sipas këtyre;
- 10.3.3 do të zbatojnë procedura për monitorimin e përputhjes me dhe parandalimin e lindjes së përgjegjësive sipas legjislacionit mjedisor dhe ate social;

Kredimarrësi siguron qe menjehere me marrjen dijani te faktit do te njoftoje me shkrim Kredidhenesin, për

- (i) çdo Pretendim Mjedisor apo social kundër tij aktual, në proces apo i mundshëm; dhe
- (ii) çdo fakt apo rrethanë që në mënyrë të arsyeshme mund të shkaktojë ngritjen apo mundësinë e ngritjes së një Pretendimi Mjedisor apo social kundër tij;

Kredimarresi duhet të njoftojë menjehere Bankën për çdo ngjarje apo kusht i cili mund të ketë një Efekt Material Negativ mbi aktivitetin, biznesin e Kredimarresit, veprimet dhe kushtet financiare apo aftësinë e Kredimarresit për të kryer ndonjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate; dhe i çdo incidenti ose aksidenti në lidhje me Kredimarresin ose objektin e financimit që ka të ngjarë të ketë një efekt material mbi mjedisin, shëndetin ose sigurinë apo ndonjë ndryshimi të propozuar në natyrën e aktivitetit apo biznesit ose operacioneve të Kredimarresit ose ndonjë pretendim sipas ndonjë politike sigurimi dhe kur pretendimi që ngrihet kundër tij, në rast se për të merret një vendim negativ, ka apo në mënyrë të arsyeshme mund të ketë Efekt Material Negativ.

Te gjithe parashikimet e pikes me siper do te zbatohen dhe Kredimarresi merr persiper qe do te marre te gjithe masat per te ushtruar veprimtarine e tij ne perputhje me kerkesat e legjislacionit shqiptar dhe te Dokumentacionin e shoqerise, aktivitetit dhe Licensat.

10.4 Mosplotesimi i nje prej kushteve te percaktuara ne kete kontrate kredie bankare nga ana e kredimarresit pervec se konsiderohet rast mospermbushje ne kuptim te nenit 12 te kesaj Kontrate, do te shoqerohet me rritjen e menjehershme te normes se interesit te percaktuar ne nenin 4 pika 4.1 te kesaj kontrate Kredie Bankare, me + 0.5 % (zero pike pese perqind) ne momentin e konstatimit te kushtit te thyer.

## NENI 11: TE DREJTA DHE DETYRIME TE DOREZANESIT

11.1 Dorezanesi garanton pa rezerva Banken se do te pergjigjet para saj per permbushjen e detyrimit total te Kredimarresit, ne rast se Kredimarresi nuk permbush detyrimet e tij, me cdo pasuri te tij te luajtshme, te paluatjshme, me cdo llogari apo depozite te tij bankare dhe jo duke u kushtezuar vetem ne keto,

11.2 Dorezanesi eshte i detyruar solidarisht me Kredimarresin kryesor pa kushte dhe ne menyre te pakthyeshme per ekzekutimin e detyrimit si dhe per njohjen dhe permbushjen e te gjitha parashikimeve te kesaj kontrate

11.3 Dorezanesi pergjigjet per aq sa detyrohet Kredimarresi, duke perfshire edhe pagimin e kamates, shperblimin e demit te shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit dhe te shpenzimeve te tjera gjyqesore, permbarimore etj, qe ka bere Banka ne lidhje me kete kredi.

11.4 Kerkesa e pare e Bankes nuk i neshetrohet faktit nese Kredimarresi duhet te kryejë te gjitha veprimet e nevojshme te kerkuara nga Banka per ekzekutimin e detyrimit, pasi pavaresisht nga kjo dorezanesi eshte i detyruar ti pergjigjet kerkesave te bankes njesoj si kredimarresi.

11.5 Dorezania nuk perfundon me ripagimin pjesor te detyrimit nga Kredimarresi, per aq kohe sa kontrata e kredise eshte ne fuqi.

11.6 Detyrimi i Dorezanesit zvogelohet proporcionalisht me zvogelimin e detyrimit te Kredimarresit.

11.7 Dorezanesi detyrohet te njoftoje Banken per cdo ndryshim te adrese se tij.

## NENI 12: MOSPËRMBUSHJA E DETYRIMEVE DHE ZGJIDHJA E KONTRATES

12.1 Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate mosplotësimi i ndonje prej neneve te kësaj Kontrate dhe i kontratave te tjera te cilat konsiderohen pjese integrale e saj do të konsiderohet si mospërmbushje e Kontrates. Rastet e mospermbushjes jane rastet ne te cilat

bankes i lind e drejta te zgjidhe kontraten dhe kredimarresi/bashkekredimarresi dorezanesi detyrohen te kthejne menjehere te gjithë detyrimin qe kane ndaj bankes.

Kjo Kontrate Kredie Bankare mund te zgjidhet nga Banka, sipas gjykimit te saj, pa lajmerim te shkruar te Kredimarresit, ne rast se verifikohet nje nga treshanat e meposhtme. Raste te mospëmbushjes do të përfshijnë por nuk do të kufizohen ne:

- a) Kredimarresi nuk paguan, kur kërkohet, kryeqjenë ose interesin në lidhje me Kredinë siç kërkohet nga kjo Kontratë Kredie apo cdo kontrate tjeter kredie te lidhur ndermjet tij dhe Raiffeisen Bank;
- b) Nëse Kredimarresi nuk e ka minimumin e shumës së parave qarkulluese përmes llogarisë së tij rrjedhëse sipas kushteve te kesaj kontrate;
- c) Nëse Kredimarresi nuk e kthen shumën e plotë te Kredisë dhe cdo detyrim te pashlyer sic eshte parashikur ne nenin 2 te kontrates. Palet konsiderojne detyrim te pashlyer sipas kesaj kontrate te gjithë shumen e kredise, interesat e papaguara te kontrates bashke me interesat debitore , te gjithë komisionet e tjera te pagueshme per marrjen e kredise, respektimin e kontrates dhe ato per venien ne ekzekutim te kontrates derisa banka te kete rimarre ne llogarite e saj te gjithë kete shume.
- d) Falsifikimi, paraqitja e informacioneve mashtruese, fshehja e informacioneve nga Kredimarresi dhe Dorezanesi në mënyrë verbale ose të shkruar, ndonjë deklarate, paraqitja e planeve të biznesit, prezentimi financiar që mund të rrezikoj pozitën kolaterale të Bankës ose kthimin e plotë të detyrimit të Kredimarresit dhe Dorezanesit;
- e) Nëse Kredimarresi dhe/ose Dorezanesi ndodhen ne nje nga ngjarjet me efekt material negativ;
- f) Çfarëdo aktiviteti i paligjshem i Kredimarresit;
- g) Mospëmbushja e ndonjë prej detyrimeve te parashikuara në kete Kontrate dhe ne cdo kontrate tjeter te lidhur ndermjet paleve;
- h) Ne rast se me urdher apo autorizim te Shtetit apo qeverise (i) drejtimi I Kredimarresit zevendesohet pjeserisht apo totalisht dhe/ose pushteti i tij per te vazhduar biznesin apo veprimet e Kredimarresit kufizohet pjeserisht apo totalisht, (ii) kapitali I Kredimarresit ose teresia e te ardhurave dhe/ose pronave te Kredimarresit konfiskohen ose permdryshe shpronosen;
- i) Ka ndodhur nje ndryshim rrenjesor ne strukturen e tanishme te kapitalit te Kredimarresit per sa I perket kontrollit te pjese marrjes se shumices;
- j) Kredimarresi pranon ne forme te shkruar pamundesine per te paguar ose qe nuk do te jete ne gjendje te paguaje borxhet ne daten e caktuar, ose falimenton, ose paraqet cdo kerkese ose ndermerr nje veprim per lehtesim I aplikueshem sipas ndonje ligji per falimentim, riorganizim, paafesi paguese ose moratorium;
- k) Fillojne procedura per riorganizim, shkrirje ose likuidim te Kredimarresit (pervec rasteve kur ka aftesi paguese dhe ne terma paraprakisht te miratuara me shkrim nga Banka) ose per percaktimin e nje marrësi, kujdestari apo nepunesi te ngjashem per cdo apo te gjitha te ardhurat dhe pronat e Kredimarresit;
- l) Kredimarresi nderpret apo kercenon te nderprese veprimet e tij ose, pervec se kur perben nje veprim normal te biznesit, shet, jep me qera, transferon ose permdryshe tjeterson te gjitha apo pjese te pronave te tij (qofte me nje veprim te vetem apo me disa veprime) ose te gjitha apo pjese e pronave te tij sekuestrohen apo pervetesohen nga apo per llogari te cdo autoriteti qeveritar apo te ndonje lloji tjeter ose merren ne menyre te detyrueshme.
- m) Kredimarresi perfshihet ne nje Ceshtje Ligjore/Gjyqesore qe ka lidhje me Ortaket.
- n) Kredimarresi perfshihet ne nje Ceshtje Ligjore/Gjyqesore qe ka te beje me Fuqite e Perfaqesimit qe i jepen administratorit /administratoreve te Shoqerise;
- o) një urdhër apo vendim i gjykatës kundër Kredimarresit e konsideron atë si të falimentuar apo të paafte për të paguar ose urdhëron për shpërndarjen apo likuidimin e veprimtarisë së tij tregtare; apo depozitimi i një kërkesë për shpallje falimentimi ose për procedura administrimi për Kredimarresin sipas legjislacionit të zbatueshëm; apo Kredimarresi fillon procedurave të falimentimit ose të deklarimit si subjekt pa aftësi paguese, ose jep miratimet e nevojshme për fillimin kundër tij të procedurave të falimentimit ose të deklarimit si subjekt pa aftësi paguese, ose depoziton një kërkesë apo përgjigjet apo miraton depozitimin e një kërkesë të tillë për emërimin e likuidatorit ose administratorit të falimentimit ose pranon me shkrim për pamundësinë e tij për shlyerjen e detyrimeve në afat; ose cdo ngjarje tjetër i cili sipas legjislacionit të zbatueshëm ka të njëjtin efekt me ngjarjet e cituara në këtë Nen.
- p) Çdo rast i mospëmbushjes nga ana e Kredimarresit do të konsiderohet si mospëmbushje e Dorezanesit dhe Banka do të ketë të njëjtat të drejta per kerkim te detyrimit ndaj dorezanesit siç janë përcaktuar sipas Nenit 11 të kësaj Kontrate. Këto të drejta përfshijnë por nuk kufizohen me marrjen në posedim dhe shitjen e ndonjë apo gjithë kolateralit siç është përcaktuar në Nenin 7 dhe Kontraten e (Hipotekes, Marreveshjes Siguruese apo çfaredolloj tjeter mjeti sigurimi ligjor).

12.2. Në rast se ndodh apo vazhdon të ekzistojë qofte edhe vetem një Rast Mospërbushje, Banka ka te drejte te ndermarre te gjitha veprimet qe ajo i gjykon te arsyeshme dhe / ose kerkoje zgjidhjen e kontrates dhe rikthimin e kryegjese dhe interesave te akumuluar, si dhe cdo shume te tjeter te perlllogaritur dhe te paguashme ndaj saj.

Ne rast se nuk realizohet kthimi vullnetarisht nga klienti i te gjitha shumave qe i detyrohet bankes si me lart , banka ka te drejte:

- a) T'i drejtohet gjykates per leshimin e urdherit te ekzekutimit sipas nenit 510 te Kodit te Procedures Civile.
- b) Te filloje ekzekutimin e detyrueshem te kredise.
- c) Edhe gjate ekzekutimit te detyrueshem, kredimarrësit do te vazhdojne t'i llogariten interesa dhe penalitete sipas kesaj kontrate kredie bankare deri ne kthimin e plote te te gjitha shumave qe ai i detyrohet bankes.

12.3 Te gjitha kostot dhe shpenzimet administrative, gjyqesore, noterizimeve, komisioneve, tarifave per negoicimin, perfundimin e mbarevajtjes dhe ekzekutimin e te drejtave te Bankes, perfshire kolateralin sipas kontrates se hipotekes dhe marreveshjeve siguruese, perballohen nga Kredimarrësi/Bashkekredimarrësi/hipotekuesi/dorezanes.

### NENI 13: SIGURIMI I PAGESES SE KREDISE

13.1 Kredimarrësi do të sigurojë prane shoqerise se sigurimit te miratuar nga banka pasurite e tij te luajtshme te paluajtshme te vendosur si kolateral ne favor te Bankes te paktën per vleren e kredise, dhe do te rinovojë cdo vit policen e sigurimit. Kredimarrësi do të vendosë Bankën si përfituese të këtyre policave të sigurimit dhe do të paraqesë në Bankë kopje të rinovuara të policave të sigurimit 30 (tridhjetë ditë) ditë para afatit të mbarimit të tyre, per cdo vit. Ne rast se kredimarrësi nuk kryen rinovimin e policës së sigurimit ne afatin e kerkuar, banka ka te drejte te debitoje llogarine e kredimarrësit per vleren e primit te sigurimit dhe te beje sigurimin e pronës prane shoqerise se sigurimit. Banka kete te drejte e ushtron me iniciativen e saj pa qene nevoja te marre miratim te metejshem, jo vetem ne rastet kur llogarite e klientet kane gjendje kreditore, por dhe ne rastet kur llogaria/te nuk kane gjendje te mjaftueshme apo nuk kane fare gjendje kreditore. Ne keto raste, llogaria e kredimarrësit per shumen qe i perket primit te sigurimit , konsiderohet si overdraft i paautorizuar dhe kredimarrësi detyrohet jo vetem te paguaje shumen por dhe interesat e publikuara ne kushtet e punes se bankes per overdraftin e paautorizuar.

13.2 Kredimarrësi, Hipotekuesi pranon qe cdo kompensim dhe/apo demshperblim qe rrjedh nga policja e sigurimit te kredise ti kaloje Bankes dhe ai nuk do te kete te drejta mbi te.

13.3 Kredimarrësi bie dakort qe Banka t'i vere ne dispozicion shoqerise se sigurimit te gjithe informacionin dhe dokumentacionin e nevojshem te kredise/ kredimarrësit, perfshire dhe dokumentacionin e nje kolaterali te dyte qe mund te zevendesojë kolateralin e vendosur sipas kesaj kontrate, per efekt te marrjes ne sigurim dhe pagimit te shumes se sigurimit ne rast se ndodh ngjarja e sigurimit.

13.4 Ne rast te nje shtese te mevonshme te shumes se kredise, kredimarrësi do te paguaje primin shtese te sigurimit te kredise me nenshkrimin te kontrates se re te kredise, ne te kundert shuma shtese e kredise nuk disbursohet.

13.5 Ne rast te shlyerjes se parakohshme te kredise, kredimarrësi do te jete perfitues i nje pjese te primit te paguar, e cila do te perlllogaritet ne ate moment nga shoqeria e sigurimit, ne baze te pjeses se mbetur te afatit te kredise.

13.6 Ne rast se Kredimarrësi, Hipotekuesi dhe Shoqeria e Sigurimit jane ne proces gjyqesore per probleme te kompesimit/demshperblimit sipas kesaj kontrate kredie atehere te gjitha shpenzimet do te perballohen nga Kredimarrësi.

### NENI 14 - VERIFIKIMI DHE RAPORTIMI I TE DHENAVE

Palet ne kete kontrate bien dakord dhe deklarojne si me poshte :Duke kuptuar se, të dhënat tona demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë do te trajtohen ne perputhje me kuadrin ligjor dhe nenligjor ne fuqi per mbrojtjen e te dhenave personale, sekretin bankar si dhe sekretin profesional si dhe per faktin se Banka Raiffeisen dhe Regjistri i Kredive te Bankes se Shqiperise kane marre te gjitha masat e nevojshem per te garantuar trajtimin e sigurt te te dhenave te mesiperme:

Autorizoj Raiffeisen Bank që, për qëllimet që përfshijnë:

1. vlerësimin e aplikimit për të marrë kredi;
2. vlerësimin e rrezikut të kredisë gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies time kontraktore të kredisë me bankën Raiffeisen dhe/ose
3. vlerësimin e besueshmërisë time si person i lidhur me kredimarrësit,

të njihet me detyrimet e mia ndaj bankave/ degëve të bankave të huaja/ subjekteve kredidhënëse, nëpërmjet përdorimit të autorizuar të të dhënave/informacionit të Regjistrit të Kredive, në mënyrë që të vlerësojë sasinë e detyrimeve financiare, garancitë dhe besueshmërinë/afësinë për të shlyer detyrimet financiare. Gjithashtu, jap pëlqimin tim që banka Raiffeisen, të përdorë emrin dhe të dhënat e mia identifikuese dhe financiare që mbahen në Regjistrin e Kredive, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë

Ky autorizim konsiderohet i dhene per te gjithe personat nenshkrues te kontrates , pra si per kredimarrësit dhe te dhenat e tyre, ashtu dhe per dorezanesit dhe apo hipotekuesit.

### NENI 15 – TE NDRYSHME



15.1 Kjo Kontratë Kredie do të mbetet në fuqi deri në datën kur detyrimet ndersjellta të paleve të jenë plotësuar në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj kontrate.

15.2 Kjo Kontratë përbën titull ekzekutiv të vlefshëm për Kredimarrësin, të zbatueshëm kundrejt Kredimarrësit në përputhje me termat e saj.

15.3 Kjo Kontratë Kredie dhe dokumentat e cituara këtu përbejnë të gjithë detyrimin e palëve në lidhje me këtë objekt dhe do të mbizotërojnë ndaj çdo qëllimi ose kuptimi në lidhje me këtë operacion. Çdo ndryshim, heqje dorë nga Banka në lidhje me ndonjë kusht ose afat, ose miratim i dhënë nga Banka sipas kësaj Kontrate Kredije, do të bëhet me shkrim, nënshkruhet nga Banka, dhe në rast të ndryshimit edhe nga Kredimarrësi. Në rast se Banka heq dorë nga ndonjë prej kushteve të ndonjë Disbursimi, me marrjen e Disbursimit, Kredimarrësi do të konsiderohet se ka pranuar të gjitha kushtet dhe afatet e heqjes-dorë.

15.4 Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër që bëhet apo do të bëhet sipas kësaj Kontrate Kredije për Bankën apo për Kredimarrësin do të bëhet me shkrim. Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë Kredije, ky njoftim, kërkim ose çdo lloj komunikimi tjetër konsiderohet se është kryer apo bërë në mënyrën e duhur kur dorëzohet nëpërmjet postës së rregjistruar, ose me faks, të pala e duhur, ose të bërë në adresën e specifikuar në këtë kontrate, ose në ndonjë adresë tjetër për të cilën palët kanë marrë njoftim si dhe në numrat e kontaktit të deklaruar nga palët.

15.5 Aneks të kësaj kontrate janë :

- Aneksi 1 –sqarimet per NEI-n
- Aneksi 2 - Nje koment mbi kredimarrjes ne valute dhe rritjen e normes se interesit gjate periudhes se kredise.
- Aneksi 3 - Forma e aplikimit te disbursimit
- Aneksi 4 - Ngjarja e Luhatjes se Tregut dhe norma e refinancimit

### NENI 16 – NDALIMI I HEQJES DORE

Asnjë mënyrë sjellje dhe pamundësi ose vonesë e Bankës në realizimin e të drejtave, kompetencave ose mjeteve juridike, nuk do të konsiderohet si heqje dorë ose se bie ndesh me të drejtat, kompetencat ose mjetet juridike të vet Bankës. Asnjë e drejtë, kompetencë ose mjet juridik i Bankës nuk do të përjashtojë ndonjë të drejtë, kompetencë ose mjet juridik tjetër të cilësuar këtu ose që bëhet më pas e disponueshme nga ligji, praktika, aktet nënligjore e të tjera.

### NENI 17 – LIGJI DHE JURIDIKSIONI

Kjo Kontratë Kredie do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe të gjitha mosmarrëveshjet apo pretendimet që lindin apo lidhen me këtë Kontratë Kredije do të zgjidhet nga Gjykata e Shkallës së Parë Tirane.

**NË PRANINË E PALËVE**, që veprojnë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kjo Kontratë Kredije nënshkruhet në prani të perkthyesit në 5 kopje, dy për kredimarrësit, dy për bankën dhe një për noterin.

#### KREDIDHENES/BANKA:

Raiffeisen Bank SHA

Perfaqesuar nga

Erion BALLI



Rudina HORJET






#### KREDIMARRRES:

Shoqeria "TIRANA - URBAN - TRANS" sha

Perfaqesuar nga

Hazbi PARLLAKU



#### BASHKEKREDIMARRRES:

Shoqeria "PARLLAKU" shpk


Perfaqesuar nga

Hazbi PARLLAKU



#### DOREZANES:

Hazbi PARLLAKU





NOTER  


**Aneks 1  
Kontrate**

**I. Banka ve ne dijani kredimarresin, si me poshte vijon:**

- Norma e interesit per 12 muaj nga data e disbursimit te pare do te jete Tribor 1Y + 2.5% vjetore min 7.5% ne vit.
- Per kredite afatgjata, pjesa e papaguar e kryegjese ne fillim te kesaj periuadhe eshte 18'000'000 ALL dhe ne fund do te jete \_\_\_\_.
- Per kredite me kufi, kufiri i kredise do te jete sa ai i pershkruar ne nenin 2 te kontrates se kredise me kufi.
- Me kerkese te kredimarresit, Banka i ve ne dispozicion gjendjen e llogarise per cdo periuadhe te kredise qe kerkohet.
- Interesat e kredise me kufi llogariten cdo muaj mbi shumen e perdorur nga kredimarresi.
- Ne baze te normes se interesit te parashkuar ne nenin 1, plani i ripagimit te kredise per Shoqerine "TIRANA - URBAN - TRANS" sha Shoqerine "Parllaku" shpk per 12 muajt e ardhshem, duke perfshire shumat e cdo kesu dhe daten e ripagimit do te jete si me poshte vijon:

Plani i Ripagimit:

**II. Norma Efektive e Interesit**

Ne momentin e nenshkrimt te kontrates Norma Efektive e Interesit (NEI) eshte 7.89% ne vit. Megjithate, Vlera e sakte e NEI-T do te shprehet ne planin e amortizimit, i cili do ti dorezohet klientit pas disbursimit te kredise.

**ANEKSI 2**

**Informacion mbi kredimarrjen ne valute dhe i ndryshimin te normes se interesit**

I Nderuar Klient,

Me poshte gjeni nje koment mbi rrezikun qe paraqet per ju :

▪ **Ndryshimi i Normes se Interesit**

Raiffeisen BANK sh.a., e percakton normen e interesit te kredise suaj bazuar tek Tribor/Euribor/Libor(1-vjecar) per Kredite ne ALL/EUR/USD/CHF/GBP.

TRIBOR eshte Norma e Interesit Nderbankar per LEKU-n. Kjo norme llogaritet nga Banka e Shqiperise(BSH) dhe publikohet cdo dite biznesi ne oren 11(ora shqiptare).

EURIBOR eshte Norma e Interesit Nderbankar per EURO-n. Kjo norme llogaritet nga Federata Bankare Europiane(FBE) dhe publikohet cdo dite biznesi ne oren 11(ora belge).

LIBOR eshte Norma e Interesit Nderbankar per USD-n. Kjo norme llogaritet nga Interbank Londer dhe publikohet cdo dite biznesi ne oren 11(ora angleze).

Normat e Tribor/Euribor/Libor ndryshojne cdo dite pune bankare dhe mund ti gjeni te publikuar edhe ne sportelet e Raiffeisen Bank sha.

Ju kujtojme se, ne rast se ju merrni nje Kredi ne Raiffeisen BANK, keset mujore do te ndryshojne mbas afatit te percaktuar ne kontraten e kredise. Norma e interesit te kredise, mbas afatit te percaktuar ne kontrate, mund te jete me e larte se norma e interesit ne daten e lidhjes se kontrates se kredise. Po keshtu, dhe norma e interesit ne rastin e « ngjarjes se luhatjes se tregut » mund te jete me e larte se norma e interesit ne daten e lidhjes se kontrates.

▪ **Huamarrja ne Valute**

Ne rast se ju merrni nje kredi ne valute te huaj, keset mujore do te paguhen ne te njejten valute.

Nderkohe, nese te ardhurat tuaja jane ne Lek, duhet te kini parasysh qe, per shkak te ndryshimeve te kursit kembimit te valutave, ne momente te caktuara mund te nevojiten me teper LEK per te paguar kesin mujor.

Theksojme se, edhe pse vlerat e monedhave jane te qendrueshme gjate kesaj periuadhe, ato mund te ndryshojne ndjeshem ne te ardhmen. Bazuar sa me lart, ju lutemi te merrni ne konsiderate keto rreziqe perpara se te firmosni Kontraten tuaj te Kredise.

Ne rast se keni ndonje pyetje rreth ndryshimit te normes se interesit apo rreth huamarrjes ne valuta te ndryshme, mos hezitoni te pyesni Analistin e Kredise. Ne rast se ata nuk jane ne gjendje t'u pergjigjen pyetjeve tuaja, drejtohuni tek Drejtori i Deges.

**Deklarate nga Kredimarresi**

Une, \_\_\_\_\_ kam lexuar dhe diskutuar permabajtjen e ketij dokumenti me Analisti e Kredise. Une kuptoj dhe pranoj rrezikun e ndryshimit te normes apo rrezikun e huamarrjes ne valute.

Nenshkrimi i Kredimarresit \_\_\_\_\_


Data \_\_\_\_\_

**KREDIMARRRES:**

Shoqeria "TIRANA - URBAN - TRANS" sha

Perfaqsuar nga

Hazbi PARLLAKU



**BASHKEDIMARRRES:**

Shoqeria "PARLLAKU" shpk


Perfaqsuar nga

Hazbi PARLLAKU



**DOREZANES:**

Hazbi PARLLAKU







### ANEKSI 3 - FORMA E APLIKIMIT TË DISBURSIMIT

[Të shkruhet në Letër me Kokë të Kredimarrësit]

[Data]

Për: (Kredidhënësi -Emri dhe Adresa):

Subjekti:Nr. \_\_\_\_\_ i Aplikimit të Disbursimit

I/E Nderuar Zotëri/Zonjë:

1.Jeni të lutur t'i referoheni termave të Kontratës së Kredise datë \_\_\_\_\_ ("Kontrata e Kredise") ndërmjet \_\_\_\_\_ ("Kredimarrësi"), dhe ("Kredidhënësi).

2.Shprehjet e përkufizuara në Kontratën e Kredise do të kenë të njëjtin kuptim këtu.

3.Me anë të kësaj letre kërkojmë Disbursimin e mëposhtëm në përputhje me të gjitha dispozitat e Kontrates së Kredisë:

Monedha e kërkuar: [fut Monedhën e Kredisë]

Shuma (në shifra dhe me fjalë): \_\_\_\_\_

Banka : \_\_\_\_\_

Datë Valuta:

#### Udhëzimet e Pagesës (Detajet e Bankës së Kredimarrësit):

Emri i Llogarisë së Kredimarrësit: \_\_\_\_\_

Numri i Llogarisë së Kredimarrësit: \_\_\_\_\_

Emri i Bankës së Kredimarrësit: \_\_\_\_\_

Adresa e Bankës së Kredimarrësit: \_\_\_\_\_

#### Detajet e Bankës Korrespondente të Kredimarrësit:

Emri i Korrespondentes: \_\_\_\_\_

Adresa e Korrespondentes: \_\_\_\_\_

Emri i Llogarisë së Kredimarrësit: \_\_\_\_\_

Numri i Llogarisë së Kredimarrësit: \_\_\_\_\_

Referenca: \_\_\_\_\_

4. Për qëllimet e nenit 9 të Kontratës së Kredise, ne deklarojmë dhe garantojmë se:

- të gjitha kontratat, dokumentet dhe instrumentet që i janë dorëzuar Kredidhënësit janë të pakushtëzuara, në fuqi dhe efekt të plotë;
- deklarimet dhe garancitë e bëra nga Kredimarrësi në Kontratat e Kredive dhe Kontratat e Garancive janë të vërteta, dhe që nga kjo date, me të njëjtin efekt sikur këto deklarime dhe garanci të ishin bërë në datën e kësaj kontrate;
- nuk ka ndodhur dhe as është duke vazhduar ose është e pashmangshme ndonjë mosmarrëveshje;
- Kredimarrësi, si rezultat i këtij Disbursimi, nuk do të shkelë Statutin, ndonjë dispozitë të kontratës ose dokument në të cilin Kredimarrësi është palë (duke përfshirë të Kontratën e Kredisë) ose me të cilën Kredimarrësi është i detyruar, ose ndonjë ligj në fuqi për Kredimarrësin;
- nuk ka ndodhur asgjë që mund të ketë një efekt të pafavorshëm mbi biznesin e Kredimarrësit, operacionet ose gjendjen financiare ose aftësinë e Kredimarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas Kontratës së Kredise ose Kontratave të Garancive; dhe
- të ardhurat nga ky Disbursim janë të nevojshme nga Kredimarrësi për qëllimet e percaktuara në Kete Kontrate.

I Juaji Singërisht,

Kredimarrësi

Emri:

Titulli:



## ANEKSI 4 – NGJARJA E LUHATJES SE TREGUT DHE NORMA E RIFINANCIMIT

I Nderuar Klient,

Me poshte gjeni nje koment sqarues ne lidhje me parashikimet e kesaj kontrate kredie ne rastet e ndodhjes se ngjarjes se luhatjes se tregut.

### Luhatjet e tregut dhe parapagimi i detyrueshem

- (a) Nese ndeshemi me nje Ngjarje te Luhatjes se Tregut ne lidhje me nje Kredi, ne cdo Periudhe Interesi, norma e interesit per kete kredi sipas Periudhes perkatese te Interesit do te jete norma ne perqindje per vit, e cila eshte shuma e:
- (i) Marzhi – i cili eshte perqindja e interesit mbi normen e publikuar te interesit ne Euro/USD/Leke e cila perfitohet nga banka;
  - (ii) norma qe Kredidhenesi i ka njoftuar Kredimarresit deri ne oren 12.00 sipas ores lokale, ne Diten e Kuotimit, perpara dites se pare te Periudhes perkatese te interesit, e cila shpreh si nje perqindje per vit, koston me te cilen Kredidhenesi eshte financuar ne tregun e parase nga palet e treta per financimin ne Euro/USD/Leke (me poshte "Norma e Interesit ne Luhatje te Tregut"); dhe
  - (iii) Shpenzimet e Detyrueshme, per pjesemarrjen e Kredidhenesit ne Kredi, nese ka te tilla;
- Ne kete Kontrate "Ngjarje e Luhatjes se Tregut" do te thote:
- (i) ne ose rreth ores 12.00 sipas ores lokale ne Diten e Kuotimit, per Periudhen perkatese te Interesit asnje ose vetem nje Faqe ku publikohen Normat e Interesit do te jete e disponueshme per Kredidhenesin per te percaktuar Normen e Rifinancimit ose;
  - (ii) ne ose rreth ores 12.00 sipas ores lokale ne Diten e Kuotimit per Periudhen perkatese te Interesit, Kredidhenesi informon me shkrim Kredimarresin se shpenzimet per sigurimin e fondeve ne Euro/USD/Leke tejkalojne Normen e Rifinancimit.
- (b) Nese nje Ngjarje e Luhatjes se Tregut eshte deklaruar nga Kredidhenesi, dhe Kredimarresi ka njoftuar Kredidhenesin jo me vone se ora 17.00 e ores lokale ne Diten e Kuotimit, nje dite para dites se pare te Periudhes perkatese te Interesit, qe **Norma e Interesit** e Luhatjes se tregut njoftuar nga Kredidhenesi ne vijim te paragrafit (a) (ii) me siper nuk eshte e pranueshme per te;
- (i) Kredimarresi duhet qe brenda 30 diteve nga dhenia e ketij njoftimi te mospranimi te normes se rifinancimit te parapaguaje pjesen e papaguar te Kryegjese, se bashku me interesat e perlloraritura sipas nenit 4, duke filluar nga dita e pare e Periudhes se Interesit deri ne ditin aktual te parapagimit, si dhe gjithë shumat e tjera qe kredimarresi i detyrohet Kredidhenesit sipas kesaj kontrate; dhe
  - (ii) Angazhimi i Kredidhenesit sipas kesaj kontrate perfundon me efekt te menjehershem.
- (d) Nese Kredimarresi deshton ne njoftimin e Kredidhenesit sic ishte parashikuar ne afatin e percaktuar ne paragrafin (b) me siper, do te konsiderohet e pranuar Norma e Rifinancimit e Luhatjes se tregut, e njoftuar nga Kredidhenesi sipas paragrafit (a) (ii) me siper.

### Percaktimi i normes se rifinancimit

Ne cdo periudhe rishikimi te normes se rifinancimit, kjo norma e interesit do te llogaritet si vlere aritmetike e normave te interesit te ofrimit te depozitave me afat te barabarte ose te krahasueshem me periudhen e interesit (e rrumbullkosur deri ne 4 shifra pas pjesjes dhjetore), te tregur ne faqen : Reuters page: KLIEMMM, deri ne oren 11.00 sipas ores lokale, te dites se kuotimit.

**Dita e Kuotimit**, do te kuptohet dy dite pune para dites se pare te periudhes se interesit, ne te cilen do te percaktohet norma e rifinancimit, per periudhen pasardhese te interesit. Ne rast se dita e kuotimit eshte dite pushimi, si dite kuotimi do te merret dita pasardhese e punes, pas dites se kuotimit.

Ne rast se ne Diten e Kuotimit, ne faqen : Reuters : KLIEMMM, deri ne oren 11.00 sipas ores lokale, nuk jane te shfaqura normat e interesit, banka ka te drejte te aplikojte nje norme tjeter rifinancimi, sipas atyre te shfaqura ne faqe te tjera te cilat i ofrojne keto norma ne ditin e kuotimit.

Bazuar sa me lart, ju lutemi te merrni ne konsiderate keto treziqe perpara se te firmosni Kontraten tuaj te Kredise.

Ne rast se keni ndonje pyetje rreth ketyre parashikimeve , mos hezitoni te pyesni Analistin e Kredise. Ne rast se ata nuk jane ne gjendje t'u pergjigjen pyetjeve tuaja, drejtohuni tek Drejtori i Deges.

Deklarate nga Kredimarresi

Une, \_\_\_\_\_ kam lexuar dhe diskutuar permbajtjen e ketij dokumenti me Analisti e Kredise. Une kuptoj dhe pranoj rrezikun e ndryshimit te normes se interesit ne kushtet e ndodhjes se ngjarjes se luhatjes se tregut.

Nenshkrimi i Kredimarresit \_\_\_\_\_

### KREDIMARRES:

Shoqeria "TIRANA - URBAN - TRANS" sha

Perfaqsnar nga

Hazbi PARLLAKU

### BASHKEKREDIMARRES:

Shoqeria "PARLLAKU" shpk

Perfaqsnar nga

Hazbi PARLLAKU

### DOREZANES:

Hazbi PARLLAKU